

**TRAKTATI  
THEMELUES I**

**KOMUNITETIT EUROPIAN  
TË ENERGISË ATOMIKE**

**(EUROATOM)**

## **TRAKTATI**

MADHËRIA E TIJ, MBRETI I BELGËVE, PRESIDENTI I REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PRESIDENTI I REPUBLIKËS FRANCEZE, PRESIDENTI I REPUBLIKËS ITALIANE, SHKËLQESIA E SAJ MBRETËRORE DUKESHAE MADHE E LUKSEMBURGUT, MADHËRIA E SAJ, MBRETËRESHA E HOLANDËS,

Duke njohur se energjia atomike përfaqëson një burim kryesor për zhvillimin dhe fuqizimin e industrisë dhe lejon përparimin e çështjes së paqes,

Të bindur se vetëm një përpjekje e përbashkët e pavonuar mund të ofrojë mundësinë e arritjeve të krahasueshme me kapacitetet krijuese të vendeve të tyre,

Të vendosur për të krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin e një industrie të fuqishme atomike, që do të sigurojë burime të shumta energjie, do të çojë në modernizimin e proceseve teknike dhe do të kontribuojë nëpërmjet mënyrave të tjera të ndryshme, për prosperitetin e popujve të tyre,

Të shqetësuar për të krijuar kushtet e sigurisë të nevojshme për të eliminuar rreziqet për jetën dhe shëndetin e publikut,

Duke dëshiruar të përfshijnë vende të tjera në punën e tyre dhe të bashkëpunojnë me organizata ndërkombëtare që janë të interesuara për zhvillimin paqësor të energjisë atomike.

Kanë vendosur të krijojnë Komunitetin European të Energjisë Atomike (EUROATOM), dhe për këtë qëllim kanë caktuar si Përfaqësues të Plotfuqishëm të tyre:

MADHËRINË E TIJ, MBRETIN E BELGËVE:

Mr. Paul-Henri SPAAK, Ministër i Punëve të Jashtme

BARONIN J. Ch. SNOY et d'OPPUERS, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Çështjeve Ekonomike, Kryetar i Delegacionit Belg në Konferencën Ndërqeveritare;

PRESIDENTIN E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË:

Dr. Konrad ADENAUER, Kancelar Federal,

Profesor Dr. Walter HALLSTAIN, Sekretar i Shtetit të Zyrës Federale për Marrëdhëniet me Jashtë;

PRESIDENTIN E REPUBLIKËS FRANCEZE

Z. Christian PINEAU, Ministër i Punëve të Jashtme,

Z. Maurice FAURE, Nënshef i Shtetit për Marrëdhëniet me Jashtë;

PRESIDENTIN E REPUBLIKËS ITALIANE:

Z. Antonio SEGNI, Kryetar i Këshilli të Ministrave,

Profesor Gaetano MARTINO, Ministër i Punëve të Jashtme;

SHKËLQESINË E SAJ MBRETËRORE DUKESHËNE MADHE TË LUKSEMBURGUT:

Z. Joseph BECH, Kryetari i Qeverisë,  
Ministër i Punëve të Jashtme,

Z. Lambert SCHAUS, Ambasador, Kryetar i Delegacionit të Luksemburgut në Konferencën Ndërqeveritare;

MADHËRINË E SAJ, MBRETËRESHËN E HOLANDËS:

Z. Joseph LUNS, Ministër i Punëve të Jashtme,

Z. J. LINTHORST HOMAN, Kryetar i Delegacionit të Holandës në Konferencën Ndërqeveritare,

Të cilët, pasi kanë shkëmbyer kompetencat e tyre të plota, të gjetura në formën e duhur, ranë dakord si më poshtë:

## TITULLI NJË

## **DETYRAT E KOMUNITETIT**

## Neni 1

Me anë të këtij traktati, Palët e Larta Kontraktuese, themelojnë ndërmjet tyre një Komunitet European të Energjisë Atomike (EUROATOM).

Komuniteti ka për detyrë të kontribuojë për rritjen e standardit të jetesës në Shtetet Anëtare dhe zhvillimin e marrëdhënieve me shtetet e tjera nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme, për krijimin e shpejtë dhe rritjen e industrive bërthamore.

## Neni 2

Me qëllim që të kryejë detyrat që parashikohen në këtë traktat, Komuniteti:

- (a) Nxist kërkimin dhe siguron shpërndarjen e informacionit teknik;
- (b) Krijon standarde uniforme sigurie për të mbrojtur shëndetin e punëtorëve dhe të publikut në përgjithësi, si dhe siguron zbatimin e këtyre standardeve;
- (c) Lehtëson investimin dhe siguron, në veçanti nëpërmjet inkurajimit të projekteve nga ana e sipërmarrjeve, krijimin e instalimeve bazë të nevojshme për zhvillimin e energjisë atomike në Komunitet;
- (d) Siguron që të gjithë përdoruesit në Komunitet të furnizohen rregullisht dhe në mënyrë të barabartë me minerale dhe lëndë bërthamore;
- (e) Nëpërmjet mbikëqyrjes së duhur, siguron që materialet bërthamore nuk përdoren për qëllime të ndryshme nga qëllimet për të cilat ato synohen të përdoren;
- (f) Ushtron të drejtën e pronësisë që i jepet në lidhje me materialet e veçanta të zbrëthueshme;
- (g) Siguron pika të gjëra tregtare dhe mundësi shfrytëzimi të institucioneve më të mira teknike nëpërmjet krijimit të një tregu të përbashkët për materiale dhe pajisje të specializuara, nëpërmjet lëvizjes së lirë të kapitalit për investime në fushën e energjisë atomike dhe lirisë së punësimit për specialistët brenda Komunitetit.
- (h) Krijon me vende dhe organizata të tjera ndërkombëtare marrëdhënie të tilla, që nxisin përparimin për përdorimet paqësore të energjisë atomike.

## Neni 3

1. Detyrat që i janë besuar Komunitetit kryhen nga institucionet e mëposhtme:

PARLAMENTI,  
KËSHILLI,  
KOMISIONI,  
GJYKATA E DREJTËSISË.

Secili institucion vepron brenda kufijve të kompetencave që i jep ky traktat.

2. Këshilli dhe Komisioni ndihmohen nga Komiteti Ekonomik dhe Social që ka funksion këshillimor.

**TITULLI DY**

**DISPOZITAT PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT NË  
FUSHËN E ENERGJISË ATOMIKE**

## KAPITULLI II



## NXITJA E KËRKIMIT

### Neni 4

1. Komisioni është përgjegjës për nxitjen dhe lehtësimin e kërkimit bërthamor në Shtetet Anëtare dhe mbarëvajtjen e tij, duke kryer një program kërkimi dhe trajnimi të Komunitetit.
2. Aktiviteti i Komisionit në këtë aspekt kryhet brenda fushave të renditura në Shtojcën I të këtij traktati.

Kjo listë mund të ndryshohet nga Këshilli, i cili voton me shumicë të cilësuar për propozimin e Komisionit. Ky i fundit këshillohet me Komitetin Shkencor dhe Teknik që krijohet sipas nenit 134.

### Neni 5

Për qëllime të koordinimit dhe përfundimit të kërkimit të ndërmarrë në Shtetet Anëtare, Komisioni, me anë të një kërkese specifike drejtuar një marrësi të caktuar dhe që i përcillet qeverisë së interesuar, ose me anë të një kërkese të përgjithshme të botuar, u bën thirrje Shteteve Anëtare, personave ose sipërmarrjeve t'i komunikojnë atij programet e tyre që lidhen me kërkimin që specifikohet në kërkesë.

Pasi u jep personave të përfshirë mundësi të plotë për të komentuar, Komisioni mund të japë një mendim të arsyetuar për secilin nga programet që i komunikohen atij. Komisioni e jep një mendim të tillë, nëse shteti, personi ose sipërmarrja që ka komunikuar programin e kërkon këtë gjë.

Me anë të këtyre mendimeve, Komisioni pengon mbivendosje të panevojshme dhe e drejton kërkimin drejt sektorëve që janë shfrytëzuar në mënyrë të pamjaftueshme. Komisioni nuk mund t'i botojë këto programe pa miratimin e shtetit, personit ose sipërmarrjes që i ka komunikuar ato.

Komisioni boton periodikisht një listë të atyre sektorëve të kërkimit bërthamor që i konsideron si të shfrytëzuar në mënyrë të pamjaftueshme.

Komisioni mund të mbledhë përfaqësues të qendrave publike dhe private të kërkimit si dhe ekspertë të tjerë të angazhuar në kërkim, në të njëjtat fusha ose në fusha të lidhura, për këshillime të ndërsjella dhe shkëmbim informacioni.

### Neni 6

Për të nxitur kryerjen e programeve të kërkimit që i komunikohen atij, Komisioni mund të:

- (a) japë ndihmë financiare brenda kuadrit të kontratave të kërkimit, gjithsesi, pa ofruar subvencionime;
- (b) japë, pa pagesë ose kundrejt pagesës, për kryerjen e programeve të tilla, çdo lloj materiali burimor ose materiale të veçanta të zërthyeshme që zotëron;
- (c) bëjë instalime, të pajisë ose të sigurojë ndihmë ekspertësh në dispozicion të Shteteve Anëtare, personave ose sipërmarrjeve, pa pagesë ose kundrejt pagesës;
- (d) nxisë financimin e ndërsjellë nga Shtetet Anëtare, personat ose sipërmarrjet e përfshira.

### Neni 7

Programet e kërkimit dhe të trajnimit të Komunitetit përcaktohen nga Këshilli, i cili voton në mënyrë unanime një propozim të Komisionit, i cili konsultohet me Komitetin Shkencor dhe Teknik.

Këto programe hartohen për një periudhë jo më të gjatë se pesë vjet.

Fondet që kërkohen për plotësimin e këtyre programeve përfshihen çdo vit në buxhetin e kërkimit dhe të investimit të Komunitetit.

Komisioni siguron kryerjen e këtyre programeve, dhe i dorëzon Këshillit një raport vjetor për to.

Komisioni e informon Komitetin Ekonomik dhe Social për projektet e gjera të programeve të kërkimit dhe trajnimit të Komunitetit.

#### Neni 8

1. Pas konsultimit me Komitetin Shkencor dhe Teknik, Komisioni krijon një Qendër të Përbashkët të Kërkimit Bërthamor.

Kjo qendër siguron kryerjen e programeve të kërkimit dhe të detyrave të tjera që i caktohen asaj nga Komisioni.

Ajo siguron gjithashtu krijimin e një terminologjie bërthamore të njësuar dhe të një sistemi standard matjesh.

Ajo krijon një byro qendrore për matjet bërthamore.

2. Për arsye gjeografike dhe funksionale, aktivitetet e qendrës mund të kryhen në mjedise të ndara.

#### Neni 9

1. Pas marrjes së opinionit të Komitetit Ekonomik dhe Social, brenda kuadrit të Qendrës së Përbashkët Atomike të Kërkimit, Komisioni mund të ngrejë shkolla për trajnimin e specialistëve, veçanërisht në fushën e kërkimit të mineraleve, prodhimit të materialeve bërthamore me pastërti të lartë, përpunimit të lëndëve rrezatuese, inxhinierisë bërthamore, shëndetit, sigurisë, prodhimit dhe përdorimit të radioizotopeve.

Komisioni përcakton detajet e një trajnimi të tillë.

2. Gjithashtu krijohet edhe një institucion me status universiteti, mënyra e funksionimit të të cilit përcaktohet nga Këshilli, i cili vendos me shumicë të cilësuar pas marrjes së propozimit nga Komisioni.

#### Neni 10

Komisioni mund t'i besojë kryerjen e pjesëve të caktuara të programit të kërkimit Komunitetit të Shteteve Anëtare, personave ose sipërmarrjeve, ose shteteve të treta, organizatave ndërkombëtare ose nënshtetasve të shteteve të treta.

#### Neni 11

Komisioni boton programet e kërkimit të cilave u referohen nenet 7, 8 dhe 10, si dhe raporte të rregullta ecurie mbi zbatimin e tyre.

## KAPITULLI II SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT

### Seksioni I

#### **Informacioni mbi të cilin Komuniteti ka kompetencë shpërndarjeje**

##### Neni 12

Shtetet Anëtare, personat ose sipërmarrjet kanë të drejtë, me kërkesë drejtuar Komisionit, të marrin licenca joekskluzive në përputhje me patentat, të drejta patentash të mbrojtura me kusht, modele të përdorimit ose zbatime të patentave që zotëron Komuniteti, kur ata janë në gjendje të përdorin në mënyrë efektive shpikjet e mbuluara prej tyre.

Në të njëjtat kushte, Komisioni jep licenca ose nënlicenca në përputhje me patentat, patenta, të drejta patentash të mbrojtura me kusht, modele të përdorimit ose zbatime të patentave, kur Komuniteti ka licenca kontraktuale, që i japin kompetenca për ta bërë një gjë të tillë.

Komisioni i jep këto licenca ose nënlicenca sipas kushteve të rëna dakord me të licencuarin, dhe siguron të gjithë informacionin që kërkohet për përdorimin e tyre. Këto kushte lidhen në veçanti me shpërblimin e përshtatshëm, dhe ku është e nevojshme, me të drejtën e të licencuarit për të dhënë nënlicenca për palët e treta, si dhe detyrimin për ta trajtuar informacionin si sekret tregtar.

Nëse i licencuari nuk bie dakord për kushtet që përmenden në paragrafin e tretë, ai mund ta ankimojë çështjen në Gjykatën e Drejtësisë, në mënyrë që të përcaktohen kushtet e nevojshme.

##### Neni 13

Komisioni i komunikon Shteteve Anëtare, personave dhe sipërmarrjeve informacionin e marrë nga Komuniteti, i cili nuk mbulohet nga përcaktimet e nenit 12, si në rastet kur ky informacion buron nga programi i tij i kërkimit, ose nga komunikimi tek Komisioni me të drejtën për ta përdorur atë në mënyrë të lirë.

Megjithatë, Komisioni mund ta japë një informacion të tillë, me kushtin që ai të përdoret në mënyrë konfidenciale dhe të mos u kalohet palëve të treta.

Komisioni mund të mos japë informacionin që është marrë prej tij me kufizime përdorimi ose shpërndarjeje, informacione të tilla të cilësuar si informacione sekret, me përjashtim të rasteve kur i është përmbajtur këtyre kufizimeve.

### Seksioni II

#### **Informacione të tjera**

##### (a) Shpërndarja nëpërmjet marrëveshjeve miqësore

##### Neni 14

Komisioni përpiqet, me marrëveshje miqësore, të sigurojë komunikimin e informacionit i cili përdoret nga Komuniteti për arritjet e objektivave të tij, si dhe dhënien e licencave në përputhje me patentat, të drejta patentash të mbrojtura me kusht, modelet e përdorimit ose zbatimet e patentave që mbulojnë një informacion të tillë.

##### Neni 15

Komisioni miraton procedurën, të cilën Shtetet Anëtare, personat dhe sipërmarrjet mund ta përdorin si ndërmjetëse për shkëmbim të përkohshëm ose përfundimtar të rezultateve të kërkimit të tyre, për aq kohë sa këto rezultate nuk janë marrë nga Komuniteti në bazë të kontratave të kërkimit të ofruara nga Komisioni.

Kjo procedurë duhet të jetë e tillë, që të sigurojë natyrën konfidenciale të shkëmbimit. Megjithatë, rezultatet e komunikuar, Komisioni mund t'ia përcjellë Qendrës së Përbashkët të Kërkimit Bërthamor për qëllime dokumentacioni; kjo nuk përfshin asnjë të drejtë përdorimi për të cilën pala dërguese nuk ka rënë dakord.

#### (b) Komunikimi i detyrueshëm me Komisionin

##### Neni 16

1. Sapo një Shtet Anëtar depoziton kërkesë për patentë apo shpikje ose model përdorimi, në lidhje me një subjekt specifik bërthamor, ky Shtet Anëtar i kërkon kërkuesit të bjerë dakord që përmbajtja e kërkesës t'i komunikohet menjëherë Komisionit.

Nëse kërkuesi bie dakord, ky komunikim duhet të bëhet brenda tre muajsh nga data e depozitimit të kërkesës. Nëse kërkuesi nuk bie dakord, Shteti Anëtar, brenda të njëjtës periudhë kohore, njofton Komisionin për ekzistencën e kërkesës.

Komisioni mund t'i dërgojë Shtetit Anëtar përmbajtjen e kërkesës për ekzistencën e së cilës ai është njoftuar.

Komisioni e paraqet çdo kërkesë të tillë brenda dy muajve nga data e njoftimit. Çdo zgjatje e kësaj periudhe përfshin një zgjatje korresponduese të periudhës së cilës i referohet nënparagrafi i gjashtë i këtij paragrafi.

Pas marrjes së një kërkesë të tillë nga Komisioni, Shteti Anëtar i kërkon sërish kërkuesit të bjerë dakord me komunikimin e përmbajtjes së kërkesës. Nëse kërkuesi është dakord, komunikimi bëhet menjëherë.

Nëse kërkuesi nuk bie dakord, Shtetit Anëtar do t'i kërkohet sidoqoftë t'ia bëjë këtë komunikim Komisionit brenda tetëmbëdhjetë muajve nga data e depozitimit të kërkesës.

2. Brenda tetëmbëdhjetë muajve nga data e depozitimit, Shtetet Anëtare informojnë Komisionin për ekzistencën e çdo kërkesë, ndonëse të pabotuar, për patentë, model përdorimi i cili u duket, në pamje të parë, se trajton një çështje, e cila megjithëse nuk specifikohet si bërthamore, është drejtpërsëdrejti e lidhur me energjinë atomike dhe thelbësore për zhvillimin e energjisë atomike në Komunitet.

Nëse kërkohet prej tij, përmbajtja e kërkesës i komunikohet Komisionit brenda dy muajve.

3. Në mënyrë që botimi të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, Shtetet Anëtare ulin në minimum kohën për përpunimin e kërkesave për patenta ose modele përdorimi, që lidhen me çështje të cilave u referohet paragrafi 1 dhe 2, për të cilat është bërë një kërkesë nga Komisioni.

4. Komisioni i trajton komunikimet e lartpërmendura si konfidenciale. Komunikimet mund të bëhen vetëm për qëllime dokumentacioni. Megjithatë, Komisioni mund të përdorë shpikjet që i janë komunikuar atij, ose me pëlqimin e kërkuesit ose në përputhje me nenet 17 deri në 23.

5. Parashikimet e këtij neni nuk zbatohen, kur një marrëveshje e lidhur me një shtet të tretë ose me organizata ndërkombëtare përjashton komunikimin.

#### (c) Dhënia e licencave nëpërmjet arbitrazhit ose kompetencave detyruese

##### Neni 17

1. Në mungesë të një marrëveshjeje miqësore, licencat joekskluzive mund të jepen ose nëpërmjet arbitrazhit ose nëpërmjet kompetencave detyruese në përputhje me nenet 18 deri në 23.

- (a) për Komunitetin ose Sipërmarrjet e Përbashkëta të cilave u është dhënë kjo e drejtë sipas nenit 48 në lidhje me patentat, të drejtat e mbrojtura përkohësisht të patentave ose modelet e përdorimit që lidhen me shpikjet që janë drejtpërsëdrejti të lidhura me kërkimin bërthamor, ku dhënia e licencave të tilla është e nevojshme për vazhdimësinë e kërkimit të tyre ose e domosdoshme për vënien në funksion të instalimeve.

Nëse kërkohet nga Komisioni, licenca të tilla përfshijnë të drejtën për të autorizuar palët e treta për të përdorur shpikjen, kur ata kryejnë punë ose zbatojnë urdhra të vendosura nga Komisioni ose Sipërmarrjet e Përbashkëta;

- (b) për personat ose sipërmarrjet që i kanë paraqitur kërkesë Komisionit në lidhje me patentat, të drejtat e mbrojtura me kusht të patentave ose modelet e përdorimit që lidhen me shpikjet, që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti dhe janë thelbësore për zhvillimin e energjisë atomike në Komunitet, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (i) të kenë kaluar të paktën katër vjet pas depozitimit të kërkesës për patentë, me përjashtim të rastit të një shpikjeje që lidhet me një objekt specifik bërthamor;
- (ii) kur nuk plotësohen kërkesat në lidhje me këtë shpikje që dalin nga zhvillimi i energjisë atomike, në konceptimin e Komisionit për një zhvillim të tillë, në territorin e një Shteti Anëtar ku mbrohet shpikja;
- (iii) pronari, të cilit i kërkohet të plotësojë kërkesa të tilla, vetë ose përmes të licencuarit të tij, nuk e ka plotësuar këtë kërkesë;
- (iv) personat ose sipërmarrjet që paraqesin kërkesë për licenca, janë në gjendje të plotësojnë efektivisht kërkesa të tilla duke përdorur shpikjen.

Për të plotësuar këto kërkesa, Shtetet Anëtare mund të mos marrin masa shtrënguese të parashikuara në legjislacionin e tyre të brendshëm, që kufizojnë mbrojtjen e shpikjes, me përjashtim të rasteve kur bëhet një kërkesë fillestare nga Komisioni.

2. Një licencë joekskluzive mund të mos jepet siç parashikohet në paragrafin 1, ku pronari mund të provojë praninë e arsyeve legjitime, dhe në veçanti, kur ai nuk ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion.

3. Dhënia e një licence sipas paragrafit 1 jep të drejtën e kompensimit të plotë, për shumën e të cilit bihet dakord ndërmjet pronarit të patentës, të drejtave të mbrojtura me kusht të patentës ose modelit të përdorimit dhe të licencuarit.

4. Parashikimet e këtij neni nuk cenojnë dispozitat e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale.

#### Neni 18

Për qëllimet e përcaktuara në këtë seksion krijohet një Komitet Arbitrazhi. Këshilli, me propozim të Gjykatës së Drejtësisë, emëron anëtarët dhe parashikon rregullat e veprimit të këtij Komiteti.

Palët mund të bëjnë ankim kundër një vendimi të Komitetit të Arbitrazhit, i cili ka efekt pezullues në Gjykatën e Drejtësisë brenda një muaji nga njoftimi. Gjykata e Drejtësisë e kufizon shqyrtimin e tij në vlefshmërinë formale të vendimit dhe në interpretimin e dispozitave të këtij traktati nga Komiteti i Arbitrazhit.

Vendimet përfundimtare të Komitetit të Arbitrazhit kanë fuqi *res judicata* ndërmjet palëve të interesuara. Ato janë të detyrueshme, siç parashikohet në nenin 164.

#### Neni 19

Në rastet kur nuk arrihet marrëveshje miqësore, Komisioni synon të sigurojë dhënien e licencave në njërin nga rastet e parashikuara në nenin 17; ai e njofton pronarin e patentës të së drejtës të mbrojtur me kusht të patentës, të modelit të përdorimit ose zbatimit të patentës, për qëllimin e tij, dhe në këtë njoftim specifikon emrin e kërkuesit dhe objektin e licencës.

#### Neni 20

Brenda një muaji nga marrja e njoftimit, të cilit i referohet neni 19, pronari mund t'i propozojë Komisionit, dhe kur është e nevojshme, edhe kërkuesit, të lidhin një marrëveshje të posaçme për t'ia referuar çështjen Komitetit të Arbitrazhit.

Nëse Komisioni ose kërkuesi refuzojnë të lidhin një marrëveshje të tillë, Komisioni nuk i kërkon Shtetit Anëtar ose autoriteteve përkatëse të tij të japin licencën ose të shkaktojnë dhënien e saj.

Nëse, kur një çështje i referohet atij sipas një marrëveshjeje të posaçme, Komiteti i Arbitrazhit konstaton se kërkesa nga Komisioni përputhet me parashikimet e nenit 17, ai jep një vendim të arsyetuar që përmban dhënien e licencës për kërkuesin dhe parashikimin e kushteve të licencës dhe të shpërblimit, kur palët nuk kanë rënë dakord për këto pika.

#### Neni 21

Nëse pronari nuk propozon që çështja t'i referohet Komitetit të Arbitrazhit, Komisioni mund t'i bëjë thirrje Shteteve Anëtare të interesuara ose autoriteteve përkatëse të tyre të japin licencën ose të shkaktojnë dhënien e saj.

Nëse, pas dëgjimit të çështjes së pronarit, Shteti Anëtar, ose autoritetet përkatëse të tij, janë të mendimit se nuk janë respektuar kushtet e nenit 17, ai njofton Komisionin për refuzimin e dhënies së licencës ose shkaktimit të dhënies së saj.

Nëse ai refuzon dhënien e licencës ose shkaktimin e dhënies së saj, ose nëse brenda katër muajsh nga data e kërkesës nuk është dhënë asnjë informacion në lidhje me dhënien e licencës, Komisioni ka dy muaj kohë për ta çuar çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë.

Pronari dëgjohe në seanca përpara Gjykatës së Drejtësisë.

Nëse vendimi i Gjykatës së Drejtësisë përcakton se janë respektuar kushtet e nenit 17, Shteti Anëtar i interesuar ose autoritetet përkatëse të tij marrin masat siç kërkohet për zbatimin e këtij vendimi.

#### Neni 22

1. Nëse pronari i patentës, i të drejtës së mbrojtur përkohësisht të patentës, ose i modelit të përdorimit dhe i licencuari nuk bien dakord për shumën e kompensimit, palët e interesuara mund të lidhin një marrëveshje të posaçme për t'ia referuar çështjen Komitetit të Arbitrazhit.

Duke bërë këtë gjë, palët heqin dorë nga e drejta e kryerjes së proceseve të tjera të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 18.

2. Nëse i licencuari refuzon të lidhë një marrëveshje të posaçme, licenca që ai ka marrë konsiderohet e pavlefshme.

Nëse pronari refuzon të lidhë një marrëveshje të posaçme, kompensimi që i referohet këtij neni përcaktohet nga autoritetet përkatëse kombëtare.

## Neni 23

Pas kalimit të një viti, vendimet e Komitetit të Arbitrazhit ose të autoriteteve përkatëse kombëtare mund të rishikohen, në përputhje me kushtet e licencës, nëse ka fakte të reja për ta justifikuar këtë veprim.

Një rishikim i tillë është çështje që i përket organit që ka dhënë vendimin.

## Seksioni III

### Dispozitat e Sigurimit

#### Neni 24

Informacioni që merr Komuniteti si rezultat i realizimit të programeve të tij të kërkimit, dhe nxjerrja e të cilit ka të ngjarë të cenojë interesat e sigurimit të një ose më shumë Shteteve Anëtare, i nënshtrohet një sistemi sigurimi në përputhje me parashikimet e mëposhtme:

1. Këshilli, në bazë të një propozimi nga Komisioni, miraton rregulloret e sigurimit, duke marrë parasysh dispozitat e këtij neni, duke parashtruar klasifikimet e ndryshme të sigurimit që do të zbatohen dhe masat e sigurimit të përshtatshme për secilin klasifikim.

2. Kur Komisioni konsideron, se nxjerrja e një informacioni të caktuar mund të cenojë interesat e një ose më shumë Shteteve Anëtare, ai zbaton përkohësisht për këtë informacion klasifikimin e kërkuar për këtë rast nga rregulloret e sigurimit.

Ai i komunikon këtë informacion menjëherë Shteteve Anëtare, të cilat marrin masa për sigurimin e tij përkohësisht në të njëjtën mënyrë.

Shtetet Anëtare e informojnë Komisionin brenda tre muajve nëse ata dëshirojnë të ruajnë klasifikimin e zbatuar përkohësisht, ta zëvendësojnë atë me një tjetër ose ta deklasifikojnë informacionin nga lista e informacionit sekret.

Pas përfundimit të kësaj periudhe zbatohet niveli më i lartë i sigurimit për këto kërkesa. Për këtë arsye, Komisioni njofton Shtetet Anëtare.

Me kërkesën e Komisionit ose të një Shteti Anëtar, Këshilli, me vendim unanimit, mund të aplikojë në çdo kohë një tjetër klasifikim ose të deklasifikojë informacionin. Këshilli merr mendimin e Komisionit para se të merret ndonjë veprim për kërkesën e një Shteti Anëtar.

3. Parashikimet e neneve 12 dhe 13 nuk zbatohen për informacionin që është objekt i klasifikimit të sigurisë.

Megjithatë, me kusht që të jenë respektuar masat e duhura të sigurimit,

(a) Informacioni të cilit i referohet neni 12 dhe 13 mund t'i komunikohet nga Komisioni;

(i) Një Sipërmarrje e Përbashkët;

(ii) Një personi ose sipërmarrje të ndryshme nga një Sipërmarrje e Përbashkët, nëpërmjet Shtetit Anëtar në territorin e të cilit vepron ky person ose kjo sipërmarrje;

(b) Informacioni, të cilit i referohet neni 13, mund t'i komunikohet nga një Shtet Anëtar një person ose një sipërmarrje të ndryshme nga një Sipërmarrje e Përbashkët që vepron në territorin e atij Shteti, me kusht që Komisioni të njoftohet për këtë komunikim.

Për më tepër, çdo Shtet Anëtar ka të drejtë t'i kërkojë Komisionit dhënien e një licence sipas nenit 12, për të plotësuar nevojat e atij shteti ose ato të një personi ose sipërmarrje që vepron në territorin e tij.

#### Neni 25

1. Një Shtet Anëtar që njofton ekzistencën ose që i komunikon përmbajtjen e kërkesës për patentë, ose model përdorimi që lidhet me një çështje të specifikuar në nenin 16 pikat (1) ose (2), kur është e nevojshme, tërheq vëmendjen për nevojën për të zbatuar klasifikimin e dhënë për arsye mbrojtjeje, duke deklaruar në të njëjtën kohë kohëzgjatjen e mundshme të një klasifikimi të tillë.



Komisioni u përcjell të gjithë Shteteve të tjera Anëtare komunikimet e marra në përputhje me nënparagrafin e mësipërm. Komisioni dhe Shtetet Anëtare marrin ato masa, të cilat, sipas rregulloreve të sigurimit, përkojnë me klasifikimin e kërkuar nga shteti i origjinës.

2. Komisioni mund t'ua përcjellë këto komunikime Sipërmarrjeve të Përbashkëta, ose nëpërmjet një Shteti Anëtar, një personi ose sipërmarrjeje me përjashtim të një Sipërmarrjeje të Përbashkët që vepron në territorin e atij shteti.

Shpikjet që janë çështje e kërkesave që u referohet paragrafi 1 mund të përdoren vetëm me pëlqimin e kërkuarit, ose në përputhje me nenet 17 deri në 23.

Komunikimet, dhe kur është e nevojshme përdorimi i tyre, që referohen në këtë paragraf i nënshtrohen masave, të cilat, sipas rregulloreve të sigurimit, korrespondojnë me klasifikimin e sigurimit që kërkohet nga shteti i origjinës.

Komunikimet në të gjitha rastet i nënshtrohen pëlqimit të Shtetit të origjinës. Pëlqimi për komunikimin dhe përdorimin mund të refuzohen vetëm për arsye mbrojtjeje.

3. Me kërkesë të Komisionit ose të një Shteti Anëtar, Këshilli, me votim unanim, mund të zbatohet në çdo kohë një tjetër klasifikim ose deklasifikim të informacionit. Këshilli merr mendimin e Komisionit para marrjes së ndonjë veprimi me kërkesë të një Shteti Anëtar.

#### Neni 26

1. Kur klasifikohet informacioni që trajtohet nga patentat, zbatimet e patentave, të drejtat e patentave të mbrojtura me kusht, modelet e përdorimit ose kërkesat për modele përdorimi në përputhje me nenin 24 dhe 25, shtetet që kanë paraqitur kërkesë për një klasifikim të tillë mund të mos refuzojnë të lejojnë kërkesat përkatëse që të depozitohen në Shtete të tjera Anëtare.

Çdo Shtet Anëtar merr masat e nevojshme për të ruajtur sigurimin e të drejtave të tilla dhe kërkesave në përputhje me procedurën e parashtruar në ligjet dhe në rregulloret e saj.

2. Asnjë kërkesë që lidhet me informacionin e klasifikuar në përputhje me nenin 24 nuk mund të depozitohet jashtë Shteteve Anëtare, me përjashtim të rasteve kur sigurohet një pëlqim unanim prej tyre. Nëse Shtetet Anëtare nuk e bëjnë të ditur qëndrimin e tyre, pëlqimi konsiderohet se është marrë në përfundim të gjashtë muajve nga data në të cilën informacioni i është komunikuar Shteteve Anëtare nga Komisioni.

#### Neni 27

Dëmshpërblimi për çdo dëmtim që i shkaktohet kërkuarit, si rezultat i klasifikimit për arsye mbrojtjeje, mbulohet nga dispozitat e ligjeve kombëtare të Shteteve Anëtare dhe është përgjegjësi e shtetit që paraqet kërkesën për një klasifikim të tillë që ka marrë rinovimin ose shtyrjen e klasifikimit, ose ka shkaktuar ndalimin e depozitimit të kërkesave jashtë Komunitetit.

Kur disa Shtete Anëtare e kanë marrë rinovimin, ose zgjatjen e klasifikimit ose kanë shkaktuar ndalimin e depozitimit të kërkesave jashtë Komunitetit, ato janë bashkërisht përgjegjëse për ndreqjen e dëmit që shkaktohen nga veprimi i tyre.

Komuniteti mund të mos kërkojë dëmshpërblim sipas këtij neni.

## Seksioni IV

## **Dispozita të Posaçme**

### Neni 28

Kur, si rezultat i komunikimit të tyre me Komisionin, kërkesat e pabotuara për patenta ose modele përdorimi, ose për patenta ose modelet e përdorimit të klasifikuara për arsye mbrojtjeje, përdoren jo siç duhet ose i bëhen me dije një personi të paautorizuar, Komuniteti ia kompenson dëmin që i shkaktohet palës së interesuar.

Komuniteti, pa cenuar të drejtat e tij kundrejt personit përgjegjës për dëmin, deri në masën që ka kompensuar dëme të tilla, merr çdo të drejtë veprimi që ata kanë ndaj palëve të treta. Kjo nuk cenon të drejtën e Komunitetit për të ndërmarrë veprime kundër personit që është përgjegjës për dëmin, në përputhje me dispozitat e përgjithshme në fuqi.

### Neni 29

Kur një marrëveshje ose kontratë për shkëmbimin e informacionit shkencor ose industrial në fushën bërthamore ndërmjet një Shteti Anëtar, një personi ose sipërmarrjeje nga njëra anë, dhe një shteti të tretë, një organizate ndërkombëtare ose një nënshtetasi të një shteti të tretë nga ana tjetër, kërkon nga secila palë nënshkrimin e një shteti që vepron në kapacitetin e tij sovran, marrëveshja përfundohet nga Komisioni.

Sipas dispozitave të neneve 103 dhe 104, Komisioni kur e konsideron të përshtatshme, autorizon një Shtet Anëtar, një person ose një sipërmarrje për të përfunduar një marrëveshje të tillë.

## KAPITULLI III

## SHËNDETI DHE SIGURIA

### Neni 30

Brenda Komunitetit vendosen standarde bazë për mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve dhe të publikut në përgjithësi, kundër rreziqeve që shkaktohen nga rrezatimet jonizuese.

Shprehja “standard bazë” nënkupton:

- (a) Dozat maksimale të lejueshme në përputhje me sigurinë e përshtatshme;
- (b) Nivelet maksimale të lejueshme të ekspozimit dhe të ndotjes;
- (c) Parimet themelore që drejtojnë mbikëqyrjen shëndetësore të punëtorëve.

### Neni 31

Standardet bazë hartohen nga Komisioni, pasi ai merr mendimin e grupit të personave të caktuar nga Komiteti Shkencor dhe Teknik nga radhët e ekspertëve shkencorë, dhe në veçanti, mendimin e ekspertëve të shëndetit publik në Shtetet Anëtare. Komisioni merr mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social për këto standarde bazë.

Pas konsultimit me Parlamentin, Këshilli përcakton standardet bazë me propozim të Komisionit, i cili e bën propozimin mbi bazën e mendimit të marrë prej këtyre Komiteteve; Këshilli vepron vetëm me shumicë të cilësuar.

### Neni 32

Me kërkesë të Komisionit ose të një Shteti Anëtar, standardet bazë mund të rishikohen ose të shtohen në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 31.

Komisioni shqyrton çdo kërkesë që bëhet nga një Shtet Anëtar.

### Neni 33

Çdo Shtet Anëtar parashikon dispozitat e duhura, me anë të legjislacionit, rregulloreve ose veprimeve administrative, për të siguruar përputhshmëri me standardet bazë të përcaktuara, dhe merr masat e nevojshme në lidhje me mësimdhënien, arsimimin dhe trajnimin profesional.

Komisioni bën rekomandimet e nevojshme për harmonizimin e dispozitave të zbatueshme në këtë fushë nga Shtetet Anëtare.

Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit dispozitat e zbatueshme në datën e hyrjes në fuqi të këtij traktati dhe projekt dispozitat e tjera vijuese të së njëjtës natyrë.

Çdo rekomandim që mund të dëshirojë të nxjerrë Komisioni në lidhje me projektdispozita të tilla bëhet brenda tre muajve nga data e komunikimit të këtyre projekt dispozitave.

### Neni 34

Çdo Shtet Anëtar në territorin e të cilit do të zhvillohen eksperimente veçanërisht të rrezikshme merr masa shëndetësore dhe sigurie shtesë, për të cilat shteti duhet të marrë paraprakisht mendimin e Komisionit.

Pëlqimi i Komisionit kërkohet kur rezultatet e eksperimenteve të tilla ka të ngjarë të kenë ndikim mbi territorin e Shteteve të tjera Anëtare.

### Neni 35

Çdo Shtet Anëtar përcakton mjetet e nevojshme për të kryer monitorim të vazhdueshëm të nivelit të radioaktivitetit në ajër, ujë, dhe tokë, dhe për të siguruar përputhshmërinë me standardet bazë.

Komisioni ka të drejtën e përdorimit të mjeteve të tilla: ai mund të verifikojë funksionimin dhe efikasitetin e tyre.

### Neni 36

Autoritetet përkatëse i komunikojnë Komisionit në mënyrë periodike informacionin për kontrollet e përcaktuara në nenin 35, në mënyrë që Komisioni të jetë i informuar për nivelin e radioaktivitetit ndaj të cilit është i ekspozuar publiku.

### Neni 37

Çdo Shtet Anëtar i jep Komisionit të dhëna të tilla, të përgjithshme, që lidhen me çdo plan për hedhjen e mbetjeve radioaktive në atë formë që e lejon atë të përcaktojë, nëse zbatimi i këtij plani çon në ndotjen radioaktive të ujit, tokës ose hapësirës ajrore të një Shteti tjetër Anëtar.

Komisioni jep mendimin e tij brenda gjashtë muajve pas konsultimit me grupin e ekspertëve të cilit i referohet neni 31.

### Neni 38

Komisioni u bën rekomandime Shteteve Anëtare në lidhje me nivelin e radioaktivitetit në ajër, ujë dhe tokë.

Në raste urgjencash, Komisioni nxjerr një direktivë që u kërkon Shteteve Anëtare të përfshira, të marrin të gjitha masat e nevojshme, brenda një periudhe të përcaktuar nga Komisioni, për të parandaluar cenimin e standardeve bazë dhe për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret.

Nëse shteti në fjalë nuk arrin të zbatojë direktivën e Komisionit brenda periudhës së parashikuar, Komisioni ose çdo Shtet Anëtar i përfshirë, duke u shmangur nga nenet 141 dhe 142, mund ta çojë menjëherë çështjen para Gjykatës së Drejtësisë.

### Neni 39

Komisioni, brenda kuadrit të Qendrës së Përbashkët të Kërkimit Bërthamor, menjëherë pas krijimit të saj, krijon një dokumentacion shëndeti dhe sigurie, si dhe seksionin e studimit.

Ky seksion, në veçanti ngarkohet me detyrat e mbledhjes së dokumentacionit dhe informacionit të cilit i referohen nenet 33, 36 dhe 37 dhe dhënies së ndihmës Komisionit për të kryer detyrat që i janë caktuar atij në këtë Kapitull.

## KAPITULLI IV

### INVESTIMET

#### Neni 40

Në mënyrë që të nxiten veprimet nga personat dhe sipërmarrjet, dhe të lehtësohet zhvillimi i koordinuar i investimeve të tyre në fushën bërthamore, Komisioni boton në mënyrë periodike programe ilustruese, që dëshmojnë në veçanti objektivat e prodhimit të energjisë bërthamore dhe të gjitha llojet e investimeve që nevojiten për përmbushjen e tyre.

Komisioni merr mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social për programe të tilla para botimeve të tyre.

#### Neni 41

Personat dhe sipërmarrjet e përfshira në aktivitetet industriale, të renditura në Shtojcën II të këtij traktati, i komunikojnë Komisionit projekte investimi që lidhen me instalimet e reja dhe me zëvendësime ose shndërrime që plotësojnë kriteret për sa i përket llojit dhe përmasës, siç përcaktohet nga Këshilli me propozim të Komisionit.

Lista e aktiviteve industriale që përmendet më lart mund të ndryshohet nga Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar mbi propozimin e Komisionit, pas marrjes së mendimit paraprak të Komitetit Ekonomik dhe Social.

#### Neni 42

Projektet që përmenden në nenin 41 i komunikohen Komisionit, dhe për qëllime informuese, edhe Shteteve Anëtare përkatëse jo më vonë se tre muaj para mbylljes së kontratave të para me furnizuesit, ose nëse puna kryhet nga sipërmarrja me burimet e tyre, tre muaj para fillimit të punës.

Këshilli, duke vepruar me propozim të Komisionit, mund ta ndryshojë këtë afat kohor.

#### Neni 43

Komisioni diskuton me personat ose sipërmarrjet të gjitha aspektet e projekteve të investimit që lidhen me objektivat e këtij traktati.

Ai i komunikon pikëpamjet e tij Shteteve Anëtare përkatëse.

#### Neni 44

Me pëlqimin e Shteteve Anëtare, personave dhe sipërmarrjeve të përfshira, Komisioni boton çdo projekt investimi që i komunikohet atij.

## KAPITULLI V

### SIPËRMARRJET E PËRBASHKËTA

#### Neni 45

Sipërmarrjet që janë të një rëndësie shumë të madhe për zhvillimin e industrisë atomike të Komunitetit mund të krijohen si sipërmarrje të përbashkëta brenda kuptimit të këtij traktati, në përputhje me nenet e mëposhtme.

#### Neni 46

1. Çdo projekt për krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët, pavarësisht nëse rrjedh nga Komisioni, një Shtet Anëtar ose një burim tjetër, është objekt hetimi nga Komisioni.

Për këtë qëllim, Komisioni merr pikëpamjet e Shteteve Anëtare dhe të çdo organi publik ose privat, që sipas mendimit të Komisionit mund të japë këshilla të dobishme.

2. Komisioni i dërgon Këshillit çdo projekt për krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët, së bashku me mendimin e tij të arsyetuar.

Nëse Komisioni jep një mendim të favorshëm për nevojën e krijimit të sipërmarrjes së përbashkët të propozuar, ai i dërgon Këshillit propozime që lidhen me:

- (a) Vendndodhjen;
- (b) Statutet;
- (c) Masën dhe planin e financimit;
- (d) Pjesëmarrjen e mundshme nga Komuniteti në financimin e sipërmarrjes së përbashkët;
- (e) Pjesëmarrjen e mundur nga një shtet i tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një shtet kombëtar i një shteti të tretë në financimin ose menaxhimin e sipërmarrjes së përbashkët;
- (f) Dhënien e njëres ose të gjitha avantazheve të renditura në Shtojcën III të këtij traktati.

Komisioni bashkëngjit një raport të detajuar për projektin në tërësi.

#### Neni 47

Këshilli, kur çështja i dërgohet atij nga Komisioni, mund t'i kërkojë këtij të fundit të japë informacione të mëtejshme ose të bëjë hetime të mëtejshme, nëse çmohen të nevojshme nga Këshilli.

Nëse Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar, gjykon se duhet të kryhet një projekt pavarësisht nga mendimi jo i favorshëm i Komisionit, Komisioni i dërgon Këshillit propozimet dhe raportin e detajuar që përmenden në nenin 46.

Kur mendimi i Komisionit është i favorshëm, ose në rastin të cilit i referohet paragrafi më lart, Këshilli voton me shumicë të cilësuar për secilin nga propozimet e Komisionit.

Këshilli voton me unanimitet në lidhje me:

- (a) Pjesëmarrjen e Komunitetit në financimin e sipërmarrjes së përbashkët;
- (b) Pjesëmarrjen e një shteti të tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas i një shteti të tretë në financimin ose menaxhimin e sipërmarrjes së përbashkët.

#### Neni 48



Këshilli, me votim unanim mbi një propozim të Komisionit, mund të zbatojë në secilën sipërmarrje të përbashkët çdonjërin ose të gjitha përparësitë e renditura në Shtojcën III të këtij traktati; çdo Shtet Anëtar nga ana e tij siguron ofrimin e këtyre përparësive.

Këshilli, në përputhje me të njëjtën procedurë, përcakton kushtet që lidhen me respektimin e ofrimit të këtyre përparësive.

#### Neni 49

Sipërmarrjet e përbashkëta krijohen me vendim të Këshillit.

Çdo sipërmarrje e përbashkët ka personalitet juridik.

Në secilin nga Shtetet Anëtare, sipërmarrja gëzon kapacitetin juridik më të madh që i jepet personave juridikë sipas ligjeve përkatëse kombëtare; ajo mund të blejë ose shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe mund të jetë palë në procese gjyqësore.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë traktat ose në statutet e tyre, çdo sipërmarrje e përbashkët drejtohet nga rregullat që zbatohen për sipërmarrjet industriale ose tregtare; statutet e saj mund t'i referohen në mënyrë suplementare ligjeve kombëtare të Shteteve Anëtare.

Me përjashtim të rasteve kur juridiksioni për raste të mosmarrëveshjeve të sipërmarrjeve të përbashkëta i caktohet Gjykatës së Drejtësisë në këtë traktat, mosmarrëveshjet në të cilat përfshihen këto sipërmarrje të përbashkëta zgjidhen nga gjykatat e zakonshme ose gjykatat e posaçme kombëtare.

#### Neni 50

Statutet e sipërmarrjeve të përbashkëta ndryshohen, kur është e nevojshme, në përputhje me dispozitat e posaçme që përmbajnë këtë qëllim.

Ndryshime të tilla nuk hyjnë në fuqi nëse nuk miratohen nga Këshilli, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 47 me propozim të Komisionit.

#### Neni 51

Deri në ngritjen e organeve përgjegjëse për funksionimin e sipërmarrjeve të përbashkëta, Komisioni është përgjegjës për të ekzekutuar të gjitha vendimet e Këshillit që lidhen me krijimin e këtyre sipërmarrjeve.

## KAPITULLI VI

## FURNIZIMET

### Neni 52

1. Furnizimet me xeherorë, materiale burimore, dhe materiale të veçanta të zërthyeshme sigurohen në përputhje me parashikimet e këtij kapitulli nëpërmjet një politike të përbashkët furnizimi, në bazë të parimit të mundësive të barabarta në burimet e furnizimit.

2. Për këtë qëllim dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë kapitull:

- (a) Ndalohen të gjitha praktikrat që synojnë sigurimin e një pozicioni të privilegjuar për përdorues të caktuar;
- (b) Krijohet një Agjenci e cila ka të drejtë të përzgjedhë xeherorët, materialet burimore dhe materiale të veçanta të zërthyeshme të prodhuara në territoret e Shteteve Anëtare, si dhe të drejtën ekskluzive për të përfunduar kontrata që lidhen me furnizimin e xeherorëve, materialeve burimore dhe materialeve të veçanta të zërthyeshme që vijnë nga brenda ose jashtë Komunitetit.

Agjencia nuk mund të diskriminojë në asnjë mënyrë përdoruesit për shkaqe të përdorimit që synojnë të përdorin nga furnizimi i kërkuar, në përjashtim të rasteve kur një përdorim i tillë nuk është i ligjshëm, ose rezulton të jetë në kundërshtim me kushtet e vendosura nga furnizuesit jashtë Komunitetit për ngarkesën në fjalë.

## Seksioni I

## Agjencia

### Neni 53

Agjencia mbikëqyret nga Komisioni, i cili nxjerr direktiva për të, ka të drejtën e vetos mbi vendimet e saj dhe cakton Drejtorin e Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm të saj.

Çdo veprim, i nënkuptuar ose i shprehur, i kryer nga Agjencia gjatë ushtrimit të së drejtës së saj të zgjedhjes ose të drejtës së saj ekskluzive për të përfunduar kontratat e furnizimit, mund t'i referohet Komisionit nga palët e përfshira, dhe Komisioni jep vendim brenda një muaji.

### Neni 54

Agjencia ka personalitet juridik dhe autonomi financiare.

Këshilli, me propozim të Komisionit, përcakton statutet e Agjencisë, duke votuar me shumicë të cilësuar.

Statutet mund të ndryshohen në përputhje me të njëjtën procedurë.

Statutet përcaktojnë kapitalin e Agjencisë dhe kushtet në të cilat duhet të përdoren ato. Pjesa më e madhe e kapitalit i përket gjithmonë Komunitetit dhe Shteteve Anëtare. Kontributet për kapitalin përcaktohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet Shteteve Anëtare.

Rregullat për menaxhimin tregtar të aktiviteteve të Agjencisë përcaktohen në statutet e saj. Këto të fundit mund të parashikojnë një tarifë për transaksionet që mbulojnë shpenzimet operative të Agjencisë.

### Neni 55

Shtetet Anëtare komunikojnë ose shkaktajnë komunikimin e të gjithë informacionit të nevojshëm në Agjenci, për ta lejuar atë të ushtrojë të drejtën e saj për dhënie mendimi dhe të drejtën e saj ekskluzive për të përfunduar kontrata furnizimi.

### Neni 56

Shtetet Anëtare janë përgjegjëse për të siguruar se Agjencia vepron lirisht në territoret e tyre.

Ato mund të krijojnë një ose më shumë organe me kompetencë për të përfaqësuar, në lidhje me Agjencinë, prodhuesit dhe përdoruesit në territoret joeuropiane nën juridiksionet e tyre.

## Seksioni II

### **Xeherorët, materialet burimore dhe materialet e veçanta të zbërthyeshme që vijnë nga brenda Komunitetit**

### Neni 57

1. E drejta e përzgjedhjes së Agjencisë përfshin:

- (a) Blerjen e të drejtave për të përdorur dhe konsumuar materiale që zotërohen nga Komuniteti, sipas parashikimeve të Kapitullit VIII;
- (b) Blerjen e së drejtës së pronësisë në të gjitha rastet e tjera.

2. Agjencia ushtron të drejtat e saj të zgjedhjes duke përfunduar kontrata me prodhuesit e xeherorëve, materialeve burimore, dhe materialeve të veçanta të zbërthyeshme.

Në bazë të neneve 58, 62 dhe 63, çdo prodhues i ofron Agjencisë xeherorët, materialet burimore ose materialet e veçanta të zbërthyeshme, që prodhohen brenda territoreve të Shteteve Anëtare para se ata të përdoren, transferohen ose ruhen.

#### Neni 58

Kur një prodhues kryen disa etapa prodhimi, nga nxjerrja e xeherorëve deri në prodhimin e metalit, duke përfshirë dhe prodhimin e mineralit, ai mund t'i ofrojë produktin Agjencisë në çdo etapë prodhimi që përcaktohet prej tij.

E njëjta gjë zbatohet dhe për dy ose më shumë sipërmarrje, kur lidhja i është komunikuar në kohë Komisionit dhe kur është diskutuar me të në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 43 dhe 44.

#### Neni 59

Në rast se Agjencia nuk e ushtron të drejtën e saj të zgjedhjes në tërësi ose pjesërisht të produktit të prodhuesit, ky i fundit,

- (a) Duke përdorur burimet e tij ose sipas kontratës, mund të përpunojë ose shkaktojë përpunimin e xeherorëve, materialeve burimore ose materialeve të veçanta të zbërthyeshme, me kushtin që ai i ofron Agjencisë produktin e këtij përpunimi;
- (b) Me anë të një vendimi të Komisionit, autorizohet të nxjerrë prodhimin që ai zotëron jashtë Komunitetit, me kusht, që kushtet që ofrohen prej tij të mos jenë më të favorshme se kushtet që i janë ofruar më parë Agjencisë. Materialet e veçanta të zbërthyeshme mund të eksportohen vetëm nëpërmjet Agjencisë dhe në përputhje me parashikimet e nenit 62.

Komisioni mund të mos e japë një autorizim të tillë, nëse marrësi i furnizimeve nuk e përmbush kriterin e ruajtjes së interesave të përgjithshme të Komunitetit, ose në rast se afatet dhe kushtet e kontratave të tilla janë në kundërshtim me objektivat e këtij traktati.

#### Neni 60

Përdoruesit e mundshëm informojnë në mënyrë periodike Agjencinë për furnizimet që kërkohen prej tyre, duke specifikuar masat, natyrën fizike dhe kimike, vendin e origjinës, përdorimin e synuar, datat e prurjeve dhe kushtet e pagesës, të cilat formojnë afatet dhe kushtet e kontratës së furnizimit që ata duan të përfundojnë.

Në të njëjtën mënyrë, prodhuesit informojnë Agjencinë për ofertat që ata janë në gjendje të bëjnë, duke deklaruar të gjitha specifikimet, dhe në veçanti kohëzgjatjen e kontratave që kërkohen, për të bërë të mundur përpilimin e programeve të prodhimit. Programe të tilla nuk zgjatin më shumë se dhjetë vjet, në përjashtim të rasteve kur është arritur marrëveshja e Komisionit.

Agjencia informon të gjithë përdoruesit e mundshëm për ofertat dhe volumin e kërkesave që ka marrë, dhe u bën thirrje atyre të ofrojnë porositë e tyre në një afat kohor të specifikuar.

Kur agjencia i merr të gjitha këto porosi, ajo bën me dije kushtet që duhen plotësuar,

Nëse Agjencia nuk përballon në tërësi të gjitha porositë që merren, në përputhje me parashikimet e neneve 68 dhe 69, ajo ndan në përpjesëtim të drejtë furnizimet ndërmjet porosive që lidhen me secilën ofertë.

Rregullat e Agjencisë, të cilat kërkojnë miratimin e Komisionit, përcaktojnë mënyrën në të cilën ekuilibrohen porositë me ofertën.

## Neni 61

Agjencia plotëson të gjitha porosinë, me përjashtim të rasteve kur kjo gjë ndalohe nga pengesa ligjore ose materiale.

Kur përfundon një kontratë, Agjencia, ndërsa respekton parashikimet e nenit 52, mund t'u kërkojë përdoruesve të bëjnë parapagesat e duhura ose në formë garancish, ose të ndihmojnë në plotësimin e angazhimeve afatgjatë të Agjencisë për prodhuesit, kur këto janë të domosdoshme për ekzekutimin e porosisë.

## Neni 62

1. Agjencia ushtron të drejtën e zgjedhjes për materialet e veçanta të zërthyeshme që prodhohen në territoret e Shteteve Anëtare në mënyrë që të:

- (a) përmbushë kërkesat nga përdoruesit brenda Komunitetit, në përputhje me nenin 60; ose
- (b) ruajë këtë material vetë/ose
- (c) eksportojë materiale të tilla me autorizimin e Komisionit, në përputhje me parashikimet e nënparagrafit të dytë të nenit 59 pika (b).

2. Megjithatë, ndërsa vazhdojnë të jenë objekt i dispozitave të Kapitullit VII, materiale të tilla dhe çdo mbetje e riprodhueshme mbetet në pronësinë e prodhuesit, kështu që ai mund:

- (a) t'i ruajë ato me autorizimin e Agjencisë, ose;
- (b) t'i përdorë ato brenda kufijve të kërkesave të tij, ose;
- (c) t'i bëjë ato të disponueshme për sipërmarrjet në Komunitet, brenda kufijve të kërkesave të tyre, ku, për realizimin e një programi që i është komunikuar sipas rregullave Komisionit, këto sipërmarrje kanë me prodhuesin një lidhje të drejtpërdrejtë, që nuk ka as qëllimin dhe as efektin e kufizimit të prodhimit, zhvillimit teknik ose investimit, ose të krijimit të pabarazive në mënyrë jo të drejtë ndërmjet përdoruesve në Komunitet.

3. Parashikimet e nenit 89 paragrafi (1) pika (a) zbatohen për materiale të veçanta të zërthyeshme që prodhohen në territoret e Shteteve Anëtare, dhe për të cilat Agjencia nuk ka ushtruar të drejtat e saj të zgjedhjes.

## Neni 63

Xeherorët, materialet burimore dhe materialet e veçanta të zërthyeshme, të prodhuara nga sipërmarrjet e përbashkëta do t'i ndahen përdoruesve sipas rregullave të parashikuara në statutet dhe marrëveshjet e këtyre sipërmarrjeve.

## Seksioni III

**Xeherorët, materialet burimore dhe materialet e veçanta të zërthyeshme që vijnë nga jashtë Komunitetit**

## Neni 64

Agjencia duke vepruar, kur është e nevojshme, brenda kuadrit të marrëveshjeve të përfunduara ndërmjet Komunitetit dhe një shteti të tretë ose një organizate ndërkombëtare, përveç rasteve të përjashtimeve që parashikohen në këtë traktat, gëzon të drejtën ekskluzive të lidhë marrëveshje ose kontrata, qëllimi kryesor i të cilave është të bëjë furnizimin me xeherorë, materiale burimore ose materiale të veçanta të zërthyeshme që vijnë nga jashtë Komunitetit.

## Neni 65

Neni 60 zbatohet për kërkesat nga përdoruesit dhe për kontratat ndërmjet përdoruesve dhe Agjencisë, në lidhje me furnizimin me xeherorëve, materialeve burimore ose materiale të veçanta të zbërthyeshme që vijnë nga jashtë Komunitetit.

Gjithsesi, Agjencia vendos për origjinën gjeografike të furnizimeve, me kusht që kushtet të cilat janë të paktën aq favorizuese sa kushtet e specifikuar në urdhër janë të garantuara për përdoruesin.

## Neni 66

Nëse Komisioni, mbi bazën e kërkesave të përdoruesve të përfshirë, identifikon se Agjencia nuk është në gjendje të sigurojë brenda një kohe të arsyeshme të gjitha furnizimet ose pjesë të furnizimeve të porositura, ose që mund ta bëjë këtë gjë me çmime shumë të larta, përdoruesit kanë të drejtë të përfundojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë kontrata që lidhen me furnizimet nga jashtë Komunitetit, me kusht që kontrata të tilla të plotësojnë në aspekte thelbësore kërkesat e specifikuar në porositë e tyre.

Kjo e drejtë jepet për një periudhë kohore njëvjeçare dhe mund të zgjatet, nëse situata që justifikon dhënien e saj vazhdon.

Përdoruesit që përdorin të drejtën e parashikuar në këtë nen, i komunikojnë Komisionit kontratat e drejtpërdrejta që propozojnë të nënshkruajnë. Komisioni, brenda një muaji, mund të kundërshtojë përfundimin e kontratave të tilla, nëse ato janë në kundërshtim me objektivat e këtij traktati.

## Seksioni IV

### Çmimet

## Neni 67

Në përjashtim të rasteve kur ky traktat parashikon përjashtime, çmimet përcaktohen si rezultat i balancimit të kërkesës me ofertën, siç parashikohet në nenin 60; rregulloret kombëtare të Shteteve Anëtare nuk ndërhyjnë në parashikime të tilla.

## Neni 68

Praktikat e çmimeve që synojnë sigurimin e një pozicioni të privilegjuar për përdorues të caktuar, në kundërshtim me parimin e mundësive të barabarta të parashikuar në dispozitat e këtij Kapitulli janë të ndaluara.

Nëse Agjencia zbulon se përdoren praktika të tilla, ajo ia raporton këto praktika Komisionit.

Komisioni, nëse pranon zbulime të tilla, mund të përcaktojë çmimet e ofertave në fjalë në një nivel që përputhet me parimin e mundësive të barabarta.

## Neni 69

Këshilli mund të vendosë çmime, me votim unanim, me propozim të Komisionit.

Kur Agjencia përcakton kushtet në të cilat mund të plotësohen porositë, në përputhje me nenin 60, ajo mund t'u propozojë përdoruesve që kanë bërë porosi që të barazojnë çmimet.

## Seksioni V

### **Dispozita që lidhen me politikën e furnizimit**



## Neni 70

Brenda kufijve të parashikuar në buxhetin e Komunitetit, Komisioni, sipas kushteve të përcaktuara prej tij, mund të japë mbështetje financiare për programet e ardhshme në territoret e Shteteve Anëtare.

Komisioni mund t'u bëjë rekomandime Shteteve Anëtare me idenë e zhvillimit në të ardhmen dhe shfrytëzimit të depozitave minerale.

Shtetet Anëtare i dorëzojnë çdo vit Komisionit një raport për zhvillimin e perspektivës dhe prodhimit, për rezervat e mundshme, dhe investimet e bëra ose të planifikuara në territoret e tyre për minierat. Raporti i dorëzohet Këshillit së bashku me një mendim nga Komisioni, i cili jep në veçanti se cilat janë veprimet e ndërmarra nga Shtetet Anëtare pas rekomandimeve që u janë bërë atyre sipas paragrafit të mësipërm.

Në rastin kur çështja i dërgohet Komisionit nga Këshilli, ky i fundit vendos me votim me shumicë të cilësuar, se megjithëse mundësitë për nxjerrje duken të justifikuara nga pikëpamja ekonomike në kuadrin afatgjatë, aktivitetet në të ardhmen dhe zgjerimi i operacioneve të minierave vazhdon të jetë dukshëm i papërshtatshëm, Shteti Anëtar i prekur, për sa kohë nuk ka qenë i aftë ta përmirësojë këtë situatë, konsiderohet se i ka hequr vetes dhe nënshtetasve të tij të drejtën e mundësive të barabarta për burimet e tjera të furnizimit brenda Komunitetit.

## Neni 71

Komisioni i bën të gjitha rekomandimet e nevojshme Shteteve Anëtare në lidhje me të ardhurat ose rregulloret e minierave.

## Neni 72

Agjencia, nga materialet e disponueshme brenda ose jashtë Komunitetit, mund të krijojë stoqet e nevojshme tregtare për të lehtësuar furnizimet ose për furnizime normale nga Komuniteti.

Kur është e nevojshme, Komisioni mund të vendosë të krijojë stoqe për raste urgjente. Metoda e financimit të stoqeve të tilla miratohet nga Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar mbi bazën e një propozimi nga Komisioni.

## Seksioni VI

### **Dispozita të Posaçme**

## Neni 73

Kur një marrëveshje ose një kontratë ndërmjet një Shteti Anëtar, një personi ose një sipërmarrjeje nga njëra anë, dhe një shteti të tretë, një marrëveshjeje ndërkombëtare ose një nënshtetasi të një shteti të tretë nga ana tjetër parashikon *inter alia* ofrimin e produkteve që vijnë brenda zonës së shtrirjes së Agjencisë, kërkohet miratimi paraprak i Këshillit për përfundimin ose rinovimin e asaj marrëveshjeje ose kontrate kur bëhet fjalë për furnizimin e produkteve.

## Neni 74

Komisioni përjashton nga dispozitat e këtij kapitulli transferimin, importimin ose eksportimin e sasive të vogla të xeherorëve, materialeve burimore ose materialeve të veçanta të zërthyeshme siç përdoren normalisht në kërkim.

Agjencia njoftohet për çdo transfertë, import ose eksport që kryhet sipas kësaj dispozite.

#### Neni 75

Dispozitat e këtij kapitulli nuk zbatohen për angazhimet që lidhen me përpunimin, shndërrimin ose dhënien e formës xeherorëve, materialeve burimore ose materialeve të veçanta të zbrërthyeshme dhe të lidhura ndërmjet,

- (a) Disa personave ose sipërmarrjeve, kur materiali i kthehet personit ose sipërmarrjes fillestare pas përpunimit, shndërrimit ose dhënies së formës, ose;
- (b) Një personi ose sipërmarrjeje dhe një organizate ndërkombëtare ose një shtetasi të një shteti të tretë, kur materiali është përpunuar, shndërruar ose i është dhënë formë jashtë Komunitetit, dhe më pas i kthehet personit ose sipërmarrjes fillestare, ose;
- (c) Një personi ose sipërmarrjeje dhe një organizate ndërkombëtare ose një nënshtetasi të një shteti të tretë, kur materiali është përpunuar, shndërruar ose i është dhënë formë brenda Komunitetit, dhe më pas i kthehet organizatës, nënshtetasit të origjinës ose çdo marrësi ngarkese jashtë Komunitetit që caktohet nga një organizatë ose nënshtetas i tillë.

Personat dhe sipërmarrjet e përfshira njoftojnë Agjencinë për praninë e angazhimeve të tilla, dhe sapo të nënshkruhen kontratat, e informojnë atë për sasinë e materialeve të përfshira në lëvizje. Komisioni mund të parandalojë angazhimet që i referohen nënparagrafit (b), nëse konsiderohet se shndërrimi ose dhënia e formës nuk mund të kryhen me efikasitet dhe me siguri dhe pa shkaktuar humbjen e materialit në dëm të Komunitetit.

Materialet me të cilat lidhen angazhime të tilla, në territoret e Shteteve Anëtare, janë objekt i ruajtjes së parashikuar në Kapitullin VII. Dispozitat e Kapitullit VIII, nuk janë të zbatueshme për materiale të veçanta të zbrërthyeshme të mbuluara nga angazhimet e përmendura në nënparagrafin (c).

#### Neni 76

Me iniciativën e një Shteti Anëtar ose të Komisionit, dhe në veçanti, nëse rrethanat e parashikuara krijojnë një situatë të një mungese të përgjithshme, Këshilli, me votim unanim, me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin, mund të ndryshojë parashikimet e këtij kapitulli. Komisioni heton në lidhje me çdo kërkesë që bëhet nga një Shtet Anëtar.

Shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të këtij traktati, Këshilli mund të miratojë këto dispozita në tërësi. Në rast mosmiratimi, miratohen dispozita të reja të lidhura me objektin e këtij kapitulli në përputhje me procedurën e paraqitur në paragrafin më lart.

## KAPITULLI VII

## GARANCITË

### Neni 77

Në përputhje me dispozitat e këtij kapitulli, Komisioni siguron që në territorin e Shteteve Anëtare:

- (a) xeherorët, materialet burimore dhe materialet e veçanta të zërthyeshme nuk ndryshojnë përdorimet e synuara të deklaruara nga përdoruesit;
- (b) të respektohen dispozitat që lidhen me furnizimin dhe mbrojtjen e veçantë të detyrimeve që merren nga Komunitetit sipas një marrëveshjeje të përfunduar me një shtet të tretë ose një organizatë ndërkombëtare.

### Neni 78

Çdokush që krijon ose drejton një instalim për prodhimin, ndarjen ose përdorim tjetër të materialeve burimore ose materiale të veçanta të zërthyeshme, ose për përpunimin e lëndëve rrezatuese bërthamore i deklaron Komisionit karakteristikat bazë teknike të instalimeve deri në masën që njohja e këtyre karakteristikave është e nevojshme për arritjen e objektivave që parashikohen në nenin 77.

Komisioni duhet të miratojë teknikat që përdoren për përpunimin kimik të materialeve rrezatuese në masën e nevojshme për të arritur objektivat e parashikuara në nenin 77.

### Neni 79

Komisioni kërkon që të dhënat operative të mbahen dhe të prodhohen në mënyrë që të lejohet kontabiliteti për prodhimin ose përdorimin e xeherorëve, materialeve burimore dhe materialeve të veçanta të zërthyeshme. E njëjta kërkesë zbatohet në rastin e transportimit të materialeve burimore dhe të materialeve të veçanta të zërthyeshme.

Ata që janë objekt i kërkesave të tilla njoftojnë autoritetet e Shtetit Anëtar në fjalë për komunikimet që i bëjnë Komisionit, në përputhje me nenin 78 dhe me paragrafin e parë të këtij neni.

Natyra dhe masa e kërkesave të cilave u referohet paragrafi i parë i këtij neni përcaktohen në një rregullore të hartuar nga Komisioni dhe të miratuar nga Këshilli.

### Neni 80

Komisioni mund të kërkojë që çdo material i veçantë i zërthyeshëm që është i tepërt dhe që zbulohet ose përftohet si nënprodukt, si dhe që aktualisht nuk është nën përdorim ose gati për përdorim, depozitohet në Agjenci ose në pika të tjera të cilat mbikëqyren ose mund të mbikëqyren nga Komisioni.

Materialet e veçanta të zërthyeshme, të depozituara në këtë mënyrë duhet t'u kthehen palëve të përfshira me kërkesën e tyre.

### Neni 81

Komisioni mund të dërgojë inspektorë në territoret e Shteteve Anëtare. Përpara se të dërgojë një inspektor në detyrën e tij të parë në territorin e një Shteti Anëtar, Komisioni konsultohet me shtetin përkatës; një konsultim i tillë është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha detyrat e inspektorit në të ardhmen.

Me paraqitjen e një dokumenti që përcakton autoritetin e tyre, inspektorët në çdo kohë kanë mundësi hyrjeje në të gjitha vendet dhe mundësi përdorimi të të dhënave dhe komunikimi me të gjithë personat, të cilët për shkak të

punës së tyre merren me materiale, pajisje ose instalime që janë objekt i ruajtjes që parashikon ky kapitull, në masën e nevojshme, në mënyrë që ruajtje të tilla të zbatohen për xeherorët, materialet burimore dhe materiale të veçanta të zbërthyeshme, dhe për të siguruar përputhshmërinë me nenin 77. Nëse kërkohet nga shteti përkatës, inspektorët e caktuar nga Komisioni shoqërohen nga përfaqësues të autoriteteve të atij shteti; gjithsesi, në këtë rast inspektorëve nuk u shkaktohen vonesa ose pengesa të tjera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Në rast se kundërshtohet kryerja e inspektimit, Komisioni i kërkon Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë të nxjerrë një urdhër për të siguruar kryerjen e inspektimit në mënyrë të detyrueshme. Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë e nxjerr vendimin brenda tri ditëve.

Nëse ka rrezik vonese, Komisioni vetë mund të nxjerrë një urdhër me shkrim në formën e një vendimi, për të vijuar me inspektimin. Ky urdhër i dërgohet pa vonesë Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë për miratim vijues.

Pas nxjerrjes së urdhrit ose të vendimit, autoritetet e shteteve përkatëse sigurojnë që inspektorët kanë mundësi hyrjeje në vendet e specifikuar në urdhër ose vendim.

#### Neni 82

Inspektorët merren në punë nga Komisioni.

Ata janë përgjegjës për marrjen dhe verifikimin e të dhënave të cilave u referohet neni 79. Ata i raportojnë çdo shkelje Komisionit.

Komisioni mund të nxjerrë një direktivë që i bën thirrje Shtetit Anëtar të interesuar të marrë brenda një afati kohor të parashikuar nga Komisioni, të gjitha masat e nevojshme për të ndaluar një shkelje të tillë; ai informon Këshillin për sa më lart.

Nëse Shteti Anëtar nuk vepron në përputhje me direktivën e Komisionit sipas afatit kohor të përcaktuar, Komisioni ose Shteti Anëtar përkatës, duke iu shmangur neneve 141 dhe 142, ia referojnë çështjen drejtpërsëdrejti Gjykatës së Drejtësisë.

#### Neni 83

1. Në rast të një shkeljeje të detyrimeve që parashikohen në këtë kapitull nga persona ose sipërmarrje, Komisioni gëzon të drejtën e vendosjes së sanksioneve kundër këtyre personave ose sipërmarrjeve.

Këto sanksione jepen sipas shkallës së shkeljes së kryer:

- (a) paralajmërim
- (b) tërheqje të përfitimeve speciale, si për shembull tërheqje të ndihmës financiare ose teknike
- (c) vendosje e sipërmarrjes për një periudhë jo më shumë se katër muaj nën administrimin e një personi ose bordi të caktuar, me një marrëveshje të përbashkët të Komisionit dhe të Shtetit që ka juridiksion mbi sipërmarrjen;
- (d) tërheqje e plotë ose të pjesshme e materialeve burimore ose materialeve të veçanta të zbërthyeshme.

2. Vendimet e marra nga Komisioni në zbatim të paragrafit 1 dhe që kërkojnë dorëzimin e materialeve janë të zbatueshme. Ato mund të zbatohen në territoret e Shteteve Anëtare në përputhje me nenin 164.

Duke u shmangur nga neni 157, apelimet që i dërgohen Gjykatës së Drejtësisë kundër vendimeve të Komisionit që përmbajnë një ndër sanksionet e parashikuara në paragrafin 1 kanë efekt pezullues. Gjithsesi, Gjykata e Drejtësisë, pas ankimit nga Komisioni ose çdo Shteti Anëtar përkatës, mund të urdhërojë zbatimin e menjëhershëm të vendimit.

Për të siguruar mbrojtjen e interesave që janë cenuar ekziston një procedurë e përshtatshme ligjore.

3. Komisioni mund t'u bëjë rekomandime Shteteve Anëtare në lidhje me ligjet dhe me rregulloret që përcaktohen, për të siguruar përputhshmërinë në territoret e tyre me detyrimet që rrjedhin nga ky kapitull.

4. Shtetet Anëtare sigurojnë zbatimin e sanksioneve, dhe kur është e nevojshme, sigurojnë që shkeljet ndreqen nga ata që i kanë kryer ato.

#### Neni 84

Në zbatimin e garancive, nuk bëhet asnjë diskriminim për shkaqe të përdorimit të synuar të xeherorëve, materialeve burimore dhe materialeve të veçanta të zbërthyeshme.

Qëllimi dhe procedura për garancitë dhe kompetencat e organeve përgjegjëse për zbatimin e tyre kufizohet në arritjen e objektivave të përcaktuara në këtë kapitull.

Garancitë mund të mos shtrihen për materiale që kanë si synim të plotësojnë kërkesat e sigurisë, të cilat janë në rrugën e përpunimit të veçantë për këtë qëllim, ose të cilat pas përpunimit janë në përputhje me planin operativ, të vendosur ose të ruajtur në një godinë ushtarake.

#### Neni 85

Kur kërkohet prej rrethanave të reja, procedurat për zbatimin e garancive të parashikuara në këtë kapitull, me kërkesën e një Shteti Anëtar ose të Komisionit, mund të miratohen nga Këshilli, i cili voton unanimitisht mbi një propozim që i vjen nga Komisioni dhe pas konsultimit me Parlamentin. Komisioni shqyrton kërkesa të tilla të bëra nga një Shtet Anëtar.

## KAPITULLI VIII

## PRONËSIA

### Neni 86

Materialet e veçanta të zërthyeshme janë pronë e Komunitetit.

E drejta e pronësisë e Komunitetit përfshin të gjitha materialet e veçanta të zërthyeshme që janë prodhuar ose importuar nga një Shtet Anëtar, një person ose një sipërmarrje, dhe janë objekt i garancive të parashikuara në Kapitullin VII.

### Neni 87

Shtetet Anëtare, personat ose sipërmarrjet kanë të drejtë të pakufizuar të përdorimit dhe konsumimit të materialeve të veçanta të zërthyeshme, që janë bërë pjesë e pronësisë së tyre në mënyrë të rregullt, sipas detyrimeve të vendosura mbi to nga ky traktat, në veçanti të atyre që lidhen me garancitë, të drejtën e përzgjedhjes që i jepet Agjencisë si dhe shëndetin dhe sigurinë.

### Neni 88

Agjencia mban një llogari të veçantë në emër të Komunitetit, e quajtur “Llogaria Financiare e Materialeve të Veçanta të Zërthyeshme”.

### Neni 89

1. Në Llogarinë Financiare të Materialeve të Veçanta të Zërthyeshme:

- (a) vlera e materialeve të veçanta të zërthyeshme që janë lënë në pronësi ose janë vendosur në përdorim të një Shteti Anëtar, personi ose sipërmarrja i kreditohet Komunitetit dhe i debitohet atij Shteti Anëtar, personi ose sipërmarrjeje;
- (b) vlera e materialeve të veçanta të zërthyeshme të cilat prodhohen dhe importohen nga një Shtet Anëtar, person ose sipërmarrje dhe bëhen pronë e Komunitetit, i debitohen Komunitetit dhe i kreditohen atij Shtetit Anëtar, personi ose sipërmarrje. Një hyrje e tillë bëhet dhe kur një Shtet Anëtar, person ose sipërmarrje i jep Komunitetit materiale të veçanta të zërthyeshme, që më parë janë lënë në pronësi ose janë vënë në përdorim të atij Shteti, personi ose sipërmarrjeje.

2. Ndryshimet në vlerë që prekin sasinë e materialeve të veçanta të zërthyeshme shprehen për qëllime kontabiliteti, në mënyrë të tillë që të mos çojnë në humbje ose fitime për Komunitetin. Çdo humbje ose fitim i ngarkohet llogarisë së mbajtësit.

3. Bilancet që dalin nga transaksionet që përmenden më lart bëhen të pagueshme drejtpërdrejt me kërkesë të kreditorit.

4. Kur Agjencia ndërmerr transaksione për llogari të saj, ajo për qëllime të këtij kapitulli, konsiderohet se është sipërmarrje.

### Neni 90

Kur kërkohet nga rrethanat e reja, dispozitat e këtij kapitulli që lidhen me të drejtën e Komunitetit për pronësinë, me kërkesë të një Shteti Anëtar ose të Komisionit, mund të rregullohen nga Këshilli, që voton unanimisht një



propozim të Komisionit dhe pas konsultimeve me Parlamentin. Komisioni shqyrton çdo kërkesë të tillë të parashtruara nga Shteti Anëtar.

#### Neni 91

Sistemi i pronësisë, që është i zbatueshëm për të gjitha subjektet, materialet dhe asetet që nuk i takojnë Komunitetit sipas këtij kapitulli, përcaktohet nga legjislacioni i secilit Shtet Anëtar.

## KAPITULLI IX

### TREGU I PËRBASHKËT BËRTHAMOR

#### Neni 92

Dispozitat e këtij kapitulli zbatohen për mallrat dhe produktet e specifikuara në listat që janë pjesë përbërese e Shtojcës IV të këtij traktati.

Këto lista, me kërkesë të Komisionit ose të një Shteti Anëtar, mund të ndryshohen nga Këshilli, me propozim të Komisionit.

#### Neni 93

Shtetet Anëtare, një vit pas hyrjes në fuqi të këtij traktati, heqin ndërmjet njëri-tjetrit të gjitha tarifat doganore për importet dhe eksportet, ose taksat që kanë efekt të barasvlefshëm, si dhe të gjitha kufizimet sasiore për importet dhe eksportet në lidhje me:

- (a) produktet në listat A1 dhe A2;
- (b) produktet në listën B, nëse janë objekt i një tarife të përbashkët doganore, dhe nëse shoqërohen nga një certifikatë e lëshuar nga Komisioni që deklaron se këto produkte synohen të përdoren për qëllime bërthamore.

Territoret joeuropiane nën juridiksionin e një Shteti Anëtar mund, gjithsesi, të vazhdojnë të vendosin tarifa importi dhe eksporti ose tatime, që kanë efekte ekuivalente kur ato janë të një natyre ekskluzive fiskale. Nivelet e tarifave dhe të tatimeve të tilla, si dhe i sistemeve që i drejtojnë ato nuk çojnë në diskriminim ndërmjet këtij shteti dhe Shteteve të tjera Anëtare.

#### Neni 94

Shtetet Anëtare krijojnë një tarifë të përbashkët doganore në përputhje me përcaktimet e mëposhtme:

- (a) Në lidhje me produktet që specifikohen në listën A1, tarifa e përbashkët doganore fiksohet në nivelin e tarifës më të ulët në fuqi në çdo Shtet Anëtar më datë 1 janar 1957;
- (b) Në lidhje me produktet e specifikuara në listën A2, Komisioni merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se negociatat ndërmjet Shteteve Anëtare fillojnë brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij traktati. Nëse, për disa nga këto produkte nuk është arritur asnjë marrëveshje brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij traktati, Këshilli me votim me shumicë të cilësuar mbi një propozim të Komisionit, përcakton nivelin e zbatueshëm për tarifat e përbashkëta doganore;
- (c) Tarifa e përbashkët doganore për produkte e specifikuara në listat A1 dhe A2 vihet në zbatim nga fundi i vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij traktati.

#### Neni 95

Këshilli, me votim unanim në bazë të një propozimi nga Komisioni, mund të vendosë për zbatimin e hershëm të taksave në tarifat e përbashkëta doganore për produktet e renditura në listën B, ku një masë e tillë ka prirjen të kontribuojë për zhvillimin e energjisë atomike në Komunitet.

#### Neni 96

Shtetet Anëtare heqin të gjitha kufizimet në bazë të kombësisë që kanë ndikim mbi të drejtën e nënshtetasve të çdo Shteti Anëtar të përfitojnë punësim të specializuar në fushën e energjisë atomike, në varësi të kufizimeve që vijnë si rezultat i kërkesave kryesore të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik.

Pas konsultimeve me Parlamentin, Këshilli, pasi voton me shumicë të cilësuar mbi propozimin e Komisionit, dhe pasi ka kërkuar mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social, mund të nxjerrë direktiva për zbatimin e këtij neni.

#### Neni 97

Për personat fizikë dhe juridikë, qofshin ato publikë ose privatë, të cilët janë nën juridiksionin e një Shteti Anëtar, nuk zbatohet asnjë kufizim në bazë të kombësisë, kur ato dëshirojnë të marrin pjesë në ndërtimin e instalimeve bërthamore të një natyre shkencore ose industriale në Komunitetin.

#### Neni 98

Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar përfundimin e kontratave të sigurimeve që mbulojnë rreziqet bërthamore.

Brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij traktati, Këshilli nxjerr direktiva për zbatimin e këtij neni, pas votimit me shumicë të cilësuar mbi propozimin e Komisionit, pasi ka kërkuar më parë mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social, dhe pas konsultimit me Parlamentin.

#### Neni 99

Komisioni mund të bëjë rekomandime për lehtësimin e lëvizjeve të kapitalit, që synon financimin e aktiviteteve industriale të renditura në listë në Shtojcën II të këtij traktati.

#### Neni 100

Çdo Shtet Anëtar merr përsipër të autorizojë në monedhën e Shtetit Anëtar ku banon kreditori ose përfituesi, çdo pagesë që lidhet me lëvizjen e mallrave, shërbimeve ose kapitaleve, si dhe çdo transfertë kapitali dhe fitimesh, në shkallën që lëvizja e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe personave ndërmjet Shteteve Anëtare të liberalizohet në përputhje me këtë traktat.

## KAPITULLI X

### MARRËDHËNIET ME JASHTË

#### Neni 101

Komuniteti, brenda kufijve të kompetencave dhe të juridiksionit të tij, mund të hyjë në detyrime nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve dhe kontratave me një shtet të tretë, me një organizatë ndërkombëtare ose me një nënshtetas të një shteti të tretë.

Marrëveshje ose kontrata të tilla negocohen nga Komisioni në përputhje me direktivat e Këshillit; ato përfundohen nga Komisioni me miratimin e Këshillit, i cili voton me shumicë të cilësuar.

Marrëveshjet ose kontratat, zbatimi i të cilave nuk kërkon veprim nga Këshilli, dhe të cilat mund të preken nga kufijtë e buxhetit përkatës, negocohen dhe përfundohen vetëm nga Komisioni, i cili e mban Këshillin të informuar.

#### Neni 102

Marrëveshjet ose kontratat e përfunduara me një shtet të tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas të një shteti të tretë, në të cilën përveç Komunitetit, janë palë dhe një ose më shumë Shtete Anëtare, nuk hyn në fuqi deri sa Komisioni të njoftohet nga të gjithë Shtetet Anëtare përkatëse, se ato marrëveshje apo kontrata janë të zbatueshme në përputhje me dispozitat e ligjeve përkatëse kombëtare.

#### Neni 103

Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit projekt marrëveshje ose kontrata me një Shtet të tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas të një shteti të tretë, deri në masën që marrëveshja ose kontrata të tilla lidhen me çështje të parashikuara në fushën e zbatimit të këtij traktati.

Nëse një projekt marrëveshje ose kontratë përmban klauzola që pengojnë zbatimin e këtij traktati, Komisioni, brenda një muaji nga marrja e një komunikimi të tillë, i bën të njohura komentet e tij shtetit përkatës.

Shteti nuk përfundon marrëveshjen e propozuar ose kontratën deri sa të ketë plotësuar vërejtjet e Komisionit, ose pasi ka zbatuar vendimin e Gjykatës së Drejtësisë, që gjykon në mënyrë urgjente zbatimin nga një shtet, për sa i përket përputhshmërisë së klauzolave të propozuara me dispozitat e këtij traktati. Në çdo kohë, Gjykatës së Drejtësisë mund t'i çohet një ankim pasi shteti ka marrë komentet nga Komisioni.

#### Neni 104

Asnjë person ose sipërmarrje që përfundon ose rinovon një marrëveshje ose kontratë me një shtet të tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas të një shteti të tretë pas hyrjes në fuqi të këtij traktati, nuk mund ta përdorë këtë marrëveshje ose kontratë në mënyrë që të shmangë detyrimet e përcaktuara në këtë traktat.

Secili Shtet Anëtar merr masa të tilla që i konsideron të nevojshme në mënyrë që t'i komunikojë Komisionit, me kërkesë të këtij të fundit, të gjithë informacionet që lidhen me marrëveshjet dhe kontratat që lidhen pas hyrjes në fuqi të këtij traktatit, siç parashikohet në të, nga një person ose sipërmarrje me një shtet të tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas i një shteti të tretë. Komisioni mund të kërkojë një komunikim të tillë, vetëm me qëllim verifikimi, që marrëveshje ose kontrata të tilla nuk përmbajnë klauzola që pengojnë zbatimin e këtij traktati.

Me kërkesë të Komisionit, Gjykata e Drejtësisë nxjerr vendim për përputhshmërinë e marrëveshjeve ose kontratave të tilla me dispozitat e këtij traktati.

## Neni 105

Dispozitat e këtij traktati nuk përdoren për të parandaluar zbatimin e marrëveshjeve ose kontratave të lidhura para hyrjes së saj në fuqi nga një Shtet Anëtar, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas i një shteti të tretë, kur marrëveshje të tilla i janë komunikuar Komisionit jo më vonë se tridhjetë ditë nga hyrja në fuqi e këtij traktati.

Marrëveshjet ose kontratat e lidhura në periudhën ndërmjet nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të këtij traktati, nga një person ose një sipërmarrje me një shtet i tretë, një organizatë ndërkombëtare ose një nënshtetas i një shteti të tretë, nuk përdoren si shkaqe për moszbatimin e këtij traktati, nëse, sipas mendimit të Gjykatës së Drejtësisë, e cila merr vendim mbi një ankim të bërë nga Komisioni, një ndër arsyet vendimtare për secilën nga palët në lidhjen e marrëveshjes ose kontratës ishte synim për të shmangur dispozitat e këtij traktati.

## Neni 106

Shtetet Anëtare, të cilat përpara hyrjes në fuqi të këtij traktati kanë lidhur marrëveshje që parashikojnë bashkëpunim në fushën e energjisë atomike me shtetet e treta, kërkohet të zhvillojnë së bashku me Komisionin negociatat e nevojshme me këto shtete të treta, në mënyrë që të sigurohet, se të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshje të tilla të merren përsipër sa më shumë të jetë e mundur nga Komuniteti.

Çdo marrëveshje e re e siguruar nga negociata të tilla kërkon pëlqimin e shtetit ose të Shteteve Anëtare nënshkruese të marrëveshjeve të referuara më lart dhe miratimi të Këshillit që voton me shumicë të cilësuar.

## **TITULLI TRE**

### **DISPOZITAT QË DREJTOJNË INSTITUCIONET**

## KAPITULLI I INSTITUCIONET E KOMUNITETIT

### Seksioni I

#### **Parlamenti**

##### Neni 107

Parlamenti, i cili përbëhet nga përfaqësues të popujve të shteteve të Komunitetit, ushtron kompetenca këshillimore dhe mbikëqyrëse, të cilat i jepen nga ky traktat.

##### Neni 108

1. Parlamenti përbëhet nga përfaqësues që caktohen nga parlamentet përkatëse ndërmjet anëtarëve të tyre, në përputhje me procedurën e parashikuar nga çdo Shtet Anëtar.

2. Numri i këtyre anëtarëve është si më poshtë:

Belgjika .....	14
Gjermania .....	36
Franca .....	36
Italia .....	36
Luksemburgu .....	6
Holanda .....	14

3. Parlamenti bën propozime për zgjedhjet nëpërmjet një votimi të përgjithshëm të drejtpërdrejtë në përputhje me një procedurë të njëzuar në të gjitha Shtetet Anëtare.

Këshilli, me votim unanim, parashikon dispozitat e duhura, të cilat ai ua rekomandon Shteteve Anëtare për miratim në përputhje me kërkesat përkatëse kushtetuese.

##### Neni 109

Parlamenti mbledhet në seancë vjetore. Ai thirret për t'u mbledhur pa kërkesë paraprake të martën e tretë të tetorit.

Parlamenti mund të mbledhet dhe në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të shumicës së anëtarëve të tij ose me kërkesë të Këshillit ose të Komisionit.

##### Neni 110

Parlamenti zgjedh Kryetarin dhe zyrtarët e tij nga radhët e anëtarëve të tij.

Anëtarët e Komisionit mund të marrin pjesë në të gjitha takimet, dhe me kërkesë të tyre mund të dëgjohen në emër të Komisionit.

Komisioni i përgjigjet me gojë ose me shkrim pyetjeve që i drejtohen nga Parlamenti ose nga anëtarët e tij.

Këshilli dëgjohe nga Parlamenti në përputhje me kushtet e parashikuara nga Këshilli në rregulloren e tij.

##### Neni 111

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë traktat, Parlamenti vepron me shumicë absolute të votave të mbledhura.

Kuorumi përcaktohet në rregullore.

#### Neni 112

Parlamenti miraton rregulloren e tij me votim me shumicë të anëtarëve të tij.

Punimet e Parlamentit botohen në mënyrën e parashikuar në rregulloren e tij.

#### Neni 113

Parlamenti diskuton në seancë të hapur raportin e përgjithshëm vjetor, që i dërgohet atij nga Komisioni.

#### Neni 114

Në rast të dorëzimit në Parlament të një mocioni mosbesimi për aktivitetet e Komisionit, Parlamenti nuk voton të paktën për tre ditë pas dorëzimit të mocionit, dhe voton vetëm me votim të hapur.

Në rast se mocioni i mosbesimit dorëzohet nga dy të tretat e shumicës të votave të anëtarëve duke përfaqësuar shumicën e anëtarëve të Parlamentit, të gjithë anëtarët e Komisionit japin dorëheqjen. Ata vijojnë të merren me punët e zakonshme deri sa të zëvendësohen në përputhje me nenin 127.

### Seksioni II

#### **Këshilli**

#### Neni 115

Këshilli kryen detyrat e tij dhe ushtron kompetencat e vendimmarrjes në përputhje me dispozitat e këtij traktati.

Ai merr të gjitha masat brenda kompetencave të tij për të koordinuar veprimet e Shteteve Anëtare dhe të Komunitetit.

#### Neni 116

Këshilli përbëhet nga përfaqësues të Shteteve Anëtare. Çdo qeveri i delegon atij një nga anëtarët e tij.

Posti e Presidentit mbahet për një afat gjashtë mujor nga secili shtet i Këshillit me rotacion, sipas rendit alfabetik të Shteteve Anëtare.

#### Neni 117

Këshilli mblidhet kur thirret nga Kryetari i tij me iniciativën e këtij të fundit, ose me kërkesë të një anëtari të tij ose të Komisionit.

#### Neni 118

1. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë traktat, Këshilli vepron me shumicë të anëtarëve të tij.

2. Kur Këshillit i kërkohet të veprojë me shumicë të cilësuar, votat e anëtarëve të tij llogariten si më poshtë:

Belgjika .....	2
Gjermania .....	4
Franca .....	4
Italia .....	4
Luksemburgu .....	1
Holanda .....	2

Për miratimin e tyre, aktet e Këshillit kërkojnë të paktën:

- Dymbëdhjetë vota pro, kur ky traktat kërkon që ata të miratojnë një propozim të Komisionit,
- Dymbëdhjetë vota pro nga të paktën katër anëtarë në raste të tjera.

3. Abstenimet nga anëtarët të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar nuk pengojnë miratimin nga Këshilli, të akteve që kërkojnë unanimitet.

#### Neni 119

Në rastet kur, në përputhje me këtë traktat, Këshilli voton me propozim të Komisionit, kërkohet unanimiteti për një akt që përbën një amendim të atij propozimi.

Për aq kohë sa Këshilli nuk ka vepruar, Komisioni mund të ndryshojë propozimin e tij fillestar, në veçanti kur janë bërë konsultime me Parlamentin për këtë propozim.

#### Neni 120

Kur votohet, çdo anëtar i Këshillit mund të veprojë gjithashtu në emër të një ose më shumë Shteteve Anëtare.

#### Neni 121

Këshilli miraton rregulloren e tij.

Kjo rregullore mund të parashikojë krijimin e një komisioni që përbëhet nga përfaqësues të Shteteve Anëtare. Këshilli përcakton detyrat dhe kompetencat e këtij komisioni.

#### Neni 122

Këshilli mund t'i kërkojë Komisionit të bëjë studime që konsiderohen si të dëshirueshme nga Këshilli për arritjen e objektivave të përbashkëta dhe t'i dërgojë atij propozimet e nevojshme.

#### Neni 123

Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar, mund të përcaktojë pagat, dietat dhe pensionet për Kryetarin, gjyqtarët, avokatët e përgjithshëm, dhe Kancelarin e Gjykatës së Drejtësisë. Ai, gjithashtu, sërish me anë të një shumice të cilësuar, mund të përcaktojë çdo pagesë që bëhet në vend të shpërblimit.

### Seksioni III

### **Komisioni**



## Neni 124

Në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i energjisë bërthamore brenda Komunitetit, Komisioni:

- Siguron që zbatohen dispozitat e këtij traktati dhe masat e marra nga institucionet në përputhje me këto dispozita;
- Formulon rekomandime ose jep mendime për fushat që trajton traktati, nëse parashikohet shprehimisht kështu nga traktati, ose nëse konsiderohet e nevojshme nga Komisioni;
- Ka kompetencat e tij të vendimmarrjes dhe merr pjesë në formësimin e masave të marra nga Këshilli dhe nga Parlamenti në mënyrën e parashikuar në këtë traktat;
- Ushtron kompetencat që i jepen atij nga Këshilli për zbatimin e rregullave të parashtruara nga ky i fundit.

## Neni 125

Komisioni boton çdo vit, jo më vonë se një muaj para hapjes së seancës së Parlamentit, një raport të përgjithshëm për aktivitetet e Komunitetit.

## Neni 126

1. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, secili me një nënshtetësi të ndryshme, i cili përzgjidhet në bazë të kompetencës së përgjithshme sipas qëllimit të veçantë të këtij traktati, dhe pavarësia e të cilit është e garantuar.

Numri i anëtarëve të Komisionit mund të ndryshohet nga Këshilli, me votim unanim.

Vetëm shtetasit e Shteteve Anëtare mund të jenë anëtarë të Komisionit.

2. Anëtarët e Komisionit, në interes të përgjithshëm të Komunitetit, janë tërësisht të pavarur në kryerjen e punëve të tyre.

Në kryerjen e këtyre detyrave, ata as nuk kërkojnë dhe as marrin udhëzime nga ndonjë qeveri ose nga ndonjë organ tjetër. Ata tërhiqen nga çdo veprim që është në mospërputhje me detyrat e tyre. Çdo Shtet Anëtar merr përsipër ta respektojë këtë parim, dhe të mos kërkojë të ketë ndikim mbi anëtarët e Komisionit në kryerjen e detyrave të tyre.

Anëtarët e Komisionit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre nuk angazhohen në kryerjen e asnjë detyre tjetër, qoftë ajo fitimprurëse ose jo. Kur marrin detyrat e tyre ata angazhohen solemnisht që si gjatë dhe pas ushtrimit të funksioneve të tyre ata do të respektojnë detyrimet që rrjedhin si rezultat i kryerjes së kësaj detyre, dhe në veçanti të detyrimit për t'u sjellë me dinjitet dhe për të ruajtur diskrecionin në lidhje me pranimin e marrjes së emërimeve apo përfitimeve të caktuara pasi janë larguar nga detyra. Në rast të ndonjë shkeljeje të këtyre detyrimeve, Gjykata e Drejtësisë, pas kërkesës nga Këshilli ose Komisioni, mund të vendosë që anëtari në fjalë, sipas rrethanave, ose të dalë në pension në mënyrë të detyrueshme, sipas dispozitave të nenit 129, ose t'i mohohet e drejta për të marrë pension, ose për të marrë përfitime të tjera në vend të tij.

## Neni 127

Anëtarët e Komisionit emërohen me marrëveshje të ndërsjellë të qeverive të Shteteve Anëtare.

Kohëzgjatja e tyre në detyrë është katër vjet. Ky mandat është i rinovueshëm.

## Neni 128

Përveç zëvendësimit të zakonshëm, ose vdekjes, detyrat e një anëtari të Komisionit përfundojnë në rastin e dhënies së dorëheqjes ose daljes së detyrueshme në pension.

Në këtë rast, vendi i lirë i punës plotësohet për pjesën e mandatit të mbetur. Këshilli, me votim unanim, mund të vendosë që nuk është e nevojshme që ky vend i lirë të plotësohet .

Me përjashtim të rasteve të daljes së detyrueshme në pension sipas parashikimeve të nenit 128, anëtarët e Komisionit qëndrojnë në detyrë deri sa të zëvendësohen.

#### Neni 129

Nëse asnjë anëtar i Komisionit nuk i plotëson më kushtet e kërkuara për kryerjen e detyrave të tij, ose nëse është fajtor për sjellje serioze të pahijshme, Gjykata e Drejtësisë, pas kërkesës së Këshillit ose të Komisionit, mund ta nxjerrë atë me detyrim në pension.

Në një rast të tillë, Këshilli me votim unanim dhe si masë e përkohshme, mund ta pezullojë anëtarin nga detyra dhe mund të bëjë parashikime për zëvendësimin e tij në pritje të vendimit të Gjykatës së Drejtësisë. Gjykata e Drejtësisë, pas kërkesës së Këshillit ose të Komisionit, mund ta pezullojë përkohësisht anëtarin nga detyra.

#### Neni 130

Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit emërohen nga radhët e anëtarëve për një afat dy vjeçar, në përputhje me të njëjtën procedurë që parashikohet për emërimin e anëtarëve të Komisionit. Këto emërimë mund të rinovohen.

Në përjashtim të rastit kur zëvendësohet i gjithë Komisioni, emërimë të tilla bëhen pas konsultimit të Komisionit. Në rast të daljes në pension ose të vdekjes, Kryetari ose zëvendëskryetari zëvendësohen për pjesën e mandatit që mbetet, në përputhje me dispozitat e paragrafit të parë.

#### Neni 131

Këshilli dhe Komisioni konsultohen me njëri-tjetrin dhe me marrëveshje të përbashkët përcaktojnë metodat e bashkëpunimit.

Komisioni miraton rregulloret e tij për t'u siguruar se si ai dhe departamentet e tij veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij traktati. Ai siguron që këto rregullore të botohen.

#### Neni 132

Komisioni voton me shumicë të numrit të anëtarëve të parashikuar në nenin 126.

Një takim i Komisionit është i vlefshëm, vetëm nëse në të është i pranishëm numri i anëtarëve të përcaktuar në rregulloren e Komisionit.

#### Neni 133

Këshilli, me votim unanim, mund të bjerë dakord që qeveria e një Shteti Anëtar t'i akreditojë Komisionit një përfaqësues të kualifikuar për të marrë përsipër detyra të përhershme të bashkërendimit.

#### Neni 134

1. Krijohet një Komitet Shkencor dhe Teknik; ai i bashkëngjitet Komisionit dhe ka status këshillimor.

Me Komitetin zhvillohen konsultime kur parashikohet kështu nga ky traktat. Me Komitetin mund të zhvillohen konsultime në të gjitha rastet në të cilat Komisioni e konsideron këtë gjë si të drejtë.

2. Komiteti përbëhet prej njëzet anëtarësh të emëruar nga Këshilli, pas konsultimit me Komisionin.

Anëtarët e Komitetit emërohen në cilësinë e tyre personale për një mandat pesë vjeçar. Ky emërim është i rinovueshëm. Ata nuk janë të detyruar ligjërisht nga asnjë udhëzim i detyrueshëm.

Komiteti Shkencor dhe Teknik zgjedh çdo vit Kryetarin e tij ndërmjet radhëve të anëtarëve të tij.

Neni 135

Komisioni mund të bëjë konsultime dhe të ngrejë grupet studimore të nevojshme për kryerjen e detyrave të tij.

Seksioni IV

### **Gjykata e Drejtësisë**

Neni 136

Gjykata e Drejtësisë siguron që të respektohet ligji në interpretimin dhe zbatimin e këtij traktati.

Neni 137

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga shtatë gjyqtarë.

Gjykata e Drejtësisë mbledhet në seancë plenare. Ajo, gjithsesi, mund të formojë dhoma, secila e përbërë prej tre deri në pesë gjyqtarë, ose për të bërë hetime të caktuara përgatitore ose për të gjykuar për kategori të veçanta të çështjeve, në përputhje me rregullat e parashikuara për këto qëllime.

Sa herë që Gjykata e Drejtësisë shqyrton çështje që i paraqiten nga një Shtet Anëtar ose nga një ndër institucionet e Komunitetit, ose kur i duhet të japë vendime paraprake për çështje që i dërgohen në përputhje me nenin 150, ajo mbledhet në seancë plenare.

Nëse kërkohet nga Gjykata e Drejtësisë, Këshilli, me votim unanim, mund të rrisë numrin e gjyqtarëve dhe të bëjë rregullimet e nevojshme në paragrafët dy dhe tre të këtij neni dhe në paragrafin e dytë të nenit 139.

Neni 138

Gjykata e Drejtësisë ndihmohet nga dy avokatë të përgjithshëm.

Është detyrë e Avokatit të Përgjithshëm, që vepron me paanësi dhe pavarësi të plotë, të paraqesë në një seancë të hapur gjyqësore parashtrime të arsyetuara për çështje që i çohen Gjykatës së Drejtësisë, në mënyrë që të ndihmojë gjykatën në kryerjen e detyrave që i janë caktuar asaj në nenin 136.

Nëse kërkohet nga Gjykata e Drejtësisë, Këshilli me votim unanim, mund të rrisë numrin e avokatëve të përgjithshëm dhe të bëjë rregullimet e nevojshme në paragrafin e tretë të nenit 39.

Neni 139

Gjyqtarët dhe avokatët e përgjithshëm përzgjidhen nga radhët e atyre personave pavarësia e të cilëve është e garantuar, dhe që kanë kualifikimet që kërkohen për emërim në pozicionet më të larta gjyqësore në vendet e tyre përkatëse, ose që janë juristë me kompetencë të njohur; ata emërohen me marrëveshje të ndërsjellë të qeverive të Shteteve Anëtare për një mandat gjashtë vjeçar.

Çdo tri vjet bëhet një zëvendësim i pjesshëm i gjyqtarëve. Në mënyrë alternative, zëvendësohen tre ose katër gjyqtarë. Tre gjyqtarët, mandati i të cilëve përfundon në fund të tre viteve të para, caktohen me short.

Çdo tre vjet bëhet një zëvendësim i pjesshëm i avokatëve të përgjithshëm. Avokati i Përgjithshëm, mandati i të cilit përfundon në fund të tre vjeçarit të parë, caktohet me short.

Gjyqtarët dhe avokatët e përgjithshëm që dalin në pension kanë të drejtë të riemërohen.

Gjyqtarët zgjedhin Kryetarin e Gjykatës së Drejtësisë nga radhët e anëtarëve të tyre për një mandat tre vjeçar. Ai mund të rizgjidhet.

#### Neni 140

Gjykata e Drejtësisë emëron Kancelarin e saj dhe përcakton rregullat që drejtojnë shërbimin e tij.

#### Neni 141

Nëse Komisioni është i mendimit se një Shtet Anëtar nuk ka përmbushur detyrimet që përcaktohen për të në këtë traktat, ai nxjerr një mendim të arsyetuar për çështjen pasi i jep shtetit përkatës mundësinë të depozitohet vëzhgimet e tij.

Nëse shteti në fjalë nuk është dakord me mendimin, brenda kohës së parashikuar nga Komisioni, ky i fundit mund t'ia dërgojë çështjen Gjykatës së Drejtësisë.

#### Neni 142

Një Shtet Anëtar që është i mendimit se një tjetër Shtet Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim të parashikuar në këtë traktat, mund t'ia dërgojë çështjen Gjykatës së Drejtësisë.

Përpara se një Shtet Anëtar të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar për një cenim të pretenduar të një detyrimi të përcaktuar në këtë traktat, ai e parashtron çështjen para Komisionit.

Komisioni jep një mendim të arsyetuar, pasi çdo shteti të prekur i jepet mundësia të parashtrorë çështjen e tij dhe vëzhgimet e tij për çështjen e palës tjetër, si me gojë dhe me shkrim.

Nëse Komisioni nuk jep mendim brenda tre muajve nga data në të cilën i është parashtruar çështja, mungesa e këtij mendimi nuk e pengon procesin e dërgimit të çështjes në Gjykatën e Drejtësisë.

#### Neni 143

Nëse Gjykata e Drejtësisë identifikon se një Shtet Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim të parashikuar në këtë traktat, shtetit i kërkohet të marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e marrë nga Gjykata e Drejtësisë.

#### Neni 144

Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion të pakufizuar për:

- (a) Procese të ngritura sipas nenin 12 për të përcaktimin e kushteve të nevojshme për dhënien e licencave dhe të nënlicencave nga Komisioni;
- (b) Procese të ngritura nga persona ose sipërmarrje kundër sanksioneve që u vendosen atyre nga Komisioni sipas nenit 83.

#### Neni 145

Nëse Komisioni është i mendimit se një person ose sipërmarrje ka kryer një shkelje të këtij traktati, për të cilën nuk zbatohen dispozitat e nenit 83, ai i bën thirrje Shtetit Anëtar që ka juridiksion mbi këtë person ose sipërmarrje që të respektohen sanksionet në lidhje me shkeljen, në përputhje me ligjin e tij të brendshëm.

Nëse shteti në fjalë nuk përmbush një kërkesë të tillë brenda periudhës së parashtruar nga Komisioni, ky i fundit mund të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë për të zgjidhur çështjen e akuzës për shkelje nga personi ose sipërmarrja përkatëse.

#### Neni 146

Gjykata e Drejtësisë rishikon ligjshmërinë e akteve të Këshillit dhe të Komisionit, me përjashtim të rekomandimeve dhe mendimeve. Për këtë qëllim, ajo ka juridiksion mbi çështjet e ngritura nga një Shtet Anëtar, Këshilli ose Komisioni mbi bazën e mungesës së kompetencës, shkeljen e një kërkesë thelbësore procedurale, shkeljen e këtij traktati ose të çdo shteti të së drejtës që lidhet me zbatimin e tij, ose me abuzimin e kompetencave.

Çdo person fizik ose juridik, në të njëjtat kushte, mund të fillojë procedura kundër një vendimi që i drejtohet atij personi ose kundër një vendimi, i cili, megjithëse në formën e një rregulloreje ose të një vendimi që i drejtohet të njëjtit person, lidhet drejtpërsëdrejti ose individualisht me personin e parë.

Procedurat e parashikuara në këtë nen kryhen brenda dy muajve pas botimit të masës, ose pas njoftimit të palës së paditur për të, ose në mungesë të kësaj të fundit, brenda dy muajve nga dita e njoftimit të këtij të fundit, sipas rastit.

#### Neni 147

Nëse veprimi është i bazuar, Gjykata e Drejtësisë e deklaron aktin në fjalë të pavlefshëm.

Në rast të një rregulloreje, gjithsesi, Gjykata e Drejtësisë, nëse e konsideron të rëndësishme këtë gjë, deklaron se cilat nga efektet e rregullores që ka deklaruar të pavlefshme konsiderohen si përfundimtare.

#### Neni 148

Nëse Këshilli ose Komisioni, duke mos respektuar këtë traktat, nuk vepron, Shtetet Anëtare ose institucionet e tjera të Komunitetit mund të ngrenë një padi pranë Gjykatës së Drejtësisë në mënyrë që të ndreqet shkelja.

Padia është e pranueshme vetëm nëse institucionit në fjalë i është kërkuar më parë të veprojë. Nëse brenda dy muajve nga koha që atij i është kërkuar të veprojë, institucioni në fjalë nuk e ka përcaktuar pozicionin e tij, padia mund të ngrihet brenda afatit të dy muajve të tjerë.

Çdo person fizik ose juridik, në bazë të kushteve që parashikohen në paragrafët më lart, ankohet para Gjykatës së Drejtësisë, kur një institucion i Komunitetit nuk i ka drejtuar atij personi asnjë akt të ndryshëm nga një rekomandim ose mendim.

#### Neni 149

Institucionit, akti i të cilit është deklaruar i pavlefshëm, ose paaftësia e të cilit për të nxjerrë një akt është deklaruar si në kundërshtim me këtë traktat, i kërkohet të marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës së Drejtësisë.

Ky detyrim nuk prek asnjë detyrim që mund të rrjedhë nga zbatimi i paragrafit të dytë të nenit 188.

#### Neni 150

Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion për të dhënë vendime paraprake në lidhje me:

- (a) interpretimin e këtij traktati;
- (b) vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve të Komunitetit;
- (c) interpretimin e statuteve të organeve të krijuara nga një akt i Këshillit, me përjashtim të rasteve kur këto statute parashikojnë ndryshe.

Kur ngrihet një pyetje e tillë para një gjykatë të zakonshme ose një gjykate të posaçme të një Shteti Anëtar, kjo gjykatë e zakonshme ose e posaçme, nëse është e mendimit se nevojitet një vendim për çështjen për t'i dhënë mundësi asaj të nxjerrë një vendim, i kërkon Gjykatës së Drejtësisë të japë një vendim.

Kur një pyetje e tillë ngrihet për një çështje që është pezull në një gjykatë të zakonshme ose në një gjykatë të posaçme të një Shteti Anëtar, kundër vendimeve të së cilës nuk ka rregullim juridik sipas legjislacionit të brendshëm, gjykatat e zakonshme ose të posaçme ia çojnë çështjen Gjykatës së Drejtësisë.

#### Neni 151

Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion në mosmarrëveshjet që lidhen me dëmshpërblimin e parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 188.

#### Neni 152

Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion në mosmarrëveshjet ndërmjet Komunitetit dhe nënpunësve të tij brenda kufijve, dhe sipas kushteve të parashikuara në rregulloret e stafit ose kushtet e punësimit.

#### Neni 153

Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion për të dhënë vendime sipas çdo klauzole arbitrazhi që përfshihet në një kontratë nga ose në emër të Komunitetit, pavarësisht nëse ajo kontratë rregullohet nga e drejta publike ose private.

#### Neni 154

Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion mbi çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Anëtare që lidhet me objektin e këtij traktati, nëse mosmarrëveshja i dërgohet asaj sipas një marrëveshjeje të posaçme ndërmjet palëve.

#### Neni 155

Me përjashtim të rastit kur juridiksioni i jepet Gjykatës së Drejtësisë nga ky traktat, mosmarrëveshjet në të cilat Komuniteti është palë, për këtë shkak, nuk përjashtohen nga juridiksioni i gjykatave të zakonshme ose të posaçme të Shteteve Anëtare.

#### Neni 156

Pavarësisht nga përfundimi i afatit të parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 146, çdo palë, në proceset që kanë si objekt një rregullore të Këshillit ose të Komisionit, mund të pretendojë arsyet e specifikuar në paragrafin e parë të nenit 146, në mënyrë që t'i kërkojë Gjykatës së Drejtësisë mospërputhshmërinë me këtë rregullore.

#### Neni 157

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë traktat, paditë e ngritura para Gjykatës së Drejtësisë nuk kanë efekt pezullues. Gjykata e Drejtësisë, gjithsesi, nëse konsideron se kërkohet kështu nga rrethanat, mund të urdhërojë pezullimin e aktit të kontestuar.

#### Neni 158

Gjykata e Drejtësisë, për çdo çështje që i drejtohet, mund të japë masa të nevojshme të përkohshme.

#### Neni 159

Vendimet e Gjykatës së Drejtësisë janë të zbatueshme sipas kushteve të parashikuara në nenin 164.

#### Neni 160

Statuti i Gjykatës së Drejtësisë përcaktohet në një protokoll të veçantë.

Gjykata e Drejtësisë miraton rregulloren e saj. Rregullorja kërkon miratimin unanim të Këshillit.

## KAPITULLI II DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR DISA INSTITUCIONE

### Neni 161

Në mënyrë që të kryejë detyrat e tij, Këshilli dhe Komisioni, në përputhje me dispozitat e këtij traktati, harton rregullore, nxjerr direktiva, merr vendime, bën rekomandime ose jep mendime.

Rregullorja ka zbatim të përgjithshëm. Ajo është detyruese në tërësi, dhe është drejtpërsëdrejti e zbatueshme nga të gjithë Shtetet Anëtare.

Direktiva është detyruese në lidhje me rezultatin që duhet arritur për secilin nga Shtetet Anëtare të cilës ajo i drejtohet, dhe i takon autoriteteve kombëtare të përzgjedhin formën dhe metodat e arritjes së rezultatit.

Vendimi është detyrues në tërësi për subjektet të cilave u drejtohet.

Rekomandimet dhe mendimet nuk kanë karakter detyrues.

### Neni 162

Rregulloret, direktivat dhe vendimet e Këshillit dhe të Komisionit përfshijnë arsyet mbi të cilat mbështeten dhe i referohen çdo propozimi ose mendimi që kërkohet të merret në përputhje me këtë traktat.

### Neni 163

Rregulloret botohen në Gazetën Zyrtare të Komunitetit. Ato hyjnë në fuqi në datën e specifikuar në to, ose në mungesë të saj, në ditën e njëzetë pas botimit të tyre.

Direktivat dhe vendimet u njoftohen atyre të cilëve u drejtohen, dhe hyjnë në fuqi pas njoftimit të tyre.

### Neni 164

Zbatimi kryhet sipas rregullave të procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet ai. Urdhri për zbatim i bashkëngjitet vendimit, pa formalitete të tjera të ndryshme nga verifikimi i vërtetësisë së vendimit, nga organi kombëtar që caktohet nga qeveria e secilit Shtet Anëtar për këtë qëllim, dhe i bëhet me dije Komisionit, Gjykatës së Drejtësisë dhe Komitetit të Arbitrazhit të krijuar sipas nenit 18.

Kur të kenë përfunduar këto formalitete me kërkesën e palës së interesuar, kjo e fundit mund të vijojë me zbatimin në përputhje me legjislacionin e brendshëm, duke ia çuar çështjen drejtpërsëdrejti organit përgjegjës.

Zbatimi mund të pezullohet vetëm me anë të një vendimi nga Gjykata e Drejtësisë. Gjithsesi, gjykatat e vendeve përkatëse kanë juridiksion mbi ankesat që lidhen me zbatimin jo të drejtë.



### KAPITULLI III KOMITETI EKONOMIK DHE SOCIAL

#### Neni 165

Ky traktat parashikon krijimin e Komitetit Ekonomik dhe Social. Ai ka status këshillimor.

Komiteti përbëhet nga përfaqësues të kategorive të ndryshme të aktivitetit ekonomik dhe social.

#### Neni 166

Numri i anëtarëve të Komitetit është si më poshtë:

Belgjika .....	12
Gjermania .....	24
Franca .....	24
Italia .....	24
Luksemburgu .....	5
Holanda .....	12

Anëtarët e Komitetit emërohen nga Këshilli, i cili voton unanimisht, për një periudhë katër vjeçare. Emërimi i tyre është i rinovueshëm.

Anëtarët e Komitetit emërohen në cilësinë e tyre personale dhe nuk janë të detyruar nga asnjë udhëzim detyrues.

#### Neni 167

1. Për emërimin e anëtarëve të Komitetit, çdo Shtet Anëtar i jep Këshillit një listë që përmban dyfishin e numrit të kandidatëve për vendet që i takojnë shtetasve të tij.

Përbërja e Komitetit merr parasysh nevojën e sigurimit të përfaqësimit të përshtatshëm të kategorive të ndryshme të aktivitetit ekonomik dhe social.

2. Këshilli konsultohet me Komisionin. Ai mund të marrë opinionin e organeve europiane që janë përfaqësuese të sektorëve të ndryshëm socialë dhe ekonomikë, për të cilët aktivitetet e Komunitetit janë shqetësuese.

#### Neni 168

Komiteti zgjedh Kryetarin dhe zyrtarët e tij nga radhët e anëtarëve për një periudhë dy vjeçare.

Ai miraton rregulloren e tij dhe ia dërgon atë Këshillit për miratim, i cili duhet të bëhet unanimisht.

Komiteti mblidhet nga Kryetari i tij me kërkesë të Këshillit ose të Komisionit.

#### Neni 169

Komiteti mund të ndahet në seksione të specializuara.

Këto seksione të specializuara funksionojnë brenda kushteve të përgjithshme të referencës së Komitetit. Ato nuk mund të konsultohen në mënyrë të pavarur nga Komiteti.

Brenda Komitetit mund të krijohen dhe nënkomisione për të përgatitur projektvendime për çështje specifike ose fusha specifike, të cilat i dërgohen Komitetit për shqyrtimin e tij.

Rregullorja parashikon metodat e përbërjes së termave të referencës së seksioneve dhe të nënkomisioneve të specializuara.

#### Neni 170

Komiteti duhet të konsultohet nga Këshilli ose nga Komisioni kur parashikohet kështu në këtë traktat. Komiteti mund të konsultohet nga ato institucione në të gjitha rastet në të cilat ata e konsiderojnë të arsyeshme.

Këshilli ose Komisioni, nëse konsiderohet e nevojshme për dhënien e mendimit të tij, jep një afat kohor që nuk është më pak se dhjetë ditë nga data në të cilën Kryetari merr njoftim për këtë qëllim. Pas përfundimit të afatit kohor, mungesa e mendimit nuk parandalon veprime të mëtejshme.

Mendimi i Komitetit dhe ai i seksioneve të specializuara, së bashku me një procesverbal të punimeve i dërgohet Këshillit dhe Komisionit.

### **TITULLI KATËR**

#### **DISPOZITAT FINANCIARE**

## Neni 171

1. Çdo vit financiar bëhen vlerësimet e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të Komunitetit, me përjashtim të atyre të Agjencisë dhe të sipërmarrjeve të përbashkëta, dhe këto të ardhura dhe shpenzime pasqyrohen ose në buxhetin operativ ose në buxhetin e kërkimit dhe të investimit.

Të ardhurat dhe shpenzimet e pasqyruara në çdo buxhet janë të balancuara.

2. Të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë, e cila funksionon në përputhje me parimet tregtare, buxhetohen në një llogari të posaçme.

Mënyra e vlerësimit, zbatimi dhe auditimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve të tilla parashikohet, sipas statuteve të Agjencisë, në rregulloret financiare të hartuara në përputhje me nenin 183.

3. Vlerësimet e të ardhurave dhe shpenzimeve, së bashku me llogaritë operative dhe bilancin e sipërmarrjeve të përbashkëta për secilin vit financiar, i dërgohen Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit në përputhje me statutet e këtyre sipërmarrjeve.

## Neni 172

Të ardhurat e buxhetit operativ përfshijnë, pavarësisht nga të ardhura të tjera korrente, kontribute financiare të Shteteve Anëtare në nivelin e mëposhtëm:

Belgjika .....	7.9
Gjermania .....	28
Franca .....	28
Italia .....	28
Luksemburgu .....	0.2
Holanda .....	7.9

2. Buxheti i të ardhurave për kërkime dhe investime përfshin, pavarësisht nga burime të tjera, kontribute financiare të Shteteve Anëtare në masën e mëposhtme:

Belgjika .....	9.9
Gjermania .....	30
Franca .....	30
Italia .....	23
Luksemburgu .....	0.2
Holanda .....	6.9

3. Masa mund të modifikohet nga Këshilli, me votim unanimit.

4. Huatë dhe financimi për kërkim ose investim kryhet sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli sipas mënyrës së parashikuar në nenin 177 paragrafi (5).

Komuniteti mund të marrë hua në tregun e kapitaleve të një Shteti Anëtar, ose në përputhje me dispozitat ligjore që zbatohen për çështje të brendshme, ose, nëse nuk ka dispozita të tilla në një Shtet Anëtar, pasi Shteti Anëtar në fjalë dhe Komisioni janë mbledhur së bashku dhe të kenë arritur një marrëveshje për huanë e propozuar.

Organet përgjegjëse të Shtetit Anëtar në fjalë mund të refuzojnë dhënien e pëlqimit, vetëm nëse ka arsye për frikën e shqetësimeve serioze në tregun kapital të atij shteti.

#### Neni 173

Kontributet financiare të Shteteve Anëtare të parashikuara në nenin 172 mund të zëvendësohen në tërësi ose pjesërisht nga të ardhurat nga taksat e mbledhura nga Komunitetit në Shtetet Anëtare.

Për këtë qëllim, Komisioni i dërgon Këshillit propozime që lidhen me vlerësimin e taksave të tilla, metodën e përcaktimit të nivelit të tyre dhe procedurën për mbledhjen e tyre.

Pas konsultimit me Parlamentin, për këto propozime, Këshilli me votim unanim parashikon dispozitat e duhura të cilat ai ia rekomandon Shteteve Anëtare për miratim në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse kushtetuese.

#### Neni 174

1. Shpenzimet e treguara në buxhetin operativ përfshijnë në veçanti:

- (a) shpenzimet administrative;
- (b) shpenzimet që lidhen me garancitë dhe me shëndetin dhe sigurinë.

2. Shpenzimet e pasqyruara në buxhetin e kërkimit dhe të investimit përfshijnë në veçanti:

- (a) Shpenzimet që lidhen me zbatimin e programit të kërkimit të Komunitetit;
- (b) Çdo pjesëmarrje në kapitalin e Agjencisë dhe në shpenzimet e saj për investime;
- (c) Shpenzimet që lidhen me pajisjen e qendrave për trajnim;
- (d) Çdo pjesëmarrje në sipërmarrje të përbashkët ose në operacione të caktuara të përbashkëta.

#### Neni 175

Shpenzimet e pasqyruara në buxhetin operativ autorizohen për një vit financiar, në përjashtim të rasteve kur rregulloret e hartuara në përputhje me nenin 183 parashikojnë ndryshe.

Në përputhje me kushtet e parashikuara, në përputhje me nenin 183, çdo fond i ndryshëm nga ato që lidhen me shpenzimet e stafit, që është i pashpenzuar në fund të vitit financiar mbartet vetëm në vitin pasues financiar.

Fondet për të mbuluar shpenzimet klasifikohen në kapituj të veçantë, duke grupuar zëra të shpenzimeve sipas natyrës së tyre ose qëllimit dhe të nënndara, për aq kohë sa është e nevojshme, në përputhje me rregulloret e hartuara në përputhje me nenin 183.

Shpenzimet e Parlamentit, Këshillit, Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë përcaktohen në pjesë të veçanta të buxhetit, pa cenuar rregullime të veçanta për zëra të caktuar të përbashkët të shpenzimeve.

#### Neni 176

1. Në varësi të kufijve që rrjedhin nga programe ose vendime që përfshijnë shpenzime, të cilat në përputhje me traktatin kërkojnë miratimin unanim të Këshillit, fondet për shpenzime për kërkim dhe investim përfshijnë:

- (a) fonde angazhimi, që përmbledhin një seri artikujsh që përbëjnë një njësi të veçantë dhe formojnë një tërësi koherente;
- (b) fonde pagese që përfaqësojnë shumën maksimale të pagueshme çdo vit, në lidhje me angazhimet e parashikuara në nënparagrafin (a).

2. Kalendarin e datave përkatëse për fondet dhe pagesat jepet në vijim të projektbuxhetit korrespondues nga Komisioni.

3. Fondet për kërkim dhe investim klasifikohen në krerë të ndryshëm duke grupuar zërat e shpenzimeve sipas natyrës ose qëllimit, dhe të nënndara, për aq kohë sa është e nevojshme, në përputhje me rregulloret e nxjerra në përputhje me nenin 183.

4. Autorizimet e papërdorura për pagesa mbarten në vitin financiar pasardhës me anë të një vendimi nga Komisioni, në përjashtim të rasteve kur vendoset ndryshe nga Këshilli.

#### Neni 177

1. Viti financiar zgjat në kohë nga data 1 janar deri më 31 dhjetor.

2. Çdo institucion i Komunitetit bën vlerësime të shpenzimeve të tij administrative. Komisioni i konsolidon këto vlerësime në një projektbuxhet paraprak operativ. Ai bashkëngjit një mendim që mund të përfshijë vlerësime të ndryshme. Ai përgatit gjithashtu dhe një projektbuxhet paraprak kërkimi dhe investimi.

Komisioni ia dorëzon projektbuxhetet paraprake Këshillit, jo më vonë se data 30 shtator e vitit paraardhës të vitit në të cilin zbatohen këto buxhete.

Këshilli konsultohet me Komisionin, dhe kur është e nevojshme me institucione të tjera përkatëse, sa herë që ka qëllim të shpëtojë nga projektbuxhetet paraprake.

3. Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar, përcakton projektbuxhete dhe ia nis ato Parlamentit.

Projektbuxhetet i çohen Parlamentet jo më vonë se data 31 tetor e vitit që paraprin vitin në të cilin do të zbatohen projektbuxhetet.

Parlamenti ka të drejtë t'i propozojë Këshillit ndryshime në projektbuxhet.

4. Nëse brenda një muaji pas dorëzimit të projektbuxheteve në Parlament, ai nuk ka dhënë miratimin e tij ose nuk ia ka dorëzuar mendimin e tij Këshillit, projektbuxhetet konsiderohen si përfundimisht të miratuara.

Nëse brenda kësaj periudhe Parlamenti ka propozuar ndryshime, projektbuxhetet e ndryshuara i dërgohen Këshillit. Këshilli i diskuton ato me Komisionin, dhe kur është e përshtatshme, me institucione të tjera përkatëse, dhe më pas miraton përfundimisht buxhetet, me shumicë të cilësuar, në varësi të kufijve që rrjedhin nga programet ose vendimet që përfshijnë shpenzime, të cilat në përputhje me këtë traktat, kërkojnë miratim unanim nga Këshilli.

5. Për miratimin e buxhetit të kërkimit dhe investimit, votat e anëtarëve të Këshillit llogariten si më poshtë:

Belgjika .....	9
Gjermania .....	30
Franca .....	30
Italia .....	23
Luksemburgu .....	1
Holanda .....	7

Për miratimin e tyre, aktet e Këshillit kërkojnë të paktën 67 vota pro.

#### Neni 178

Nëse në fillim të vitit financiar, buxheti operativ nuk është votuar ende, çdo muaj mund të shpenzohet një shumë ekuivalente me një të dymbëdhjetën e fondeve të buxhetit të vitit financiar pararendës, duke respektuar çdo kapitull ose nënndarje tjetër të buxhetit, në përputhje me dispozitat dhe rregulloret e bëra sipas nenit 183; gjithsesi, ky rregullim nuk ka efekt mbi vënien në përdorim të fondeve të Komisionit përtej shumës prej një të dymbëdhjetën e fondeve të parashikuara në projekt-buxhet gjatë përgatitjeve.

Nëse në fillim të vitit financiar, nuk është votuar ende fondi për kërkim dhe investim, mund të harxhohet çdo muaj një shumë prej jo më shumë se një e dymbëdhjeta e fondeve që korrespondojnë me vlerësimet vjetore të pasqyruara në kalendarin e datave përkatëse të pagesave, që lidhen me fondet e caktuara që janë miratuar sipas kapitujve ose nënndarjeve të tjera të buxhetit, në përputhje me dispozitat e rregulloreve të hartuara në bazë të nenit 183.

Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar, mund të autorizojë shpenzime më të larta se një e dymbëdhjeta e buxhetit, me kusht që të respektohen kushtet e tjera të parashikuara në paragrafin e parë dhe të dytë, në varësi të kufizimeve që rrjedhin nga programet ose vendimet që përfshijnë shpenzime, të cilat në përputhje me këtë traktat, kërkojnë miratimin unanim të Këshillit.

Shtetet Anëtare çdo muaj paguajnë shumën e nevojshme për të siguruar zbatimin e këtij neni, përkohësisht dhe në përputhje me nivelet e parashikuara për vitin financiar pararendës.

#### Neni 179

Komisioni zbaton buxhetet, në përputhje me dispozitat e rregulloreve të hartuara në përputhje me nenin 183, me përgjegjësinë e tij dhe brenda kufijve të fondeve.

Rregulloret parashikojnë rregulla të detajuara për çdo institucion në lidhje me pjesët e tij në ndikimin e shpenzimeve të veta.

Brenda buxheteve, Komisioni, në varësi të kufizimeve dhe kushteve të parashikuara në rregulloret e bëra në përputhje me nenin 183, mund të transferojë fonde nga njëri kapitull në tjetrin ose nga njëra nënndarje në tjetrën.

#### Neni 180

Llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve në secilin buxhet shqyrtohen nga një Bord Auditimi, i cili përbëhet nga auditues pavarësia e të cilëve është e padiskutueshme, e njëri nga të cilët është Kryetari i Bordit. Këshilli, me votim unanim, përcakton numrin e audituesve. Audituesit dhe Kryetari i Bordit të Auditimit emërohet nga Këshilli me votim unanim, për një periudhë pesë vjeçare. Shpërblimi i tyre përcaktohet nga Këshilli, i cili vepron me shumicë të cilësuar.

Qëllimi i auditimit, i cili bazohet në procesverbale, nëse është e nevojshme bëhet në vend, është të sigurojë që janë vjelur të gjitha të ardhurat dhe janë kryer të gjitha shpenzimet, në mënyrë të rregullt dhe ligjore, dhe se menaxhimi financiar ka qenë i plotë. Pas përfundimit të çdo viti financiar Bordi i Auditimit përpilon një raport, i cili miratohet nga një shumicë e anëtarëve të tij.

Komisioni i dërgon Këshillit dhe Parlamentit çdo vit pasqyrën e vitit financiar pararendës, në lidhje me zbatimin e çdo buxheti, së bashku me një raport të Bordit të Auditimit. Komisioni i dërgon këtyre institucioneve edhe një pasqyrë financiare që tregon aktivet dhe pasivet e Komunitetit.

Me votim me shumicë të cilësuar, Këshilli i jep miratimin Komisionit në lidhje me zbatimin e çdo buxheti. Ai ia bën me dije vendimet e tij Parlamentit.

#### Neni 181

Buxheti dhe llogaritë e parashikuara në nenin 171 paragrafët (1) dhe (2) pasqyrohen në pasqyrën e llogarive, në përputhje me dispozitat e rregulloreve financiare të nxjerra sipas nenit 183.

Kontributet financiare të parashikuara në nenin 172 do t'u vihen në dispozicion Shteteve Anëtare në monedhën e tyre kombëtare.

Bilancet e disponueshme të këtyre kontributeve depozitohen në thesaret e Shteteve Anëtare ose në organet e caktuara prej tyre. Ndërkohë që janë në depozita, fonde të tilla ruajnë vlerën që i korrespondon barazisë, në datën e depozitimit, në lidhje me njësinë e llogarisë së cilës i referohet paragrafi i parë.

Bilancet mund të investohen sipas kushteve të rëna dakord ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar përkatës.

## Neni 182

1. Komisioni mund të kryejë transfertat në monedhën e njërit prej Shteteve Anëtare në monedhën e një tjetër Shteti Anëtar, me kusht që ai të njoftojë autoritetet e Shteteve Anëtare të përfshira, në masën e nevojshme për ta lejuar shumën të përdoret për qëllime që përfshihen në objektin e këtij traktati. Për aq sa është e mundur, Komisioni shmang kryerjen e transfertave të tilla, nëse zotëron para në kesh ose asete likuide në monedhën që i nevojitet.

2. Komisioni merret me secilin Shtet Anëtar nëpërmjet organit të caktuar nga shteti përkatës. Në kryerjen e operacioneve të tij financiare, Komisioni përdor shërbimet e bankës së emetimit të Shtetit Anëtar përkatës ose të çdo një institucioni tjetër financiar të miratuar nga ai Shtet.

3. Në lidhje me shpenzimet që duhet të kryejë Komuniteti në monedha të shteteve të treta, Komisioni i dërgon Këshillit një program që tregon të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara në monedha të huaja, para miratimit përfundimtar të buxheteve përpara se të miratohen përfundimisht buxhetet.

Ky program miratohet nga Këshilli, i cili voton me shumicë të cilësuar. Ai mund të ndryshohet gjatë vitit financiar në përputhje me të njëjtën procedurë.

4. Shtetet Anëtare i japin Komisionit monedhë të shteteve të treta për shpenzimet e treguara në programin e parashikuar në paragrafin 3, sipas të dhënave të parashikuara në nenin 172. Shumat e mbledhura nga Komisioni në monedhën e shteteve të treta u dërgohen me transfertë Shteteve Anëtare në përputhje me të njëjtat nivele.

5. Komisioni mund të përdorë lirshëm çdo shumë në monedhën e shteteve të treta që rrjedh nga huatë që ka marrë në vende të tilla.

6. Këshilli, me votim me shumicë të cilësuar mbi një propozim të Komisionit, mund të zbatojë, në tërësi ose pjesërisht, për Agjencinë ose për sipërmarrjet e përbashkëta, rregullimet e këmbimit të parashikuara në paragrafët pararendës, dhe aty ku është e nevojshme, i përputh këto rregullime me kërkesat e tij operative.

## Neni 183

Me votim me shumicë të cilësuar për një propozim nga Komisioni, Këshilli:

- (a) Nxjerr rregullore financiare që specifikojnë në veçanti procedurën që do të miratohet për krijimin dhe zbatimin e buxheteve, duke përfshirë dhe atë të Agjencisë, dhe për paraqitjen dhe auditimin e llogarive;
- (b) Përcakton metodat dhe procedurën nëpërmjet së cilës do t'i bëhen të disponueshme Komisionit kontributet e Shteteve Anëtare;

(c) Parashikon rregulla në lidhje me përgjegjësinë e stafit të autorizuar dhe stafit të financës dhe bën rregullimet e duhura për inspektim.

## **TITULLI PESTË**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**



#### Neni 184

Komuniteti ka personalitet juridik.

#### Neni 185

Në secilin nga Shtetet Anëtare, Komuniteti gëzon personalitet më të madh ligjor të parashikuar për personat juridikë sipas ligjeve të tyre; ai, në veçanti, mund të blejë ose shesë prona të tundshme ose të patundshme, dhe mund të jetë palë në procese ligjore. Për këtë qëllim, Komuniteti përfaqësohet nga Komisioni.

#### Neni 186

Këshilli, me votim unanim, në bashkëpunim me Këshillin dhe pas konsultimeve me institucione të tëra të përfshira parashikon rregulloret e stafit të zyrtarëve dhe kushtet e punësimit të nëpunësve të tjerë të Komunitetit.

Pasi ky traktat qëndron në fuqi për katër vjet, rregullorja e stafit dhe kushtet e punësimit mund të ndryshohen nga Këshilli, i cili voton me shumicë të cilësuar mbi një propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me institucione të tjera të përfshira.

#### Neni 187

Komisioni, brenda dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli, në përputhje me dispozitat e këtij traktati, mund të mbledhë informacion dhe të kryejë kontrollet që kërkohen për kryerjen e detyrave që i besohen atij.

#### Neni 188

Detyrimi kontraktual i Komunitetit parashikohet nga ligji i zbatueshëm në kontratën në fjalë.

Në rast të detyrimit jokontraktual, Komuniteti, në përputhje me kushtet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare, rregullon çdo dëmtim të shkaktuar nga institucionet e tij ose nga nëpunësit e tij në kryerjen e detyrave të tyre.

Detyrimi personal i nëpunësve për Komunitetin drejtohet nga dispozitat e parashikuara në rregulloren e stafit ose në kushtet e punësimit që zbatohen për to.

#### Neni 189

Vendi i institucioneve të Komunitetit përcaktohet me një marrëveshje të përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare.

#### Neni 190

Rregullat që drejtojnë gjuhët e institucioneve të Komunitetit, pa cenuar dispozitat e përfshira në rregulloren e Gjykatës së Drejtësisë, përcaktohen nga Këshilli, i cili voton unanim.

#### Neni 191

Komuniteti gëzon në territorin e Shteteve Anëtare privilegje dhe imunitete, të tilla që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, sipas kushteve të parashikuara në një protokoll të veçantë.

#### Neni 192

Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme, qofshin ato të përgjithshme ose të veçanta, për të siguruar realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky Traktat ose që rrjedhin nga veprimet e marra nga institucionet e Komunitetit. Ata lehtësojnë arritjen e detyrave të Komunitetit.

Ata abstenojnë ndaj çdo masë që pengon arritjen e objektivave të këtij traktati.

#### Neni 193

Shtetet Anëtare marrin përsipër të mos kërkojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për sa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij traktati në asnjë mënyrë zgjidhjeje të ndryshme nga ajo që parashikohet në këtë dokument.

#### Neni 194

1. Anëtarëve të institucioneve të Komunitetit, anëtarëve të komiteteve, zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë të Komunitetit, dhe personave të tjerë, të cilëve për shkak të detyrave të tyre, ose të marrëdhënieve të tyre publike ose private me institucionet ose organet e Komunitetit ose me sipërmarrje të përbashkëta u kërkohet e drejta e njohjes me çdo fakt, informacion, njohuri, dokument ose objekte që i nënshtrohen një sistemi sigurimi, në përputhje me dispozitat e parashikuara nga një Shtet Anëtar ose një institucion i Komunitetit u kërkohet, dhe pas përfundimit të detyrave ose marrëdhënieve të tilla, t'i mbajnë ato sekret ndaj çdo personi të paautorizuar dhe nga publiku i përgjithshëm.

Çdo Shtet Anëtar e trajton çdo shkelje të këtij detyrimi si akt të dëmshëm ndaj rregullave të tij për ruajtjen e sekretit, dhe si akt që përfshihet si për sa i përket rrethanave ashtu edhe juridiksionit, brenda objektit të ligjeve të tij që lidhen me aktet që cenojnë sigurimin e Shtetit dhe nxjerrjen e sekreteve profesionale. Ky Shtet Anëtar brenda juridiksionit të tij, me kërkesë të çdo Shteti Anëtar të prekur, ose të Komisionit, hap proces ndaj kujtqo që kryen një shkelje të tillë.

2. Çdo Shtet Anëtar i bën me dije Komisionit të gjitha dispozitat që rregullojnë brenda territorit të tij klasifikimin dhe sekretin e informacionit, njohurive, dokumenteve ose objekteve të mbuluara në këtë traktat.

Komisioni siguron që këto dispozita t'u komunikohen Shteteve të tjera Anëtare.

Çdo Shtet Anëtar merr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar krijimin gradual të një sistemi sigurimi sa më të njësuar dhe të kuptueshëm të jetë e mundur. Pas konsultimeve me Shtetet Anëtare përkatëse, Komisioni mund të bëjë rekomandime për këtë qëllim.

3. Institucioneve të Komunitetit, organeve të tyre si dhe sipërmarrjeve të përbashkëta u kërkohet të zbatojnë rregullat e sistemit të sigurimit në fuqi në territorin në të cilin shtrihet secili prej tyre.

4. Çdo autorizim i dhënë ose nga çdo institucion i Komunitetit ose nga një Shtet Anëtar për një person që kryen aktivitetet e tij brenda fushës së mbuluar nga ky traktat, për të pasur qasje në fakte, informacion, dokumente ose çështje e mbuluara nga ky traktat që i nënshtrohen sistemit të sigurisë, njihet nga çdo institucion tjetër dhe çdo Shtet tjetër Anëtar.

5. Dispozitat e këtij neni nuk shmangin zbatimin e dispozitave të posaçme që rrjedhin nga marrëveshje të përfunduara ndërmjet një Shteti Anëtar dhe një Shteti të tretë ose një organizate ndërkombëtare.

#### Neni 195

Institucionet e Komunitetit, Agjencia dhe sipërmarrjet e përbashkëta, gjatë zbatimit të këtij traktati, respektojnë kushtet për të pasur mundësi përdorimi të xeherorëve, materialeve burimore dhe materialeve të tjera të

zbërthyeshme, që parashikohen në rregullat dhe rregulloret kombëtare të bëra për arsye të politikës publike ose shëndetit publik.

#### Neni 196

Për qëllime të këtij traktati, në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dokument:

- (a) “person” është çdo person fizik që ndjek të gjitha ose një aktivitet të tij në territoret e Shteteve Anëtare brenda fushës së specifikuar në kapitullin përkatës të këtij traktati;
- (b) “sipërmarrje” është çdo sipërmarrje ose institucion që ndjek të gjitha ose një aktivitet të tij në territorin e Shteteve Anëtare brenda fushës së specifikuar në kapitullin përkatës të këtij traktati, pavarësisht nga statusi i tij ligjor publik apo privat.

#### Neni 197

Për qëllimet e këtij traktati:

1. “Materiale të veçanta të zbërthyeshme” nënkupton plutoniumi-239, uraniumi i pasuruar me uranium-235 ose uraniumi-233, si dhe çdo substancë që përfshin një ose më shumë izotope të mëparshme, dhe materiale të tjera të tillë të zbërthyeshme siç specifikohet nga Këshilli, i cili voton me shumicë të cilësuar mbi një propozim të Komisionit; shprehja “materiale të veçanta të zbërthyeshme”, gjithsesi, nuk përfshin materiale burimore.

2. “Uraniumi i pasuruar me uranium-235 ose uranium-233” nënkupton uraniumi që përmban uranium-235 ose uranium-233, ose të dy këto elemente në një masë të tillë që raporti i bollëkut të shumës së këtyre izotopeve ndaj izotopit 238 është më i madh se raporti i izotopit 235 ndaj izotopit 238 që ndodhen në natyrë.

3. “Materialet burimore” nënkupton uranium që përmban përzierjen e izotopeve që ndodhin në natyrë; uranium përbërja e të cilit në uranium-235 është më pak se normalja; torium; çdo element i sipërpërmendur në formën e metalit, aliazhit, përbërësit kimik ose koncentratit; çdo substancë tjetër që përmban një ose më shumë elemente të lartpërmendur në një përqëndrim të tillë siç është specifikuar nga Këshilli, i cili voton me shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit.

4. “Xeherorët” nënkupton çdo lloj xeherori që përmban, në përqendrime të tilla mesatare siç specifikohet nga Këshilli, i cili voton me shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit, substanca nga të cilat materialet burimore të përcaktuar më lart mund të përftohen nëpërmjet një përpunimi të duhur kimik dhe fizik.

#### Neni 198

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, ky traktat zbatohet në territoret europiane të Shteteve Anëtare dhe në territoret joeuropiane nën juridiksionin e tyre.

Ai zbatohet gjithashtu dhe në territoret europiane për marrëdhëniet e jashtme të të cilave është përgjegjës një Shtet Anëtar.

#### Neni 199

Komisionit i takon të sigurojë ruajtjen e të gjitha marrëdhënieve të nevojshme me të gjitha organet e Kombeve të Bashkuara, agjencive të saj të specializuara dhe të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë.

Komisioni mban gjithashtu marrëdhëniet e duhura me të gjitha organizatat ndërkombëtare.

#### Neni 200

Komuniteti krijon të gjitha format e përshtatshme të bashkëpunimit me Këshillin e Europës.

#### Neni 201

Komuniteti krijon bashkëpunim të ngushtë me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik Europian, detaje të të cilit përcaktohen me marrëveshje të ndërsjellë.

#### Neni 202

Dispozitat e këtij traktati nuk përjashtojnë ekzistencën ose realizimin e bashkimeve rajonale ndërmjet Belgjikës dhe Luksemburgut, ose ndërmjet Belgjikës, Luksemburgut dhe Holandës, kur objektivat e këtyre bashkimeve rajonale nuk arrihen nëpërmjet zbatimit të këtij traktati.

#### Neni 203

Nëse veprimi i Komisionit rezulton i nevojshëm për të arritur një ndër objektivat e Komunitetit, dhe ky traktat nuk ka parashikuar kompetencat e nevojshme, Këshilli, me votim unanim me propozim të Komisionit, dhe pas konsultimeve me Parlamentin, merr masat e nevojshme.

#### Neni 204

Qeveria e çdo Shteti Anëtar ose Komisioni mund t'i dërgojë Këshillit propozime për ndryshimin e këtij traktati. Nëse Këshilli pas konsultimeve me Parlamentin, dhe kur është e nevojshme dhe me Komisionin, jep një mendim pro thirrjes së një konference të përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare, Konferenca mbledhet nga Presidenti i Këshillit për qëllimet e përcaktimit me marrëveshje të ndërsjellë të ndryshimeve që do t'i bëhen këtij traktati.

Ndryshimet hyjnë në fuqi pas ratifikimit nga të gjithë Shtetet Anëtare në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse kushtetuese.

#### Neni 205

Çdo shtet europian mund të paraqesë kërkesë për t'u bërë anëtar i Komunitetit. Ai ia dorëzon kërkesën e tij Këshillit, i cili vepron me unanimitet pas marrjes së opinionit të Komisionit.

Kushtet e pranimit dhe të rregullimeve të këtij traktati, që bëhen të nevojshme në këtë mënyrë, janë objekt i një marrëveshjeje ndërmjet Shteteve Anëtare dhe shtetit kërkues. Kjo marrëveshje dorëzohet për ratifikim nga të gjithë shtetet kontraktuese në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse kushtetuese.

#### Neni 206

Komuniteti mund të përfundojë me një shtet të tretë, një bashkim shtetesh ose një organizatë ndërkombëtare marrëveshje për krijimin e një shoqate që përfshin të drejta dhe detyrime reciproke, veprim të ndërsjellë dhe procedura të veçanta.

Këto marrëveshje përfundohen nga Këshilli, me votim unanim pas konsultimit me Parlamentin.

Kur marrëveshje të tilla bëjnë thirrje për ndryshime të këtij traktati, këto ndryshime miratohen së pari në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 204.

#### Neni 207

Protokollet që i bashkëngjiten këtij traktati me marrëveshje të ndërsjellë të Shteteve Anëtare, janë pjesë përbërëse e këtij traktati.

#### Neni 208

Ky traktat qëndron në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

## **TITULLI GJASHTË**

### **DISPOZITA QË LIDHEN ME PERIUDHËN FILLESTARE**

SEKSIONI I  
**Krijimi i Institucioneve**

Neni 209

Këshilli mblidhet brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të këtij traktati.

Neni 210

Këshilli, brenda tre muajve nga takimi i tij i parë, merr të gjitha masat e nevojshme për të krijuar Komitetin Ekonomik dhe Social.

Neni 211

Parlamenti mblidhet brenda dy muajve nga takimi i parë i Këshillit, i cili thirret nga Presidenti i Këshillit, në mënyrë që të zgjedhë nëpunësit e tij, dhe drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

Neni 212

Gjykata e Drejtësisë i merr detyrat e saj sapo emërohen anëtarët e saj. Kryetari i saj i parë emërohet për tre vjet dhe në të njëjtën mënyrë si anëtarët e saj.

Gjykata e Drejtësisë miraton rregulloren e saj brenda tre muajve nga fillimi i punës.

Gjykatës së Drejtësisë nuk mund t'i çohet asnjë çështje para botimit të rregullores së saj. Koha në të cilën mund të ngrihet një padi fillon vetëm nga data e botimit të rregullores.

Me emërimin e tij, Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë ushtron kompetencat që i jepen nga ky traktat.

Neni 213

Komisioni i fillon funksionet e tij dhe i merr përgjegjësitë që i njihen nga ky traktat sapo të jenë emëruar anëtarët e tij.

Me fillimin e detyrave, Komisioni merr përsipër studime, përcakton kontaktet me Shtetet Anëtare, sipërmarrësit, punëtorët dhe konsumatorët që nevojiten për të bërë një sondazh të përgjithshëm të situatës së industrive bërthamore në Komunitet. Komisioni i dërgon një raport me këtë objekt Parlamentit brenda gjashtë muajve.

Neni 214

1. Viti i parë financiar shtrihet nga data e hyrjes në fuqi të këtij traktati deri më 31 dhjetor. Por, nëse ky traktat hyn në fuqi gjatë gjysmës së dytë të vitit, viti financiar shtrihet deri më 31 dhjetor të vitit pasardhës.

2. Deri sa të hartohen buxhetet për vitin e parë financiar, Shtetet Anëtare i japin Komunitetit parapagesa pa interes, të cilat më pas do t'u zbriten nga kontributet e tyre financiare për zbatimin e këtyre buxheteve.

3. Deri sa të jenë parashikuar rregullore të stafit të zyrtarëve dhe kushtet e punësimit për nëpunësit e tjerë të Komunitetit, të cilat parashikohen në nenin 186, çdo institucion merr në punë stafin që i nevojitet, dhe për këtë qëllim lidh me ta kontrata me kohëzgjatje të kufizuar.

Së bashku me Këshillin, çdo institucion shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me numrin, pagën dhe shpërndarjen e vendeve të punës.



SEKSIONI II  
**Dispozita për zbatimin fillestar të këtij traktati**

Neni 215

1. Brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij traktati, kryhet një program fillestar kërkimi dhe trajnimi, siç parashikohet në Shtojcën V të këtij traktati, kostoja e të cilit nuk e kalon shumën prej 215 milionë EPU (njësi llogarie), me përjashtim të rastit kur vendoset unanim ndryshe nga Këshilli.

2. Ndarja e shpenzimeve të nevojshme për zbatimin e këtij programi bëhet sipas ilustrimit në ndarjet kryesore në Shtojcën V.

Këshilli, me shumicë të cilësuar me propozim të Këshillit, mund ta ndryshojë këtë program.

Neni 216

Propozimet e Komisionit mbi mënyrën se si funksionon institucioni i statusit të universitetit, të cilit i referohet neni 9, i dorëzohen Këshillit brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij traktati.

Neni 217

Rregulloret e sigurimit që parashikohen në nenin 24, që lidhen me nivelin e sigurimit që përdoret për shpërndarjen e informacionit, miratohen nga Këshilli brenda gjashtë muajve të hyrjes në fuqi të këtij traktati.

Neni 218

Standardet bazë përcaktohen në përputhje me dispozitat e nenit 31 brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij traktati.

Neni 219

Dispozitat e parashikuara në ligj, rregullore ose akt administrativ për të siguruar mbrojtjen e shëndetit të publikut të përgjithshëm dhe të punëtorëve në territoret e Shteteve Anëtare, kundër rreziqeve që dalin nga rrezatimet jonizuese, në përputhje me nenin 33, i komunikohen Komisionit nga këto shtete brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij traktati.

Neni 220

Propozimet e Komisionit që lidhen me statutet e Agjencisë që parashikohen në nenin 54 i dërgohen Këshillit tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij traktati.

SEKSIONI III

**Dispozita Kalimtare**

Neni 221

Dispozitat e neneve 14 deri në 23 dhe të neneve 25 deri në 28 zbatohen për patentat, të drejtat e patentave të mbrojtura me kusht dhe modeleve të përdorimit, si dhe për patentat dhe zbatimet e modeleve të përdorimit në fuqi, para hyrjes në fuqi të këtij traktati, sipas kushteve të mëposhtme:

1. Kur vlerësimi i periudhës së kohës që i referohet nenit 17 paragrafi (2) në favor të pronarit bëhet një lëshim për situatën e re të krijuar nga hyrja në fuqi e këtij traktati.

2. Në lidhje me komunikimin e një shpikjeje që nuk është sekret, ku si periudha prej tre muajsh edhe ajo prej tetë muajsh që përmenden në nenin 16 kanë skaduar në datën e hyrjes në fuqi të këtij traktati, nga ajo datë kalon dhe një periudhë tjetër prej gjashtë muajsh.

Nëse ndonjëra, ose të dyja këto periudha nuk kanë përfunduar deri në atë datë, ato shtyhen me gjashtë muaj nga data e përfundimit të tyre normal.

3. Të njëjtat dispozita zbatohen për komunikimin e një shpikjeje sekrete në përputhje me nenin 6 dhe 25 pika (1); gjithsesi, në një rast të tillë, data e hyrjes në fuqi e rregulloreve të sigurimit të cilave u referohet neni 24 është data e marrë si pikë fillestare për periudhën e re ose për zgjatjen e periudhës aktuale.

#### Neni 222

Gjatë periudhës nga data e hyrjes në fuqi të këtij traktati dhe deri në datën e caktuar nga Komisioni, në të cilën Agjencia merr detyrat e saj, marrëveshjet dhe kontratat për furnizimin e xeherorëve ose të materialeve të veçanta të zërthyeshme përfundojnë ose rinovohen vetëm pas miratimit paraprak të Komisionit.

Komisioni refuzon të miratojë përfundimin ose rinovimin e çdo marrëveshjeje dhe kontrate që ai mendon se dëmton zbatimin këtij traktati. Në veçanti, ai mund ta bazojë miratimin e tij në varësi të futjes në marrëveshje dhe kontrata të klauzolave që e lejojnë Agjencinë të marrë pjesë në kryerjen e tyre.

#### Neni 223

Duke u shmangur nga dispozitat e nenit 60, reaktorët e instaluar në territoret e një Shteti Anëtar, të cilët mund të bëhen kritikë para përfundimit të periudhës prej shtatë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij traktati, gjatë një periudhe prej jo më shumë se 10 vjetësh nga kjo datë, në mënyrë që të merret parasysh puna dhe studimet e filluara, mund të marrin përparësi, që mund të ushtrohet si për furnizuesit me xeherorë ose materiale burimore që vijnë nga territori i atij shteti, dhe për furnizuesit e materialeve burimore, për materiale të veçanta të zërthyeshme, që janë objekt i një marrëveshjeje dypalëshe të përfunduar para hyrjes në fuqi të këtij traktati, dhe që i komunikohen Komisionit në përputhje me nenin 105.

E njëjta përparësi jepet gjatë të njëjtës periudhë prej dhjetë vjetësh për sa i përket furnizimeve për impiante ndarjesh izotopesh, pavarësisht nëse ai përbën një sipërmarrje të përbashkët ose jo, që futet në veprim në territorin e një Shteti Anëtar para përfundimit të një periudhe prej shtatë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi e këtij traktati.

Agjencia përfundon kontratat e nevojshme, pasi Komisioni siguron se janë plotësuar kushtet për ushtrimin e të drejtës të përparësisë.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

## Neni 224

Ky traktat ratifikohet nga Palët e Larta Kontraktuese, në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse kushtetuese. Instrumentet e ratifikimit depozitohen në Qeverinë e Republikës së Italisë.

Ky traktat hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit nga shteti i fundit nënshkruar. Nëse depozitimi bëhet më pak se pesëmbëdhjetë ditë para fillimit të secilit muaj, ky traktat nuk hyn në fuqi deri në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së këtij depozitimi.

## Neni 225

Ky traktat i hartuar në një kopje origjinale të vetme, në holandisht, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht, ku të katër tekstet janë njëlloj me origjinalin, depozitohen në arkivat e Qeverisë së Republikës së Italisë, e cila i jep një kopje të certifikuar secilës prej qeverive të shteteve të tjera nënshkruese.

Në prani të tyre, traktati nënshkruhet nga të Plotfuqishmit e mëposhtëm:

I nënshkuar në Romë, më datë njëzet e pesë maj të vitit një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë.

P. H. SPAAK.  
ADENAUER.  
PINEAU.  
Antonio SEGNI.  
BECH.  
J. LUNS.

J. Ch. SNOY et d'OPPUERS.  
HALLSTEIN.  
M. FAURE.  
Gaetano MARTINO.  
Lambert SCHAUS.  
J. LINTHORST HOMAN.

## **SHTOJCA**

### **SHTOJCA I**

#### **Fushat e kërkimit në lidhje me energjinë atomike të përmendura në nenin 4 të këtij traktati**

##### **I. Materialet e papërpunuara**

1. Metoda për zbulimin dhe nxjerrjen e lëndëve të papërpunuara bazë (uranium, torium, dhe produkte të tjera me rëndësi të veçantë në fushën e energjisë atomike).
2. Metoda të përqendrimit të këtyre lëndëve minerale dhe shndërrimin e tyre në përbërës teknikisht të pastër.
3. Metoda e shndërrimit të përbërësve teknikisht të pastër në përbërës dhe metale me gradë nukleare.
4. Metoda për kthimin dhe përpunimin e këtyre përbërësve dhe metaleve, si edhe plutoniumit, uraniumit-235 ose uraniumit-233, të pastër ose të përzier me këto përbërës ose metale, në elemente djegës prej industrive metalurgjike, kimike dhe të qeramikës.
5. Metoda për mbrojtjen e këtyre elementeve djegës ndaj gërryerjes ose erozionit nga agjentë të jashtëm atmosferikë.
6. Metoda të prodhimit, rafinimit, përpunimit dhe ruajtjes së materialeve të tjera speciale të përdorshëm në fushën e energjisë atomike, në veçanti:
  - (a) Moderatorët: si uji i rëndë, grafiti i gradës nukleare, beriliumi dhe oksidi i beriliumit;
  - (b) Materiale strukturore si zirkonium (pahafnium), niobium, lanthanum, titanium, berilium dhe oksidet e tyre, karbitet dhe përbërës të tjerë të aftë, që përdoren në fushën e energjisë atomike;

(c) Ftohësa, të tillë si heliumi, likuide organike, natriumi, aliazhe natrium-kaliumi, bismuthi, aliazhe plumb-bismuth.

7. Metoda të ndarjes së izotopeve:

- (a) për uraniumin;
- (b) për materiale në nivele të ponderueshëm, të cilët mund të përdoren në prodhimin e energjisë atomike, të tillë si litium-6, litium-7, azoti-15 dhe bori-10;
- (c) për izotope të përdorur në sasi të vogla për kërkim shkencor.

## II. Fizika e zbatuar në energjinë atomike

1. Fizika teorike e zbatuar:

- (a) reaksionet bërthamore me energji të ulët, në veçanti reaksionet me induktim neutroni;
- (b) zbërthimi atomik (fizioni);
- (c) ndërveprimi i rrezatimit jonizues dhe fotoneve me lëndën;
- (d) teoria e gjendjes së ngurtë;
- (e) studimi i fuzionit, me përqendrim të veçantë në sjelljen e një plazme të jonizuar nën veprimin e forcave elektromagnetike dhe të termodinamikës në temperatura ekstremisht të larta.

2. Fizika eksperimentale e zbatuar:

- (a) të njëjtat subjekte të specifikuar më sipër në 1;
- (b) studimi i vetive të elementeve transuranike dhe rëndësisë në fushën e energjisë atomike.

3. Llogaritjet mbi reaktorët:

- (a) fizika teorike makroskopike e neutronit;
- (b) matjet eksperimentale mbi neutronet; eksperimentet eksponenciale dhe kritike;
- (c) përlllogaritjet termodinamike dhe llogaritjet e fortësisë së materialeve;
- (d) matjet eksperimentale korresponduese;
- (e) kinetika e reaktorit, probleme për kontrollin e reaktorit dhe eksperimente relevante;
- (f) përlllogaritjet për mbrojtjen ndaj rrezatimit dhe eksperimente që kanë lidhje me të.

## III. Kimia fizike e reaktorëve

1. Studimi i ndryshimeve në strukturën fizike dhe kimike, dhe të ndryshimeve në karakteristikat teknike të materialeve të ndryshme në reaktorë të shkaktuara nga:

- (a) nxehtësia;
- (b) natyra e agjentëve me të cilën ato janë në kontakt;
- (c) faktorët mekanikë.

2. Studimi i degradimit dhe fenomeneve të tjera të prodhuar prej rrezatimit në:

- (a) elementet djegës;
- (b) materiale strukturore dhe ftohësa;
- (c) moderatorë.

3. Zbatimi i kimisë analitike dhe kimisë fizike analitike në komponentët e reaktorit.

4. Kimia fizike e reaktorëve homogjenë: radiokimia, gërryerja.

#### IV. Përpunimi i materialeve radioaktive

1. Metodat e nxjerrjes së plutoniumit dhe uraniumit-233 nga lëndët djegëse të rrezatuara, dhe ripërftimi i mundshëm i uraniumit ose toriumit.
2. Kimia dhe metalurgjia e plutoniumit.
3. Metodat e nxjerrjes dhe kimia e elementeve të tjera transuranike.
4. Metodat e nxjerrjes dhe kimia e radioizotopeve të përdorshëm:
  - (a) produktet e zbërthimit (fizionit) bërthamor
  - (b) radioizotope të fituara prej rrezatimit.
5. Përqendrimi dhe ruajtja e mbetjeve radioaktive të papërdorshëm.

#### V. Zbatime të radioizotopeve

Zbatimi i radioizotopeve si elemente aktivë ose gjurmues në:

- (a) industri dhe shkencë;
- (b) mjekësi dhe biologji;
- (c) bujqësi.

#### VI. Studimi i efekteve të dëmshëm të rrezatimit mbi organizmat e gjallë

1. Studimi i zbulimit dhe matjes së rrezatimeve të dëmshëm.
2. Studimi i masave të duhura parandaluese dhe mbrojtëse dhe standardeve përkatëse të sigurisë.
3. Studimi i trajtimit të efekteve të rrezatimit.

#### VII. Pajisjet

Studime që kanë lidhje me ndërtimin dhe përmirësimin e pajisjeve, veçanërisht të destinuara jo vetëm për reaktorë, por gjithashtu për çdo instalim industrial apo kërkimor i kërkuar për aktivitete kërkimi shkencor të renditura më sipër. Disa shembuj që mund të përmenden:

1. Llojet e pajisjeve mekanike në vijim:
  - (a) pompa për lëngje speciale;
  - (b) këmbyes nxehtësie;
  - (c) aparate për kërkim shkencor në fizikën bërthamore, si selektorë neutronesh me shpejtësi;
  - (d) pajisje për manovrim në distancë.
2. Llojet e pajisjeve elektrike në vijim:
  - (a) instrumente për kapjen dhe matjen e rrezatimit, të përdorura veçanërisht në:
    - zbulimin gjeologjik të mineraleve,

- kërkimin shkencor dhe teknik,
  - kontrollin e reaktorit,
  - shëndet dhe siguri;
- (b) pajisje për kontrollin e reaktorit;
- (c) akseleratorë të grimcave me energji të ulët (deri në 10 MeV).

#### VIII. Aspekte ekonomike të prodhimit të energjisë

1. Studime krahasuese, njëkohësisht teorike dhe eksperimentale, të llojeve të ndryshme të reaktorëve.
2. Studime ekonomike dhe teknike të cikleve të lëndëve djegëse.



## SHTOJCA II

### **Aktivite industriale të përmendura në nenin 41 të këtij traktati**

1. Nxjerrja minerare e xeherorëve të uraniumit dhe toriumit.
2. Pasurimi mineral i tyre.
3. Përpunimi dhe rafinimi kimik i koncentreve të uraniumit dhe toriumit.
4. Përgatitja e lëndëve djegëse bërthamore, në çdo trajtë.
5. Fabrikimi i elementeve të lëndëve djegëse bërthamore.
6. Prodhimi i hekzaflorur uraniumit.
7. Prodhimi i uraniumit të pasuruar.
8. Përpunimi i lëndëve djegëse të rrezatuara me qëllim ndarjen e disa ose të gjithë elementeve përbërës të tyre.
9. Prodhimi i moderatorëve të reaktorëve.
10. Prodhimi i zirkoniumit i tipit pahafmium ose komponentëve prej tyre.
11. Reaktorët bërthamorë të të gjithë tipeve dhe për çdo qëllim.
12. Lehtësira për përpunimin industrial të mbetjeve reaktive, të ndërtuara në afërsi me një të tjetër ose disa prej lehtësirave të specifikuar në këtë listë.
13. Instalimet gjysmëindustriale, me qëllim përgatitjen e rrugës për ndërtimin e uzinave të përfshira në çdo njërin prej aktiviteteve 3 deri në 10.

## SHTOJCA III

### **Përparësitë të cilat mund të diskutohen në sipërmarrjet e përbashkëta sipas nenit 48 të këtij traktati**

1. (a) Njohja që statusi i interesit publik në përputhje me ligjet kombëtare zbatohet në zotërimin e pronës së paluajtshme të kërkuar, për krijimin e sipërmarrjeve të përbashkëta.  
(b) Zbatimi i procedurave kombëtare për zotërimin e detyruar në bazë të interesit publik, me qëllim që ky përvetësim të hyjë në fuqi atje ku nuk arrihet marrëveshje miqësore.
2. E drejta për të lëshuar licenca, nëpërmjet arbitrazhit ose sipas kompetencave detyruese parashikohet në nenet 17 deri në 23.
3. Përrjashtimi nga të gjitha taksat dhe tatimet dhe nga të gjitha tatimet mbi asetet e kontribuara pas krijimit të sipërmarrjeve të përbashkëta.

4. Përrjashtimi nga të gjitha taksat dhe tatimet mbi blerjen e pronës së paluajtshme dhe nga të gjitha tarifaf e regjistrimit dhe të arkivimit.

5. Përrjashtimi nga të gjitha taksat e drejtpërdrejta mbi sipërrmarrjet e përrbashkëta, pronën e tyre, asetet dhe të ardhurat që do të paguheshin në rast të zakonitë.

6. Përrjashtimi nga të gjitha taksat doganore dhe detyrimet që kanë efekt të njëjtë, dhe nga të gjitha pengesat ligjore dhe kufizimet në importe ose eksporte, qoftë të një natyre ekonomike apo fiskale, duke marrë parasysh:

(a) pajisjet teknike dhe shkencore, duke përrjashtuar materialet e ndërimit dhe pajisjet për qëllime administrative;

(b) substanca të cilat janë përrpunuar ose do të përrpunohen në sipërrmarrjen e përrbashkët.

7. Marrëveshje shkëmbimi të parashikuara në nenin 182 pika (6).

8. Përrjashtimi nga pengesat në hyrje dhe e drejta e banimit për qytetarët e Shteteve Anëtare të punësuar nga sipërrmarrje të përrbashkëta dhe për bashkëshortët e tyre, si edhe pjesëtarët e tjerë të familjes nën varësi.

## SHTOJCA IV

### **Lista e materialeve dhe produkteve subjekt i dispozitave të kapitullit IX në tregun e përbashkët bërthamor**

#### LISTA A<sup>1</sup>

Xeherorë uraniumi që përmbajnë më tepër se 5 për qind të peshës uranium natyror.

Pitchblende përmban më tepër se 5 për qind të peshës së uraniumit natyror.

Oksid uraniumi.

Përbërës inorganikë të uraniumit natyror duke përjashtuar oksidin e uraniumit dhe hekzaflorurin e uraniumit.

Përbërës organikë të uraniumit natyror.

Uranium natyror i përpunuar ose i papërpunuar.

Aliazhe të cilët përmbajnë plutonium.

Përbërës organikë dhe inorganikë të uraniumit të pasuruar me komponime organike ose inorganike ose uranium-235.

Përbërës organikë ose inorganikë ose uranium-233.

Torium i pasuruar me uranium-233.

Komponime organike ose inorganike ose plutonium.

Uranium i pasuruar me plutonium.

Uranium i pasuruar me uranium-235.

Aliazhe që përmbajnë uranium të pasuruar me uranium-233 ose uranium-233.

Plutonium.

Uranium-233.

Hekzaflorur uraniumi.

Monazite.

Xeherorë toriumi të cilët përmbajnë më tepër se 20 për qind në masë torium.

Urano-torianite që përmbajnë më tepër se 20 për qind në masë torium.

Torium i përpunuar ose i papërpunuar (krudo).

Oksid toriumi.

Përbërës inorganikë të toriumit me përjashtim të oksidit të toriumit.

Përbërës organikë të toriumit.

## LISTA A<sup>2</sup>

Deuteriumi dhe komponimet e tij (duke përfshirë edhe ujin e rëndë), në të cilët raporti i numrit të atomeve deuterium ndaj atomeve të zakonshëm hidrogjen i kalon 1 : 5000.

Parafinat e rënda, në të cilat raporti i numrit të atomeve deuterium ndaj atomeve të zakonshëm hidrogjen e kalon 1 : 5000.

Përzierjet dhe tretësirat, në të cilat raporti i numrit të atomeve deuterium ndaj atomeve të zakonshëm hidrogjen e kalon 1 : 5000.

Reaktorët bërthamorë.

Pajisje për ndarjen e izotopeve të uraniumit me difuzion të gaztë ose metoda të tjera.

Pajisje për prodhimin e deuteriumit, komponimeve të tij (duke përfshirë ujin e rëndë) dhe derivatet, si dhe përzierjet ose tretësirat që përmbajnë deuterium, në të cilin raporti i numrit të atomeve deuterium ndaj atomeve hidrogjen të zakonshëm i kalon 1 : 5000.

- pajisje e cila punon me anë të elektrolizës së ujit;
- pajisje e cila punon me anë të distilimit të ujit, hidrogjenit të lëngshëm, etj;
- pajisje e cila punon me këmbim izotopik ndërmjet acidit sulfhidrik dhe ujit me anë të ndryshimit të temperaturës;
- pajisje e cila punon me teknika të tjera.

Pajisje të projektuara posaçërisht për përpunimin kimik të materialit radioaktiv:

- pajisje për ndarjen e lëndës djegëse të rrezatuar:
  - o me anë të proceseve kimike (solventëve, precipitimit, këmbimit jonik, etj.);
  - o me anë të proceseve kimike (distilimi i fraksionuar, etj.);
- pajisje për përpunimin e mbetjeve;
- pajisje për riciklimin e lëndëve djegëse.

Mjete transporti të projektuara posaçërisht për transportin e substancave me radiokativitet të lartë:

- vagonë hekurudhorë, karro mallrash dhe kamionë për transportim;
- kamionçina
- kamionë për punë të motorizuara për manipulimin e ngarkesave;
- rimorkio dhe gjysmërimorkio dhe të tjera pajisje jo të motorizuara.

Kontenierë me ekran plumbi kundrarrezatimit për transportimin ose magazinimin e materialit radioaktiv.

Izotope radioaktive artificiale dhe komponimet e tyre organike dhe inorganike.

Manipulatorë në distancë me kontroll mekanik të projektuar posaçërisht për manipulimin e substancave radioaktive:

- mekanizëm mekanik manipulimi, i stacionuar ose i lëvizshëm, por i paaftë të mund të përdoret në mënyrë manuale.

## LISTA B

Përbërës dhe pjesë për reaktorët bërthamorë.

Xeherorë litiumi dhe koncentre.

Metale me gradë nukleare:

- berilium i papërpunuar
- bismuth i papërpunuar
- niobium i papërpunuar (kolumbium);
- zirkonium i papërpunuar (pa-hafmium);
- litium i papërpunuar;
- alumin i papërpunuar;
- kalcium i papërpunuar;
- magnez i papërpunuar;

Triflorur bori.

Acid fluorhidrik anhidër.

Triflorur klori.

Triflorur bromi.

Hidroksid litiumi.

Florur litiumi.

Klorur litiumi.

Hidrir litiumi.

Karbonat litiumi.

Oksid beriliumi me gradë-nukleare.

Tulla refraktare me oksid beriliumi me gradë nukleare.

Produkte të tjera refraktare me oksid beriliumi me gradë nukleare.

Grafite artificiale në formën e blloqeve ose telave, në të cilat përmbajtja e borit është më e vogël ose e barabartë me një pjesë për milion, dhe në të cilën absorbimi neutronik termal mikroskopik i përgjithshëm në sipërfaqen e kontaktit është më i vogël ose i barabartë me 5 milibarn.

Izotope të qëndrueshme të ndara artificialisht.

Separatorë jonike elektromagnetikë, duke përfshirë mas-spektrografët dhe mas-spektrometrat.

Simulatorë reaktorësh (kompjutera specialë analogë).

Manipulatorë në distancë të kontrolluara mekanikisht:

- kontroll manual (p.sh. operim manual i ngjashëm me një instrument).

Pompa për metale të lëngshme.

Pompa me vakum të lartë.

Këmbyes nxehtësie të projektuar posaçërisht për stacionet e centraleve bërthamore.

Instrumente detektimi rrezatimi (dhe pjesë ndërrimi) të një prej llojeve të mëposhtëm, të projektuar posaçërisht, ose të adaptueshëm, për detektimin e matjes së rrezatimit bërthamor, të tilla si grimcat alfa dhe beta, rrezatimi gama, neutrone dhe protone;

- njësi numëruese Geiger (tub) ose njësi numëruese proporcionale;
- instrumente detektimi ose matëse duke përfshirë tubat Geiger-Muller ose njësi numëruese proporcionale:
- dhoma jonizimi;
- instrumente që përfshijnë dhomat e jonizimit;
- detektim rrezatimi ose pajisje matëse për zbulimin e vendburimeve të reja minerare dhe për monitorimin e reaktorëve, ajrit, ujit dhe dherave;
- detektor tub të neutroneve që përdorin borin, triflorur bori, hidrogjen ose një element i zbërthyeshëm.
- Detektim ose instrumente matës që përfshijnë detektor tub neutronesh që përdorin borin, triflorur bori, hidrogjen ose një element i zbërthyeshëm.
- Kristale xixëlluese të fiksuar ose në një shtresë metalike (shkëlqyesit e ngurtë);
- Detektim ose instrumente matës që përfshijnë shkëlqyes të lëngshëm, të ngurtë ose të gaztë.
- Amplifikatorë të projektuar posaçërisht për matje nukleare, duke përfshirë amplifikatorë linearë, preamplifikatorë, amplifikatorë të shpërndarë dhe analizues me impulse të larta;
- Pajisje të rastit për përdorim me detektorë rrezatimi;
- Elektroskopë dhe elektrometra, që përfshijnë dozimetra (por që përjashtojnë instrumente të destinuar për qëllime udhëzuese, elektroskopë me fletë metalike të thjeshta, dozimetra të projektuar posaçërisht për përdorim me pajisje mjekësore me rrezatim-X dhe instrumente matës elektrostatikë);
- Instrumente të specializuar për matjen e rrymave më të vogla se një pikoamper;
- Tuba fotomultiplikatorë me një fotokatodë, e cila jep një rrymë me të paktën 10 mikroamper për lumen, dhe në të cilën amplifikimi mesatar është më i madh se  $10^5$ , dhe të çdo lloji tjetër multiplikatori elektrik i aktivizuar nga jone pozitive;
- Shkallëzues dhe pajisje matëse elektronike të integruar për detektimin e rrezatimit.

Ciklotrone, Van de Graaff ose gjeneratorë elektrostatikë Kokroft-Valton, akseleratorë linearë dhe makineri të tjera të afta të japin një energji më të lartë se 1 MeV grimcash nukleare.

Magnete të projektuar dhe të ndërtuar posaçërisht për makineritë dhe makineritë e sipër-përmendura (Ciklotrone, etj).

Tuba përshpejtues dhe fokusues të tipit të përdorur në mas-spektrometra dhe mas-spektrografë.

Burime elektronike të fuqishme të joneve pozitive të destinuara për përdorim me akseleratorë grimcash, mas-spektrometrash dhe pajisje të ngjashme.

Pasqyra të rrafshëta antirrezatimi:

- modele ose pasqyra të rrafshëta rrethore (duke përfshirë edhe pjatat rrjeta ose flesh) në katrore ose drejtkëndësha, me sipërfaqe të sheshtë por jo punë të mëtejshme;

- modele ose pasqyra të rrafshëta rrethore (qofshin këto të rrafshët ose pastruar) prerë në formë të ndryshme katrori ose drejtkëndëshi, ose të kurbuar ose ndryshe të modeluara (për shembull, të pjerrëta ose të gdhendura);
- syze sigurie, të prodhuara prej xhami të laminuar ose rezistent, me formë ose jo.

Veshje hermetike të afta të mbrojnë nga rrezatimi ose ndotja radioaktive:

- prodhuar prej materiali plastik;
- prodhuar prej materiali gome;
- prodhuar prej fabrikatesh të imprenjuara ose të mbuluar:
- për burra;
- për gra.

Difenili (një hidrokarbur aromatik:  $C_6H_5-C_6H_5$ ).

Terfenili.

## SHTOJCA V

### **Kërkimi shkencor fillestar dhe programet e trajnimit referuar nenit 215 të këtij traktati**

#### I. Programi i Qendrës së Përbashkët

##### 1. Laboratorë, pajisje dhe infrastrukturë.

Qendra e përbashkët duhet të përfshijë:

- laboratorë të përgjithshëm për kiminë, fizikën, elektronikën dhe metalurgjinë;
- laboratorë specialë për subjektet e mëposhtëm:
  - fuzioni nuklear;
  - ndarje e izotopeve përveç uranium-235 (ky laborator duhet të pajiset me një separator elektromagnetik me rezolucion të lartë);
  - prototipe të instrumenteve të sondave gjeologjike;
  - mineralogji;
  - radiobiologji;
- një zyrë e standarteve e specilizuar në matjet bërthamore, për analiza izotopike dhe matje të sakta të rrezatimit dhe absorbimit neutronik, i pajisur me reaktorin e tij eksperimental.

##### 2. Dokumentacion, informim dhe trajnim.

Qendra e Përbashkët duhet të bashkëpunojë për një shkëmbim informacioni në nivel të lartë, veçanërisht në fushat e mëposhtme:

- materiale të papërpunuara: metoda gjeologjike, minerare, përqendrimi, shndërrimi, përpunimi, etj;
- fizika e zbatuar në energjinë atomike;
- përpunimi i materialeve radioaktive;
- zbatime të radioizotopeve.

Qendra e Përbashkët duhet të organizojë kurse specializimi që kanë të bëjnë veçanërisht me trajnimin e gjeologëve dhe në zbatimet e radioizotopeve.

Dokumentacioni mbi shëndetin dhe sigurinë, dhe seksioni i studimit paraqitur në artikullin 39 duhet të përmbledhë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm.

### 3. Prototipe reaktorësh.

Menjëherë pasi traktat hyn në fuqi, duhet të ngrihet një grup ekspertësh. Pas krahasimit të programeve të Shteteve Anëtare, ai duhet të paraqesë në Komision, sa më shpejt të jetë e mundur, rekomandimet e duhura për zgjedhje në këtë fushë, rrugët dhe mënyrat e implementimit të tyre.

Është planifikuar të ndërtohen tre ose katër prototipe me energji të ulët dhe të marrin pjesë p.sh. duke furnizuar me lëndë djegëse dhe moderatorë në tre reaktorët energjetikë.

### 4. Reaktorët me fluks të lartë.

Qendra duhet që brenda një kohe sa më të shkurtër të ketë në dispozicion një reaktor me një fluks neutronik shumë të shpejtë, për testimin e materialeve nën rrezatim.

Studimet përgatitore duhet të ndërmerren për këtë qëllim sa më shpejt që nga momenti që ky traktat hyn në fuqi.

Reaktori me fluks të lartë duhet të pajiset me fusha të jashtme eksperimentale dhe laboratorë të përshtatshëm për përdoruesit.

## II. Kërkim shkencor i realizuar sipas kontratave jashtë Qendrës së Përbashkët

Një pjesë e konsiderueshme e punës kërkimore realizohet me kontrata jashtë Qendrës së Përbashkët në përputhje me nenin 10. Këto kontrata kërkimore mund të jenë në format e mëposhtme:

1. Kërkim plotësues me atë të Qendrës së Përbashkët që realizohet në fushat e fuzionit nuklear, ndarjes së izotopeve përveç uraniumit-235, kimi, fizikë, elektronikë, metalurgji dhe radiobiologji.
2. Deri në momentin që reaktori test dhe materialet e propozuara të vendosen në punë, Qendra duhet të marrë me qira hapësira për eksperimente në reaktorët me fluks të lartë të Shteteve Anëtare.
3. Qendra mund të përdorë instalime të specializuara të Sipërmarrjeve të Përbashkëta të themeluara në përputhje me Kapitullin V, duke nënshkruar me to, duke kontraktuar kërkime të një natyre shkencore të përgjithshme.

## **Ndarja sipas zërave kryesorë të shpenzimeve që kërkohen për të ndërmarrë një kërkim shkencor dhe program trajnimi**

	PAJISJE	OPERACIONE (1)	PAJISJE dhe/ose OPERACIONE	TOTAL
<b>I. QENDRA E PËRBASHKËT</b>				
1. Laboratorë, pajisje dhe infrastrukturë				



(a)	Laboratorë të përgjithshëm për kimi, fizikë, elektronikë dhe metalurgji .....	12			
(b)	Laboratorë Specialë:				
	Fuzion nuklear.....	3.5	Viti i 1 <sup>rë</sup> 1.3		
	Ndarje izotopesh (përveç U 235).....	2	Viti i 2 <sup>të</sup> 4.3		
	Gjeologji dhe mineralogji.....	1	Viti i 3 <sup>të</sup> 6.5		
(c)	Zyra qendrore për masat nukleare.....	3	Viti i 4 <sup>rt</sup> 7.4		
(d)	Pajisje të tjera për Qendrën dhe stabilimentet e saj	8	Viti i 5 <sup>të</sup> 8.5		
(e)	Infrastrukturë	8.5		2 8	

38

66

			Viti i 1 <sup>rë</sup> 0.6		
			Viti i 2 <sup>të</sup> 1.6		
2.	Dokumentacion, informim dhe trajnim.....	1	Viti i 3 <sup>të</sup> 1.6		
			Viti i 4 <sup>rt</sup> 1.6		
			Viti i 5 <sup>të</sup> 1.6		
				7	8
3.	Prototipe reaktorësh:				
	Grupi i ekspertëve për zgjedhjen e prototipave		Viti i 1 <sup>rë</sup> 0.7		
	Programi.....			59.3 (2)	60
4.	Reaktor me fluks të lartë:				
	Reaktor.....	15			
	Laborator.....	6	Viti i 4 <sup>rt</sup> 5.2		
	Zëvendësim pajisjesh.....	3	Viti i 5 <sup>të</sup> 5.2		
		24		1 0. 4	34.
	<b>II. KËRKIMI SHKENCOR I NDËRMARRË NËN NJË KONTRATË JASHTË QENDRËS</b>				
1.	Punë plotësuese me atë të Qendrës:				

	(a)	Kimi, fizikë, elektronikë, metalurgji..			25	
	(b)	Fuzion nuklear.....			7.5	
	(c)	Ndarje të izotopeve (përveç U235)...			1	
	(d)	Radiobiologji.....			3.1	
2.		Qiramarrje të hapësirës për reaktorët me fluks të lartë të Shteteve Anëtare			6	
3.		Kërkim shkencor i ndërmarrë në ndërmarrjet e përbashkëta.....			4	
					46.6	46.
		TOTALI.....	.....	.....	.....	215

(1) Llogaritje të bazuara në një staf prej 1000 punonjësish.

(2) Pjesë e kësaj shume mund të jenë për punë të ndërmarrë nën kontrata jashtë Qendrës

**PROTOKOLL**  
**mbi**  
**ZBATIMIN E TRAKTATIT**  
**themelues të**  
**KOMUNITETIT EUROPIAN**  
**TË ENERGJISË ATOMIKE**  
**PËR PJESËT JOEUROPIANE TË**  
**MBRETËRISË SË HOLANDËS**

## PALËT E LARTA KONTRAKTUESE

Të shqetësuar, në kohën e nënshkrimit të Traktatit që krijon Komunitetin Europian të Energjisë Atomike, për të përcaktuar objektin e parashikimeve të nenit 198 të këtij traktati në lidhje me Mbretërinë e Hollandës,

Ranë dakord për dispozitat e mëposhtme, të cilat do t'i shtohen këtij traktati:

Qeveria e Mbretërisë së Hollandës, për shkak të strukturës kushtetuese të Mbretërisë që rrjedh nga Statuti i 29 dhjetorit 1954, duke u shmangur nga neni 198, ka të drejtë të ratifikojë traktatin ose në emër të Mbretërisë së Hollandës në tërësi ose në emër të Mbretërisë në Europë, dhe të Guinesë së Re holandeze.

Në rast se ratifikimi i kufizohet Mbretërisë në Europë dhe në Guinean e Re, Qeveria e Mbretërisë së Hollandës në çdo kohë, me anë të njoftimit të Qeverisë së Italisë si vend depozitues i instrumenteve të ratifikimit, deklaron se ky traktat është i zbatueshëm në Surinam ose në Antilet holandeze, ose dhe në Surinam dhe në Antilet holandeze.

Nënshkruar në Romë, më datë njëzet e pesë maj të vitit një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë.

P. H. SPAAK.  
ADENAUER.  
PINEAU.  
Antonio SEGNI.  
BECH.  
J. LUNS.

J. Ch. SNOY et d'OPPUERS.  
HALLSTEIN.  
M. FAURE.  
Gaetano MARTINO.  
Lambert SCHAUS.  
J. LINTHORST HOMAN.

**PROTOKOLL  
MBI  
PRIVILEGJET DHE IMUNITETET**

PALËT E LARTA KONTRAKTUESE NË TRAKTATIN QË KRIJON KOMUNITETIN E ENERGISË ATOMIKE,

Duke pasur parasysh se, në përputhje me nenin 191 të këtij traktati, Komuniteti gëzon në territoret e Shteteve Anëtare privilegje dhe imunitete të tilla, që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, sipas kushteve të parashikuara në një protokoll të veçantë,

Kanë caktuar si të Plotfuqishmin e tyre për të hartuar këtë protokoll:

MADHËRINË E TIJ, MBRETIN E BELGËVE:

Baronin J. Ch. SNOY et d'OPPEURS, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Çështjeve Ekonomike, Kryetar i Delegacionit Belg në Konferencën Ndërqeveritare;

PRESIDENTIN E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË:

Profesor Dr. Carl Friedrich OPHÜLS, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë, Kryetar i Delegacionit Gjerman në Konferencën Ndërqeveritare;

PRESIDENTIN E REPUBLIKËS FRANCEZE:

Z. Robert Marjolin, Profesor i Së Drejtës, Zëvendës Kryetar i Delegacionit Francez në Konferencën Ndërqeveritare;

PRESIDENTIN E REPUBLIKËS ITALIANE:

Z. BADINI CONFALONIERI, Nënsekretar i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Kryetar i Delegacionit Italian në Konferencën Ndërqeveritare;

SHKËLQESINË E SAJ MBRETËRORE DUKESHËN E MADHE TË LUKSEMBURGUT:

Z. Lambert SCHAUS, Ambasador i Dukatit të Madh të Luksemburgut, Kryetar i Delegacionit Luksemburges në Konferencën Ndërqeveritare;

MADHËRINË E SAJ MBRETËRESHËN E HOLANDËS:

Z. J. LINTHORST HOMAN, Kryetar i Delegacionit Holandez në Konferencën Ndërqeveritare;

Të cilët, pasi shkëmbyen plotfuqitë e tyre, të shprehura në formën e duhur,

Ranë dakord për dispozitat e mëposhtme, të cilat i bashkëngjiten këtij traktati që krijon Komunitetin European të Energjisë Atomike:

KAPITULLI 1  
PRONA, FONDET, ASETET DHE VEPRIMET E KOMUNITETIT

---

Neni 1

Ambientet dhe ndërtesat e Komunitetit janë të pacenueshme. Ato përjashtohen nga kërkimet, rekuizimi, konfiskimi ose shpronësimi. Prona dhe asetet e Komuniteteve nuk janë objekt i asnjë mase administrative ose ligjore shtrëngimi pa autorizimin e Gjykatës së Drejtësisë.

Neni 2

Arkivat e Komunitetit janë të pacenueshme.

Neni 3

Komuniteti, asetet e tij, të ardhurat dhe prona të tjera, përjashtohen nga gjithë gjitha taksat e drejtpërdrejta.

Qeveritë e Shteteve Anëtare, kur është e mundur, marrin masat e nevojshme për të dërguar ose rifinancuar shumat e taksave të tërthorta ose taksave të shitjeve të përfshira në çmimin e pronave të luajtshme ose të paluajtshme, kur Komuniteti kryen për përdorimin e tij zyrtar blerje substanciale, çmimet e të cilave përfshijnë taksa të këtij lloji. Këto dispozita, gjithsesi, nuk zbatohen kur ato sjellin prishjen e konkurrencës brenda Komunitetit.

Nuk bëhet asnjë përjashtim në lidhje me taksat apo tarifatat, shumat e të cilave shkojnë vetëm për tarifatat e shërbimeve të ndërmarrjeve publike.

Neni 4

Komuniteti përjashtohet nga të gjitha tarifatat doganore, ndalimet dhe kufizimet për importet dhe eksportet, në lidhje me artikujt që synohen për përdorim zyrtar prej tij; artikujt që importohen në këtë mënyrë nuk çohen në territorin e vendit prej nga ku janë importuar, pavarësisht pagesës së bërë ose jo për kthimin e tyre, në përjashtim të rasteve kur parashikohet kështu nga qeveria e atij vendi.

Komuniteti përjashtohet gjithashtu nga çdo tarifë doganore dhe çdo ndalim ose kufizim për importet dhe eksportet në lidhje me botimet e tij.

## KAPITULLI 2

### KOMUNIKIMET DHE LEJET E KALIMIT

#### Neni 5

Për komunikimet e tyre zyrtare dhe përcjelljen e të gjithë dokumentacionit të tyre, institucionet e Komunitetit gëzojnë në territorin e çdo Shteti Anëtar, trajtimin që i ofrohet nga ai shtet misionëve diplomatike.

Korrespondenca zyrtare dhe komunikime të tjera zyrtare të institucioneve të Komunitetit nuk janë objekt censurimi.

#### Neni 6

Leja e kalimit (*laissez-passer*) është një dokument që hartohet nga Këshilli, që njihet si dokumentet e vlefshme të udhëtimit nga autoritetet e Shteteve Anëtare, i cili mund t'u jepet anëtarëve dhe nëpunësve të institucioneve të Komunitetit nga presidentët e këtyre institucioneve. Këto leje kalimi u jepen zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë sipas kushteve të parashikuara në rregulloret e stafit dhe kushtet e punësimit të parashikuara në nenin 186 të këtij traktati.

Komisioni mund të përfundojë marrëveshje për këto leje kalimi për t'u njohur si dokumente të vlefshëm udhëtimi brenda territorit të shteteve të treta.



### KAPITULLI 3 ANËTARËT E PARLAMENTIT

#### Neni 7

Për lëvizjen e lirë të anëtarëve të Parlamentit që udhëtojnë në vendin e mbledhjes së Parlamentit dhe prej tij gjetkë nuk vendoset asnjë kufizim administrativ apo i ndonjë lloji tjetër.

Anëtarët e Parlamentit, në lidhje me kontrollin doganor dhe atë të këmbimit, përfitojnë:

- (a) Nga qeveria e tyre, të njëjtat lehtësi si lehtësitë që u akordohen zyrtarëve të lartë shtetërorë që udhëtojnë jashtë shtetit për misione zyrtare të përkohshme;
- (b) Nga qeveritë e Shteteve të tjera Anëtare, të njëjtat lehtësi si lehtësitë që u akordohen përfaqësuesve të qeverive të huaja në misione zyrtare të përkohshme.

#### Neni 8

Anëtarët e Parlamentit nuk janë objekt i asnjë forme hetimi, ndalimi apo procesi ligjor, në lidhje me opinionet e shprehura ose votat e hedhura prej tyre gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

#### Neni 9

Gjatë seancave të Parlamentit, anëtarët e tij, gëzojnë:

- (a) Në territorin e shtetit të tyre, imunitetet që u janë dhënë anëtarëve të parlamentit të tyre;
- (b) Në territorin e çdo Shteti tjetër Anëtar, imunitete nga çdo masë ndalimi ose procesi ligjor.

Në të njëjtën mënyrë imuniteti zbatohet për anëtarët ndërkohë që ata udhëtojnë drejt dhe nga vendi i takimeve të Parlamentit.

Imuniteti nuk mund të pretendohet kur një anëtar kapet në flagrancë gjatë kryerjes së një veprë penale, dhe nuk e ndalon Parlamentin nga ushtrimi i të drejtës së tij për heqjen e imunitetit të një prej anëtarëve të tij.

KAPITULLI 4  
PËRFAQËSUESIT E SHTETEVE ANËTARE QË MARRIN PJESË NË PUNËN E INSTITUCIONEVE TË  
KOMUNITETIT

---

Neni 10

Përfaqësuesit e Shteteve Anëtare që marrin pjesë në punën e institucioneve të Komunitetit, këshilltarët e tyre dhe ekspertët teknikë, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë udhëtimit për në vendin e mbledhjes dhe prej tij, gëzojnë privilegje zakonore, imunitete dhe lehtësi.

Ky nen zbatohet edhe për anëtarët e organeve këshillimore të komunitetit.

KAPITULLI 5  
ZYRTARËT DHE NËPUNËSIT E TJERË TË KOMUNITETIT

Neni 11

Në territorin e secilit Shtet Anëtar dhe pavarësisht nga nënshtetësia e tyre, zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Komunitetit të cilëve u referohet neni 186 i këtij traktati:

- (a) subjekt i parashikimeve të neneve 152 dhe 188 të këtij traktati, kanë imunitet nga proceset ligjore, në lidhje me aktet e kryera prej tyre në kapacitetin e tyre zyrtar, duke përfshirë dhe fjalët e tyre të thëna ose të shkruara; ata vazhdojnë të gëzojnë të njëjtin imunitet dhe pasi nuk janë më në detyrë;
- (b) Së bashku me bashkëshortet/bashkëshortët e tyre dhe anëtarët e tjerë të familjes në vartësi, nuk janë objekt i kufizimeve të imigracionit ose formaliteteve për regjistrimin e të huajve;
- (c) Në lidhje me monedhën ose rregulloret e këmbimit, u jepen të njëjtat lehtësi siç u jepen zakonisht zyrtarëve ose organizatave ndërkombëtare;
- (d) Gëzojnë të drejtën e importimit pa tarifë nga vendi i fundit i banimit të tyre, ose nga vendi nënshtetas të të cilit ata janë, për mobiljet dhe plaçkat në kohën e marrjes së detyrës për herë të parë në vendin në fjalë, dhe të drejtën e rieksporimit pa tatim të mobiljeve dhe plaçkave me përfundimin e detyrave të tyre në atë vend, në çdo rast duke qenë objekt i kushteve që konsiderohen të rëndësishme nga qeveria e shtetit në të cilin ushtrohet e drejta;
- (e) Kanë të drejtë të importojnë pa tarifë një mjet motorik për përdorimin e tyre vetjak, të blerë ose në vendin e fundit të banimit ose në vendin nënshtetas të të cilit janë, sipas kushteve që zotërojnë në tregun e brendshëm të atij vendi, dhe për ta rieksportuar atë pa tarifë, duke iu nënshtruar në të dy rastet kushteve që mendohen si të nevojshme nga qeveria e shtetit përkatës.

Neni 12

Zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Komunitetit janë të detyruar të paguajnë një taksë në të mirë të Komunitetit për pagat, pagesat që u paguhen nga Komuniteti, në përputhje me kushtet dhe procedurën e përcaktuar nga Këshilli, i cili vendos mbi bazën e propozimeve që i dërgohen nga Komisioni brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij traktati.

Ata përjashtohen nga taksat kombëtare mbi pagat dhe pagesat e paguara nga Komuniteti.

Neni 13

Gjatë zbatimit të tatimit mbi të ardhurat, tatimit mbi pasurinë dhe tarifën e vdekjes, dhe në zbatimin e konventave për shmangien e tatimit të dyfishtë ndërmjet Shteteve Anëtare të Komunitetit, zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të

Komunitetit, të cilët, vetëm për arsye të kryerjes së detyrave të tyre në shërbim të Komunitetit, banojnë në territorin e një Shteti Anëtar të ndryshëm nga shteti i tyre i vendbanimit, për qëllime tatimi në kohën e hyrjes në shërbim të Komunitetit, konsiderohen si në shtetin e banimit të tyre aktual dhe në shtetin e vendbanimit, për qëllime tatimi, sikur e kanë ruajtur vendbanimin e tyre në shtetin ku kanë lejen e qëndrimit, me kusht që ai të jetë anëtar i Komunitetit. Dispozita zbatohet dhe për bashkëshorten/bashkëshortin deri në shkallën që ajo/ai nuk është e/i angazhuar më vete në një aktivitet fitimprurës, dhe për fëmijët që janë në varësi ose në kujdestari të personave që përmenden në këtë paragraf.

Prona e tundshme që u përket personave të cilëve u referohet paragrafi më lart, dhe që gjendet në territorin e vendit në të cilin qëndrojnë ata, përjashtohet nga tarifat e vdekjes në atë vend; një pronë e tillë, për vlerësimin e një tarife të tillë, konsiderohet se është në vendin e lejes së banimit për qëllime tatimi, dhe është objekt i të drejtave të vendeve të treta dhe i zbatimit të mundshëm të dispozitave të konventave ndërkombëtare të tatimit të dyfishtë.

Çdo leje banimi e përfituar vetëm për shkak të kryerjes së detyrave në shërbim të organizatave të tjera ndërkombëtare, nuk do të merret parasysh gjatë zbatimit të dispozitave të këtij traktati.

#### Neni 14

Këshilli me votim unanim me propozim të Komisionit brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij traktati, parashikon skemën e përfitimeve të sigurimeve sociale për zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë të Komunitetit.

#### Neni 15

Këshilli me votim me propozim të Komisionit dhe pas konsultimeve me institucione të tjera të lidhura, përcakton kategoritë e zyrtarëve dhe nëpunësve të tjerë të Komunitetit mbi të cilët zbatohen dispozitat e nenit 11, paragrafi i dytë i nenit 12 dhe neni 13 plotësisht ose pjesërisht.

Emrat, gradat dhe adresat e zyrtarëve dhe të nëpunësve të tjerë të përfshirë në kategori të tilla, u komunikohen periodikisht qeverive të Shteteve Anëtare.

### KAPITULLI 6

#### PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E MISIONEVE TË AKREDITUARA NË KOMUNITET

#### Neni 16

Shteti Anëtar në territorin e të cilit ka selinë Komuniteti, i jep imunitetet e zakonshme diplomatike misioneve të shteteve të treta që i akreditohen Komunitetit.

### KAPITULLI 7

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 17

Privilegjet, imunitetet dhe lehtësitë u jepen zyrtarëve ose nëpunësve të tjerë të Komunitetit vetëm në interes të Komunitetit.

Institucioneve të tjera të Komunitetit do t'u kërkohet të heqin imunitetin që i jepet një zyrtari ose nëpunësve të tjerë sa herë që ky institucion konsideron se heqja e një imuniteti të tillë nuk bie ndesh me interesat e Komunitetit.

## Neni 18

Institucionet e Komunitetit, për qëllimin e zbatimit të këtij protokollit, bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare përkatëse.

## Neni 19

Për anëtarët e Komisionit zbatohet neni 11 deri në nenin 14 dhe neni 17.

## Neni 20

Për gjyqtarët, avokatët e përgjithshëm, Kancelarin dhe ndihmës reporterët e Gjykatës së Drejtësisë zbatohen nenet 11 deri më 14 dhe neni 17, pa cenuar parashikimet e nenit 3 të Protokollit mbi Statutin e Gjykatës së Drejtësisë në lidhje me imunitetin në proceset gjyqësore të gjyqtarëve dhe të avokatëve të përgjithshëm.

Në praninë e tyre, të Plotfuqishmit nënshkruan këtë Protokoll.

Nënshkruar në Bruksel, më shtatëmbëdhjetë prill të vitit njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë.

J. Ch. SNOY et d'OPPUERS.

C. F. OPHÜLS.

Robert MARJOLIN

Vittorio BADINI

Lambert SCHAUS

J. LINTHORST HOMAN

**PROTOKOLL**  
**MBI**  
**STATUTIN E GJYKATËS SË DREJTËSISË**

# PALËT E LARTA KONTRAKTUESE TË TRAKTATIT THEMELUES TË KOMUNITETIT EUROPIAN TË ENERGJISË ATOMIKE

Duke dëshiruar të përpilojnë Statutin e Gjykatës, i parashikuar në nenin 160 të këtij traktati,  
Kanë caktuar si të Plotfuqishmit e tyre, për këtë qëllim:

## MADHËRINË E TIJ, MBRETIN E BELGËVE:

Baronin J. Ch. SNOY et d'OPPEURS, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Çështjeve Ekonomike, Kryetar i Delegacionit Belg në Konferencën Ndërqeveritare;

## PRESIDENTIN E REPUBIKËS FEDERALE TË GJERMANISË:

Profesor Dr. Carl Friedrich OPHÜLS, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë, Kryetar i Delegacionit Gjerman në Konferencën Ndërqeveritare;

## PRESIDENTIN E REPUBLIKËS FRANCEZE:

Z. Robert Marjolin, Profesor i Së Drejtës, Zëvendës Kryetar i Delegacionit Francez në Konferencën Ndërqeveritare;

## PRESIDENTIN E REPUBLIKËS ITALIANE:

Z. BADINI CONFALONIERI, Nënsekretar i Shtetit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Kryetar i Delegacionit Italian në Konferencën Ndërqeveritare;

## SHKËLQESINË E SAJ MBRETËRORE DUKESHËN E MADHE TË LUKSEMBURGUT:

Z. Lambert SCHAUS, Ambasador i Dukatit të Madh të Luksemburgut, Kryetar i Delegacionit Luksemburgez në Konferencën Ndërqeveritare;

## MADHËRINË E SAJ MBRETËRESHËN E HOLANDËS:

Z. J. LINTHORST HOMAN, Kryetar i Delegacionit Holandez në Konferencën Ndërqeveritare;

Të cilët, pasi kanë shkëmbyer plotfuqitë e tyre, të gjetura në formën e duhur,

Ranë dakord për dispozitat e mëposhtme, të cilat i bashkëngjiten Traktatit Themelues të Komunitetit Europian të Energjisë Atomike:

### Neni 1

Gjykata e parashikuar në nenin 3 të këtij traktati, krijohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij traktati dhe të këtij statuti.

## TITULLI I

### GJYQTARËT DHE AVOKATËT E PËRGJITHSHËM \_\_\_\_\_

### Neni 2

Para se të marrë detyrat e tij, çdo gjyqtar, në një seancë të hapur gjyqësore, betohet se do të kryejë detyrat e tij, në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegjshmëri të lartë, dhe se do të ruajë sekretin e proceseve në gjykatë.

### Neni 3

Gjyqtarët kanë imunitet nga proceset gjyqësore. Pasi të kenë përfunduar detyrën, ata vazhdojnë të gëzojnë imunitet, në lidhje me aktet e kryera prej tyre në pozicionin e tyre zyrtar, duke përfshirë dhe fjalët e thëna a të shkruara.

Gjykata, e mbledhur në seancë plenare, mund të heqë imunitetin.

Kur një gjyqtari i është hequr imuniteti dhe kundër tij fillohet një proces gjyqësor, ai gjykohet në një Shtet Anëtar, vetëm nga gjykata kompetente për të gjykuar anëtarët e organit gjyqësor më të lartë kombëtar.

#### Neni 4

Gjyqtarët nuk mund të mbajnë poste politike ose administrative.

Ata nuk mund të angazhohen në asnjë punë, qoftë fitimprurëse ose jo, me përjashtim të rasteve kur bëhet përjashtim i posaçëm nga Këshilli.

Kur marrin detyrat e tyre, gjyqtarët zotohen solemnisht, se si gjatë dhe pas mbajtjes së postit të tyre, ata do të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga detyra, në veçanti detyrën për t'u sjellë me integritet dhe maturi, në lidhje me pranimin në poste të caktuara ose përfitime të tilla pas mbarimit të detyrës së gjyqtarit.

Çdo dyshim mbi këtë pikë zgjidhet me vendim të gjykatës.

#### Neni 5

Përveç zëvendësimit normal, ose vdekjes, detyrat e një gjyqtari përfundojnë kur ai jep dorëheqjen.

Kur një gjyqtar jep dorëheqjen, letra e tij e dorëheqjes i drejtohet Kryetarit të Gjykatës që ia përcjell Presidentit të Këshillit. Pas këtij njoftimi krijohet një vend i lirë në panel.

Me përjashtim të rasteve kur zbatohet neni 6, një gjyqtar vazhdon ta mbajë detyrën deri sa pasardhësi i tij merr detyrën.

#### Neni 6

Një gjyqtari mund t'i mohohet detyra ose e drejta e tij për të marrë pension ose përfitime të tjera në vend të tij, nëse me mendimin unanim të gjyqtarëve dhe të avokatëve të përgjithshëm të gjykatës, ai nuk i plotëson më kushtet e nevojshme ose nuk i plotëson detyrimet që rrjedhin nga një pozicion i tillë. Gjyqtari në fjalë nuk merr pjesë në shqyrtime të tilla.

Sekretari i Gjykatës i komunikon vendimin e Gjykatës Kryetarit të Parlamentit dhe Presidentit të Komisionit dhe ia njofton atë Presidentit të Këshillit.

Në rast të një vendimi që i mohon pozicionin e punës gjyqtarit, krijohet një vend i lirë në Gjykatë, pas njoftimit të këtij të fundit.

#### Neni 7

Një gjyqtar që zëvendëson një anëtar të gjykatës, mandati i të cilit nuk ka përfunduar, emërohet për pjesën e mbetur të mandatit të paraardhësit.

#### Neni 8

Dispozitat e neneve 2 deri me 7 zbatohen dhe për avokatët e përgjithshëm.

## TITULLI II

### ORGANIZIMI

---

#### Neni 9

Kryesekretari betohet para Gjykatës që do të kryejë detyrat e tij, në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegjshmëri si dhe do të ruajë sekretin e proceseve në gjykatë.

#### Neni 10

Gjykata bën rregullimet për zëvendësimin e sekretarit, në rastet kur atij i ndalohet të marrë pjesë në gjykatë.

#### Neni 11

Zyrtarët dhe nëpunësit e tjerë i bashkëngjiten gjykatës për të realizuar funksionimin e saj. Ata janë përgjegjës para Kancelarit, nën autoritetin e Presidentit.

#### Neni 12

Me propozim të Gjykatës, Këshilli, me votim unanim, mund të parashikojë emërimin e ndihmësraportuesve dhe parashikon rregullat që drejtojnë shërbimin e tyre. Ndihmësraportuesit mund të kërkojnë, sipas kushteve të përcaktuara në rregullore, të marrin pjesë në hetimet përgatitore në çështjet që janë pezull përpara Gjykatës dhe të bashkëpunojnë me gjyqtarin për të vepruar si raportues.

Ndihmësraportuesi zgjidhet nga personat pavarësia e të cilëve është e garantuar dhe që zotërojnë kualifikimet e duhura ligjore; ata emërohet nga Këshilli. Ata betohen para gjykatës për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegjshmëri të lartë, dhe për ruajtjen e sekretit të proceseve në gjykatë.

#### Neni 13

Gjyqtarëve, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Kancelarit i kërkohet të qëndrojnë në vendin ku Gjykata ka selinë e saj.

#### Neni 14

Gjykata punon pa ndërprerje. Kohëzgjatja e pushimeve të gjyqësorit përcaktohet nga Gjykata duke pasur parasysh nevojat e punës së saj.

#### Neni 15

Vendimet e Gjykatës janë të vlefshme, vetëm nëse gjatë shqyrtimit janë të pranishëm anëtarë me numër tek. Vendimet e Gjykatës së plotë janë të vlefshme, nëse janë të pranishëm pesë anëtarë. Vendimet e dhomave janë të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm tri gjyqtarë; në rast se njërit nga gjyqtarët e homës ndalohet të marrë pjesë, mund të thirret një gjyqtar nga një dhomë tjetër, në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloren e Gjykatës.

#### Neni 16



Asnjë gjyqtar ose avokat i përgjithshëm nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e ndonjë çështjeje në të cilën ai ka marrë pjesë më parë si agjent ose këshilltar, ose ka vepruar për njërën nga palët, ose për të cilën atij i është kërkuar të shprehet si një anëtar i një gjykate të zakonshme ose një gjykate të posaçme, i një komisioni hetimi ose në ndonjë kapacitet tjetër.

Në rast se, për disa arsye të veçanta, çdo gjyqtar ose avokat i përgjithshëm konsideron, se ai nuk duhet të marrë pjesë në gjykimin ose shqyrtimin e një çështje të caktuar, ai informon Kryetarin për këtë gjë. Në rast se, për arsye të veçanta, Kryetari është i mendimit se ndonjë gjyqtar ose avokat i përgjithshëm nuk duhet të jetë pjesë gjykimi ose nuk duhet të bëjë parashtrime për një çështje të caktuar, ai e njofton përkatësisht personin.

Çdo vështirësi që del në lidhje me zbatimin e këtij neni zgjidhet me vendim të gjykatës.

Një palë nuk mund të bëjë kërkesë për një ndryshim në përbërjen e gjykatës ose të njëjës prej dhomave të saj, për shkakë kombësie të një gjyqtari ose të mungesës nga gjykata ose nga trupi gjykues i nënshtetësisë së asaj pale.

### TITULLI III

#### PROCEDURA

##### Neni 17

Shtetet dhe institucionet e Komunitetit përfaqësohen para Gjykatës nga një agjent i emëruar për çdo çështje; agjenti mund të ndihmohet nga një këshilltar ose avokat që ka të drejtë të ushtrojë profesionin para një gjykate të një Shteti Anëtar.

Palët e tjera duhet të përfaqësohen nga një avokat që ka të drejtë të ushtrojë profesionin para një Gjykate të një Shteti Anëtar.

Agjentë, këshilltarë dhe avokatë të tillë, kur dalin para Gjykatës, gëzojnë të drejtat dhe imunitetet e nevojshme për ushtrimin e pavarur të detyrave të tyre, sipas kushteve të parashikuara në rregullore.

Në lidhje me këshilltarë dhe avokatë të tillë që dalin para Gjykatës, ajo ka kompetencën që i njihen normalisht gjykatave sipas kushteve të parashikuara në rregullore.

Mësimdhënësit në universitet, të cilët janë nënshtetas të një Shteti Anëtar, legjislacioni i të cilit u jep atyre të drejtën e audiencës, kanë të njëjtat të drejta para Gjykatës si të drejtat që i jepen avokatëve, që kanë të drejtë të ushtrojnë profesionin para një Gjykate të një Shteti Anëtar në këtë nen.

##### Neni 18

Procesi para Gjykatës përbëhet prej dy pjesësh: pjesa me shkrim dhe me gojë.

Procesi me shkrim përbëhet nga komunikimi me palët dhe me institucionet e Komunitetit, vendimet e të cilëve janë në kundërshtim me kërkesat, rrethanat e çështjes, mbrojtjet dhe vëzhgimet, dhe përgjigjet, nëse ka, si dhe të gjitha letrat dhe dokumentet në mbështetje të kopjeve të certifikuara të tyre.

Komunikimet bëhen nga Kancelari, në mënyrën dhe brenda kohës së parashikuar në rregullore.

Procesi me gojë përbëhet nga leximi i raportit që paraqitet nga një gjyqtar që luan rolin e reportuesit, seanca dëgjimore për Gjykatën nga agjentët, këshilltarët dhe avokatët që kanë të drejtë të ushtrojnë profesionin tyre para

një Gjykatë të një Shteti Anëtar, parashtrimet e avokatit të përgjithshëm, si dhe dëgjimi, nëse ka, të dëshmitarëve dhe të ekspertëve.

#### Neni 19

Një çështje i çohet Gjykatës nëpërmjet një kërkesë padie me shkrim që i drejtohet Kancelarit. Kërkesë padia përmban emrin e kërkuarit, adresën e përhershme dhe një përshkrim të nënshkruesit, emrin e palës kundër së cilës është bërë padia, objektin e mosmarrëveshjes, dhe depozitimin e një deklarate të shkurtër për shkaqet mbi të cilat bazohet padia.

Kërkesa shoqërohet, kur është e nevojshme, nga masa anulimi i të cilës kërkohet, ose në rrethanat të cilat përmenden në nenin 148 të këtij traktati, nga prova dokumentare të datës në të cilën institucionit i kërkohet të veprojë në përputhje me atë nen. Nëse së bashku me kërkesën nuk dorëzohen këto dokumente, Kancelari i kërkon palës së përfshirë t'i depozitojë këto dokumente brenda një periudhe të arsyeshme, por në këtë rast të drejtat e palës nuk shterohen, dhe në rast se këto dokumente dorëzohen pas afatit kohor për to.

#### Neni 20

Një çështje që drejtohet nga neni 18 i këtij traktati i çohet Gjykatës nëpërmjet një apeli që i drejtohet Kancelarit. Apeli përmban emrin dhe adresën e përhershme të kërkuarit dhe përshkrimin e nënshkruesit, një referencë të vendimit kundër të cilit bëhet apeli, emrat e të paditurve, objektin e mosmarrëveshjes, parashtrimet dhe një deklaratë të shkurtër të rrethanave mbi të cilat është bazuar apeli.

Apeli shoqërohet nga një kopje e noterizuar e vendimit të Komitetit të Arbitrazhit që kontestohet.

Nëse Gjykata hedh poshtë apelin, vendimi i Komitetit të Arbitrazhit bëhet përfundimtar.

Nëse Gjykata anulon vendimin e Komitetit të Arbitrazhit, çështja mund të rihapet, kur është e nevojshme, me iniciativën e njëres nga palët në çështje, para Gjykatës së Arbitrazhit. Kjo e fundit respekton vendimet për procedurë që jepen nga Gjykata.

#### Neni 21

Në rastin e parashikuar nga neni 150 i këtij traktati, vendimi i gjykatës së zakonshme ose i një gjykate të posaçme të një Shteti Anëtar, që pezullon proceset e tij dhe ia referon çështjen Gjykatës, i njoftohet asaj nga gjykata e zakonshme ose gjykata e posaçme e interesuar. Më pas vendimi i njoftohet palëve, Shteteve Anëtare dhe Komisionit si dhe Këshillit nga Kancelari i Gjykatës, nëse akti vlefshmëria ose interpretimi i të cilit është në mosmarrëveshje e ka origjinën nga Këshilli.

Brenda dy muajve nga ky njoftim, palët, Shtetet Anëtare, Komisioni, dhe kur është e nevojshme, edhe Këshilli, kanë të drejtë të dorëzojnë deklarata për çështjen ose vëzhgimeve të shkruara për Gjykatën.

#### Neni 22

Gjykata mund t'u kërkojë palëve të paraqesin të gjitha dokumentet dhe të japin të gjithë informacionin që konsiderohet i nevojshëm nga Gjykata. Për çdo refuzim mbahen shënime zyrtare.

Gjykata mund t'u kërkojë gjithashtu Shteteve Anëtare dhe institucioneve që nuk janë palë në çështje të japin të gjithë informacionin që Gjykata e konsideron të nevojshëm për procesin.

#### Neni 23

Gjykata, në çdo kohë mund t'i besojë çdo individ, organi, autoriteti, komiteti ose organizate tjetër që për zgjedh detyrën e dhënies së një mendimi të specializuar.

Neni 24

Dëshmitarët dëgohen sipas kushteve të parashikuara në rregullore.

Neni 25

Në lidhje me mosparaqitjen e dëshmitarëve në gjyq, Gjykata ka të gjitha kompetencat që kanë përgjithësisht gjykatat e zakonshme dhe gjykatat e posaçme, dhe mund të venë gjoba sipas kushteve të specifikuara në rregullore.

Neni 26

Dëshmitarët dhe ekspertët dëgohen pas bërjes së betimit, në formën e parashikuar në rregullore ose në mënyrën e parashikuar nga ligji i vendit të dëshmitarit ose të ekspertit.

Neni 27

Gjykata mund të urdhërojë që një dëshmitar ose ekspert të dëgohet nga një autoritet gjyqësor në vendin e vendbanimit të përhershëm.

Urdhri i dërgohet për zbatim autoritetit përkatës përgjegjës sipas kushteve të përcaktuara në rregullore. Dokumentet e përpiluara në përputhje me letërporositë i kthehen Gjykatës sipas të njëjtave kushte.

Gjykata mbulon shpenzimet, pa paragjykim të së drejtës për t'ua ngarkuar ato palëve, kur duhet kështu.

Neni 28

Një Shtet Anëtar e trajton shkeljen e betimit nga një dëshmitar ose ekspert, në të njëjtën mënyrë sikur vepra të ishte kryer para njëres prej gjykatave të tij me juridiksion në çështjet civile. Me kërkesë të Gjykatës, Shteti Anëtar përkatës e ndjek kundërvajtësin nëpërmjet vendosjes së tij para gjykatës përgjegjëse.

Neni 29

Seancat në Gjykatë mbahen me dyer të hapura, në përjashtim të rastit kur Gjykata, me veprim të saj ose me kërkesë të palëve, vendos ndryshe për shkak të arsyeve serioze.

Neni 30

Gjatë seancave dëgjimore, Gjykata mund të dëgjojë ekspertët, dëshmitarët dhe vetë palët. Gjithsesi, palët mund t'i drejtohen Gjykatës vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tyre.

Neni 31

Për çdo seancë mbahen procesverbale, të cilat nënshkruhen nga Kryetari dhe Kancelari.

Neni 32

Lista e shkaqeve përcaktohet nga Kryetari.

### Neni 33

Shqyrtimet e Gjykatës janë dhe mbeten sekret.

### Neni 34

Vendimet përmbajnë arsyet mbi të cilat janë bazuar. Ata përmbajnë emrat e gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtime.

### Neni 35

Vendimet nënshkruhen nga Kryetari dhe Kancelari. Ata lexohen në seancë me dyer të hapura.

### Neni 36

Gjykata vendos për kostot.

### Neni 37

Kryetari i Gjykatës, me anë të një procedure të përmbledhur, e cila mund, për aq sa është e nevojshme, të ndryshojë disa nga rregullat e përfshira në këtë statut dhe të cilat parashikohen në rregullore, gjykon për kërkesat për të pezulluar ekzekutimin, siç parashikohet në nenin 157 të këtij traktati, ose për të parashikuar masa të përkohshme sipas nenit 158, ose për të pezulluar zbatimin në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 164.

Nëse Kryetari ndalohet të marrë pjesë, vendi i tij zihet nga një tjetër gjyqtar, sipas kushteve të parashikuara në rregullore.

Vendimi i Kryetari ose i gjyqtarit që e zëvendëson atë është i përkohshëm, dhe në asnjë mënyrë nuk cenon vendimin e Gjykatës për thelbin e çështjes.

### Neni 38

Shtetet Anëtare dhe institucionet e Komunitetit mund të ndërhyjnë në çështjet para Gjykatës.

E njëjta e drejtë është e hapur për çdo palë tjetër që ka interes në rezultatin e çdo çështjeje që i dërgohet Gjykatës, në përjashtim të çështjeve ndërmjet Shteteve Anëtare, ndërmjet institucioneve të Komunitetit ose ndërmjet Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Komunitetit.

Parashtrimet e bëra në një kërkesë për të ndërhyrë janë të kufizuar në mbështetjen e parashtrimeve të njëjës nga palët.

### Neni 39

Kur pala mbrojtëse, pasi është marrë në pyetje sipas rregullave, nuk depoziton parashtrime me shkrim në mbrojtje, vendimi jepet kundër kësaj pale si shkak i mosparaqitjes së parashtrimit. Vendimi mund të kundërshtohet një muaj pas njoftimit të tij. Kundërshtimi nuk ka efektin e ruajtjes së zbatimit të gjykimit për mosparaqitjen e parashtrimit, në përjashtim të rasteve kur Gjykata vendos ndryshe.

### Neni 40

Shtetet Anëtare, institucionet e Komunitetit dhe çdo person tjetër fizik ose juridik, në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në rregullore, mund të organizojnë procese me palë të treta për të kontestuar një vendim të dhënë, pa u dhënë atyre më parë të drejtën për t'u shprehur, kur vendimi cenon të drejtat e tyre.

#### Neni 41

Nëse kuptimi ose objekti i një gjykimi është i paqartë, Gjykata e interpreton atë me aplikimin nga çdo palë ose çdo institucion i Komunitetit që ka një interes në të.

#### Neni 42

Gjykatës mund t'i paraqitet një kërkesë për rishikim vendimi, vetëm në rast të zbulimit të një fakti që është i një natyre të tillë që përbën një faktor vendimtar, dhe i cili, gjatë kohës që është dhënë vendimi, ishte i panjohur për Gjykatën dhe për palët që kërkojnë rishikimin e vendimit.

Rishikimi hapet nga vendimi i Gjykatës që përmend shprehimisht praninë e një fakti të ri, duke njohur që ai është i një karakteri të tillë që çon në hapjen e çështjes për rishikim dhe e deklaron kërkesën të pranueshme mbi këtë bazë.

Pas përfundimit të kohës prej dhjetë vjetësh nga data e vendimit nuk bëhet kërkesë për rishikim vendimi.

#### Neni 43

Periudhat e faljes bazuar në përlllogaritjen e distancës përcaktohen nga rregullorja.

Asnjë e drejtë nuk humbet si pasojë e përfundimit të një afati kohor, nëse pala në fjalë provon praninë e rrethanave të paparashikueshme ose të forcave madhore.

#### Neni 44

Proceset kundër Komunitetit për çështje që rrjedhin nga përgjegjësi jokontraktuale, nuk mund të nisin/bëhen me kalimin e pesë viteve nga marrja dijani për veprimin e kryer. Ky afat pezullohet, nëse kanë filluar procese në Gjykatë ose nëse para proceseve të tilla paraqitet një kërkesë nga pala e cenuar në institucionin përkatës të Komunitetit. Në rastin e fundit, proceset duhet të fillohen brenda një periudhe dy mujore, siç parashikohet në nenin 146; kur është e përshtatshme zbatohen dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 148.

#### Neni 45

Rregullorja e Gjykatës, e parashikuar në nenin 160 të këtij traktati, përmban, përveç dispozitave të parashikuara në këtë statut, çdo dispozitë tjetër të nevojshme për ta zbatuar atë, dhe ku është e nevojshme, për ta plotësuar atë.

#### Neni 46

Këshilli, me vendim unanim, mund të bëjë rregullime të mëtejshme në dispozitat e këtij statuti siç mund të kërkohet nga masat e marra nga Këshilli në përputhje me paragrafin e fundit të nenit 137 të këtij traktati.

#### Neni 47

Menjëherë pas betimit, Presidenti i Këshillit zgjedh me short gjyqtarët dhe avokatët e përgjithshëm, mandati i të cilëve përfundon në fund të tre viteve të para, në përputhje me paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 139 të këtij traktati.

Në praninë e tyre, të Plotfuqishmit nënshkruan këtë protokoll.

Nënshkruar në Bruksel, më shtatëmbëdhjetë prill të vitit njëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë.

J. Ch. SNOY et d'OPPUERS.

C. F. OPHÜLS.

Robert MARJOLIN

Vittorio BADINI

Lambert SCHAUS

J. LINTHORST HOMAN